



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 128

Tiranë – E premte, 19 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 487, datë 4.6.2026	Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e certifikatave të kategorizimit të strukturave akomoduese..... 11845
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 488, datë 4.6.2026	Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik..... 11845
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 26.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 352, datë 24.6.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 164 (87-2024-223), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1979 (299), datë 4.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 11845
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 31.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1913, datë 21.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 11859
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 48, datë 8.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 125, datë 20.10.2024, dhe nr. 130, datë 23.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 59 (87-2024-333), datë 19.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-364 (57), datë 27.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 11871

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 8.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 44 (86-2023-775), datë 14.7.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e vendimit nr. 537, datë 14.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”, dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për rimarrjen në shqyrtim të vlerësimit etik dhe profesional të kërkuases për vitin 2021.....	11905
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 68, datë 4.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 2512 (80-2017-2536), datë 6.6.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.7.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-968, datë 3.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	11912
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 2, datë 11.5.2026	Me objekt: 1. Shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj prokurorit Sali Hasa, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Dërgimin e çështjes në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili duhet të rishqyrtojë kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, mbasi të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. 3. Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që në kuadër të zbatimit të procesit të rregullt ligjor në procedurat administrative, mbi bazë të pretendimeve të prokurorit Sali Hasa, të fillojë hetimin disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që janë marrë me procedimin dhe gjykimin e akuzave ndaj tij dhe t’i përfshijë gjetjet e hetimit në raportin e hetimit disiplinor, që do t’i ridërgojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbas përfundimit të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë.....	11919
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 115, datë 19.6.2026	Për delegim kompetence.....	11930



URDHËR
Nr. 487, datë 4.6.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E
CERTIFIKATAVE TË KATEGORIZIMIT
TË STRUKTURAVE AKOMODUESE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore” dhe të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 8, të urdhrit nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e Certifikatës së Kategorizimit të strukturës akomoduese, të subjekteve të certifikuara nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, të z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

2. Ngarkohet z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 488, datë 4.6.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E
CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYESIT
TURISTIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore” dhe të pikës 2/1, të vendimit nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, ‘Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre’, i ndryshuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, të individëve të certifikuar nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, të z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

2. Ngarkohet z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

VENDIM
Nr. 41, datë 26.3.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datat 5.3.2026 dhe 26.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 3 (R) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Redi Molla, përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me prokurë.



SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 352, datë 24.6.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 164 (87-2024-223), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1979 (299), datë 4.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet dhe prapësimet e kërkuarit Redi Molla (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe shtetasi M. Q. nga muaji gusht i vitit 2015 deri në shkurt të vitit 2016 kanë qenë të punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës. Në muajin shkurt të vitit 2016 kërkuesi është punësuar në shoqërinë “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm, dhe në muajin mars të po atij viti edhe shtetasi M. Q. është punësuar në të njëjtën shoqëri, në pozicionin e drejtorit të departamentit mbështetës.

2. Ndërkohë, në datën 22.1.2016, është regjistruar shoqëria “Igor Elektrik” sh.p.k., e themeluar nga ortakut i vetëm dhe administratori i saj, shtetasi E. M., me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, edhe ndërtimin e rrjeteve inxhinierike të ujësjellësit. Nëpërmjet kontratave të shitblerjes të datave 27.1.2017 dhe 7.12.2018, aksionet në masën 100% janë zotëruar nga shtetasi M. P. dhe administrimi është kryer nga shtetasi N. M. Në datën 7.1.2019, është regjistruar në regjistrin tregtar ndryshimi i emrit të shoqërisë në “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k., si dhe është pasqyruar vendimi i ortakut të vetëm për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga 100 lekë në 1.000.000 lekë. Në vijim, në datën 4.3.2021, aksionari i vetëm i ka shitur administratorit të shoqërisë 100% të aksioneve për një vlerë prej 1.000.000 lekë, dhe ky i fundit, në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe të administratorit, i ka ndryshuar sërish emërtimin në “5D Konstruksion” sh.p.k. Kjo shoqëri ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në disa procedura prokurimi për periudhën 2016–2022 nga institucionet publike, ndër të cilat ka rezultuar fituese në 13 procedura prokurimi të shpallura nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës, ose institucione në varësi të saj, si dhe në 10 procedura prokurimi të shpallura nga autoriteti kontraktor, shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a.

3. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr.75, datë 27.4.2023 (*procedimi penal nr. 75/2023*) për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP). Po kështu, Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi B. K., ka regjistruar procedimin penal nr. 121, datë 23.5.2023, (*procedimi penal nr. 121/2023*) për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë dhe 259, paragrafi i dytë, të KP-së.

4. Në vijim të procedimit penal nr. 5/2023 janë kryer veprime hetimore dhe me vendimin nr. 401, datë 11.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) është



ushtruar kontroll në mjediset e zyrës së shoqërisë “5D Konstruksion” sh.p.k., duke sekuestruar dokumente, njësi kompjuterike dhe aparate të telefonisë celulare, të cilat më pas u janë nënshtruar ekspertimeve teknike kompjuterike, nga ku janë gjetur të dhëna se ortakët e vërtetë të kësaj shoqërie janë kërkuesi dhe shtetasi M. Q., të cilët dyshohet se e kanë zotëruar në mënyrë të tërthortë që prej vitit 2016.

5. Pas kryerjeve të veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për caktimin e masave të sigurimit “Arresti në burg” ndaj personave nën hetim, kërkuesit dhe shtetasit tjetër, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 e 25, të KP-së dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim”, e kryer disa herë.

6. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 28, datë 28.3.2024, ka miratuar kërkesën dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në shtatë raste, nga këto katër raste të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 të KP-së, dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim” të kryer në pesë raste, të parashikuar nga neni 257, shkronja “a”, pika 2, i KP-së. Në datën 29.3.2024, Prokuroria e Posaçme ka dërguar për gjykim kërkesën për verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal dhe marrjes në pyetje ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr.35, datë 30.3.2024, ka vendosur, ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së ndaj kërkuesit si person i hetuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 të KP-së dhe 257, shkronja “a”, pika 2, i KP-së. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

(GJKKO-ja e Apelit), me vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.3.2024 dhe nr. 35, datë 30.3.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndërkohë, për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit për kërkuesin dhe personin tjetër nën hetim, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Kolegji Penal ka udhëzuar GJKKO-në e Apelit të marrë në shqyrtim vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim, duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit, dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës, deri në fazën aktuale të hetimeve.

8. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 57 (87-2024-323), datë 7.11.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.3.2024 dhe nr. 35, datë 30.3.2024, të GJKKO-së Shkallës së Parë për llojin e masës së sigurimit “Arresti në burg” të caktuar ndaj kërkuesit, me arsyetimin se është më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit, me rëndësinë e fakteve dhe me sanksionet e parashikuara për veprat penale.

9. Në datën 28.5.2024, në GJKKO-në e Shkallës së Parë është regjistruar kërkesa penale me nr. 313 akti e paraqitur nga personi tjetër nën hetim, shtetasi M. Q., me objekt paraqitjen e informacionit dymujor dhe verifikimin e kushteve e të kriterëve që lidhen me nevojat e sigurimit ndaj personit nën hetim dhe zëvendësimin e masës së sigurimit në zbatim ndaj tij me një masë siguri mi më të butë. Në datën 30.5.2024, është regjistruar kërkesa penale me nr. 320 akti nga kërkuesi si person nën hetim, me objekt të njëjtë me shtetasin nën hetim, M. Q. Në datën 10.6.2024, është regjistruar kërkesa penale me nr. 352 akti e Prokurorisë së Posaçme, me objekt paraqitjen e informacionit dymujor për ecurinë e hetimeve ndaj kërkuesit dhe dy shtetasve të tjerë nën hetim, M. Q. dhe T. T. Me vendimin e datës 12.6.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur



bashkimin e kërkesave penale me nr. 313 akti dhe nr. 320 akti me kërkesën penale nr. 352 të Prokurorisë së Posaçme, pasi të tria këto lidhen me procedimin penal nr. 75/2023, gjenden për shqyrtim në të njëjtën fazë procedurale, përpara së njëjtës gjykatë, si dhe në thelb kanë të njëjtin objekt.

10. Sipas Prokurorisë së Posaçme, referuar informacionit me shkrim dhe qëndrimit të mbajtur gjatë zhvillimit të gjykimit, në funksion të procedimit penal në ngarkim të kërkuarit, shtetasit M. Q. e personave të tjerë që hetohen në kuadër të të njëjtit procedim, janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si: sekuestrimi i aparateve të telefonisë celulare, kryerja e ekspertimit teknik kompjuterik, ekspertimi teknik për llogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit të gjetura me shkelje, si dhe janë kryer veprime hetimore që lidhen me mënyrën e qarkullimit të shumave monetare nga shoqëria “5D Konstruktion sh.p.k.”, me burimin e të ardhurave të investuara nga shoqëria në aktivitete të tjera, si dhe me shumatat monetare që janë përfituar nga zotëruesit e shoqërisë tregtare.

11. Nga ana tjetër, me vendimin e datës 23.5.2023, Prokuroria e Posaçme ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale nr. 75/2023 dhe nr. 121/2023, të regjistruara mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit B. K., në një procedim penal me nr. 75/2023. Në vijim të hetimeve, me urdhrin e datës 4.6.2024, Prokuroria e Posaçme ka bërë ndryshime në regjistrin e njoftimeve të veprave penale të regjistrimit të personit që i atribuohet vepra penale, duke urdhëruar regjistrimin e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, i KP-së. Po kështu, sipas këtij urdhri të Prokurorisë së Posaçme, është regjistruar si person nën hetim personi juridik, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “5D Konstruktion sh.p.k.”, si subjekt i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 25, si dhe 287 të KP-së. Sipas Prokurorisë së Posaçme, për një hetim të plotë duhen kryer veprime të tjera hetimore në drejtim të grumbullimit të provave të tjera në ngarkim të personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuarin.

12. Kërkuari, nëpërmjet avokatit mbrojtës, ka kundërshtuar në GJKKO-në e Shkallës së Parë masën e sigurimit, duke pretenduar se ajo është e papërshtatshme e duhet zëvendësuar me një masë më të butë, pasi: i. kërkuari është marrë i pandehur me urgjencë për disa vepra penale, për shkak të parashkrimit, pa u thirrur për të dhënë shpjegime e sqarime paraprakisht. Në dy muajt e masës së arrestit në burg nuk ka pasur përpjekje për ta marrë në pyetje për faktet që i atribuohen; ii. mungon dyshimi i arsyeshëm dhe kërkuari nuk mund të qëndrojë në arrest në burg në fazën ku gjendet procedimi penal, pasi hetimet do të zgjasin për shkak të akteve të ekspertimit që duhet të administrohen; iii. duke marrë të mirëqenë rrezikshmërinë shoqërore të veprave, kërkuari njihet për një reputacion të mirë, si dhe nga momenti i ushtrimit të kontrollit në zyrat e shoqërisë “5D Konstruktion sh.p.k.”, në tetor 2023, ai nuk ka kryer asnjë veprim për të dëmtuar provat ose për t’iu shmangur hetimeve. Me kërkesë të njëjtë i janë drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë edhe dy personat nën hetim, shtetasit M. Q. dhe T. T.

13. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 352, datë 24.6.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit dhe të dy personave të tjerë nën hetim, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr.28, datë 28.3.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në drejtim të kontrollit për ecurinë e hetimeve dhe vlerësimit të diligjencës së organit të hetimit në kryerjen e tyre gjatë zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj personave nën hetim, Prokuroria e Posaçme ka kryer një sërë veprimesh hetimore për procedimin në tërësi. Referuar informacionit dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime thelbësore, pasi personat e hetuar vijojnë të jenë në hetim për të njëjtat fakte, për të njëjtat vepra penale, mbartin të njëjtën rrezikshmëri shoqërore të vlerësuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në momentin fillestar dhe e gjetur e drejtë edhe nga gjykata më



e lartë që ka shqyrtuar ankimin e personave nën hetim, duke miratuar masat e caktuara prej tyre. Në këtë fazë të hetimit nuk ka rezultuar të jenë bërë ndryshime të cilësimit ligjor të faktit penal me pasojë ridimensionimin e nevojave të sigurimit personal në drejtim të lehtësimit të tyre. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe personi nën hetim, M. Q.

14. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 164 (87-2024-223), datë 31.7.2024, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në apelet e kërkuetit dhe të personit tjetër nën hetim janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Ndryshe nga Prokuroria e Posaçme dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se ato nuk kanë reflektuar në qëndrimet e tyre për kualifikimin juridik të fakteve penale historike objekt procedimi, pavarësisht pjesës relevante arsyetuese të vendimit nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit. Sipas kësaj të fundit, konstatohet se për dy personat nën hetim nuk ka asnjë rrethanë që ka relativizuar rëndësinë juridike dhe faktike të fakteve penale historike të cilat u atribuohen, përkundrazi ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tyre dhe për aktivizimin e përgjegjësisë penale të tyre për veprat penale të rezultuara deri më tani se janë konsumuar sipas pikëpamjes juridike të ndryshme të GJKKO-së së Apelit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

15. Për rekursin e kërkuetit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1979 (299), datë 4.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuetit se gjykata e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake për kualifikimin ndryshe të bashkëpunimit nga ai i thjeshtë, në grup të strukturuar kriminal, janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 26.9.2024, duke vendosur, ndër të tjera, prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës

penale. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim informacionin dymujor për gjendjen e procedimit penal, si dhe kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit ku gjerësisht është arsyetuar se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur. Sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së në kohen e depozitimit.

16. Në datën 30.4.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 26.6.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje. Në datën 10.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 23.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

17.1 *Liria personale, e garantuar nga neni 27, pikat 1 dhe 2, shkronja "c", të Kushtetutës, dhe neni 5, pika 1, shkronja "c", i KEDNJ-së, në drejtim të standardit të dyshimit të arsyeshëm dhe të proporcionalitetit*, si rrjedhojë e mospranimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kërkesës së tij për zëvendësimin e masës "Arresti në burg". Gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve kërkuesi nuk ka ndërmarrë ose tentuar ndonjë veprim të çfarëdoshëm për të dëmtuar provat ose për t'u larguar, ndaj arsyet e përmendura për bazueshmërinë e caktimit të masës së sigurimit nuk i përgjigjen shkakut të vërtetë të arrestimit të



tij, por janë arbitrare dhe pasqyrojnë një arsyetim formal dhe të përgjithshëm të kriterëve të përgjithshme e të veçanta për caktimin e masës së sigurimit nga gjykatat, duke u bazuar vetëm në rrezikshmërinë e veprës dhe ashpërsinë e dënimit, pa dhënë asnjë rrethanë konkrete se në çfarë mënyre ose me çfarë veprimi kërkuesi plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 228, paragrafi 3, i KPP-së. Caktimi i një mase të sigurimit personal më të ashpër, në kushtet kur synimi mund të arrihej edhe nëpërmjet masave më të lehta, e bën masën e caktuar ndaj joproporcionale me akuzat në ngarkim të tij dhe me situatën faktike në momentin e caktimit të kësaj mase kur hetimet tashmë ishin kryer. Çdo kufizim i lirisë duhet të respektojë në mënyrë të veçantë të drejtën e shëndetit dhe të dinjitetit të të paraburgosurit, që, në rastin konkret, është në disproporcion flagrant me gjendjen e rënduar shëndetësore të kërkuesit (*shih Ebedin Abi kundër Turqisë, datë 13.3.2018, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*).

17.2 *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

17.2.1 *Parimit të paanshmërisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit, me vendimmarrjen e saj, ka rënduar pozitën e kërkuesit, ka tejkualuar kufijtë e shqyrtimit në gjykatën e apelit, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori dhe as nga gjykata e shkallës së parë, si dhe ka caktuar një masë sigurimi ekstreme në mungesë totale të arsytimit mbi pretendimin e mbrojtjes për pavlefshmëri të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë e ka tejkualuar pragun e shfaqjes së një mendimi ose sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit, apo kualifikimin e faktit penal në ngarkim të kërkuesit, duke u shprehur me bindje në arsytimin e saj se ai është fajtor e tenton të orientojë prokurorinë që të veprojë sipas bindjes së saj.

17.2.2 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsytimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit nëpërmjet kualifikimit të veprës penale, duke rekomanduar GJKKO-në e Apelit të marrë

në shqyrtim vendimin e GJKKO-së së Shkallës së parë për masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim, duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës, deri në fazën aktuale të hetimeve. Ndërkohë që GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimin nr.18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, me doza të thella paragyrimi dhe me bindjen e plotë se ai është fajtor, por për akuza edhe më të rënda nga sa pretendon organi i akuzës, Kolegji Penal, me vendimin e datës 4.12.2024, ka anashkaluar haptazi qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 26.9.2024, duke mbajtur i njëjti trup gjykues qëndrim katërcipërisht të kundërt për të njëjtin fakt në dy momente të ndryshme.

17.3 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar kërkuesin dhe personat nën hetim si fajtorë, ndonëse çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve, duke e rikualifikuar faktin penal, sipas neneve 143, paragrafi 3, 287 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, për kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, sipas nenit 28, paragrafi 4, të KP-së, duke rënduar pozitën e tyre.

17.4 *Të drejtat dhe liritë themelore*, pasi në datën 30.7.2025, nisur nga gjendja e rënduar shëndetësore, ai i është drejtuar sërish GJKKO-së të Shkallës së Parë me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me një masë më të butë. Me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka rrëzuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës, si dhe ka rrëzuar kërkesën e mbrojtësit për të marrë kartelën klinike në cilësinë e provës, duke refuzuar në këtë mënyrë prova mjekësore të specializuara, duke vënë në rrezik të drejtpërdrejtë jetën e kërkuesit, për aq kohë sa I EVP-ja, Fier nuk mund t'i ofrojë atij as terapinë e nevojshme të përditshme, as regjimin ushqimor të posaçëm, dhe as monitorimin e vazhdueshëm mjekësor që kërkon gjendja e tij.

18. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, në mënyrë të përmbledhur, për themelin e çështjes, ka prapësuar si vijon:

18.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit të paanshmërisë* nuk qëndron, pasi GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për



respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, nuk kanë zhvendosur barrën e provës të kërkuar, nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, si dhe e kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarit në fazën e caktimit të masës së sigurimit.

18.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi shkaqet e parashtruara nga kërkuar kanë për objekt vendimin nr.18 (87-2024-123), datë 3.5.2024 të GJKKO-së së Apelit, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, për më tepër është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 232, datë 26.9.2024, ndaj nuk prodhon efekte të një vendimi gjyqësor për sa i përket arsyes së prishjes së tij. Më konkretisht në arsyetimin e vendimit citohet se gjyqtari i hetimit paraprak nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake dhe se kjo ndërhyrje e gjyqtarit të hetimit paraprak në veprimtarinë e prokurorit, duke bërë kualifikim të faktit penal, është jashtë kompetencave të funksionit të gjyqtarit të hetimit paraprak.

18.3 Pretendimet për cenimin e *standardit të dyshimit të arsyeshëm dhe të proporcionalitetit* nuk qëndrojnë, pasi referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, më konkretisht vendimeve unifikuese nr. 3, datë 27.9.2002 dhe nr. 7, datë 14.10.2011 (*vendimi nr. 7/2011*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është një nga kushtet e domosdoshme në caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, sikurse dhe rreziku i ndërhyrjes në marrjen e provave, rreziku i ikjes së personit ose kryerjes së veprave të tjera penale prej tij, si dhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Vendimet e GJKKO-ve dhe të Gjykatës së Lartë nuk kanë bërë një arsyetim stereotip për plotësimin e kushteve dhe të kriterëve të përgjithshme, por i kanë ballafaquar kërkesat ligjore me rastin konkret dhe veprimet hetimore konkrete të ndërmarra në kuadër të këtij procedimi penal. Vendimmarrjet e GJKKO-ve dhe e Gjykatës së Lartë referojnë në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe në vendimet unifikuese nr. 1, datë 8.1.2009 (*vendimi nr. 1/2009*) dhe nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nuk qëndron arsyetimi i kërkuar se vetë avancimi i hetimeve passjell zbutjen e nevojave të sigurimit si një konstatim

ekstraligjor, i cili nuk i përgjigjet cilësisë që merr subjekti procedural nga personi nën hetim gjatë hetimit paraprak, në të pandehur në çdo shkallë të procesit, që përfundon me vendimin e gjykatës e që bashkëshoqërohet me masën e sigurimit personal, sipas specifikimeve të rastit konkret.

18.4 Për sa i përket pretendimit të kërkuar për *konstatimin e shkeljes të të drejtave dhe lirive themelore të tij, si dhe marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen e rendit kushtetues*, që lidhet me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, mbështetur në nenin 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, kërkuar nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës, pasi vendimi është për shqyrtim në GJKKO-në e Apelit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë disponuar për informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal, duke vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual (30.4.2025) kërkuar vijonte të ishte nën këtë masë sigurimi, që është ndryshuar në vijim



me vendimin e datës 10.10.2025, të GJKKO-së së Apelit, e cila ka vendosur ndaj tij masën “Arresti në shtëpi”. Megjithatë, pavarësisht se në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual masa e sigurimit është zëvendësuar me një masë më të lehtë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Sikurse ka pohuar edhe Gjykata në vendimmarrjen e saj, ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius*, nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar (*shih vendimin nr. 1, datë 17.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, pavarësisht se masa e sigurimit “Arresti në burg” e kundërshtuar nga kërkuesi nuk është më në fuqi për shkak të ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkesë nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se ai ka qenë duke vuajtur një masë të heqjes së lirisë, për të cilën pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohej vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore që lidhen me masat e sigurimit të arrestit në burg, përfshirë ato që kanë të bëjnë me kontrollin periodik të prokurorisë, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës*

Kushtetuese). Prandaj, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore për zëvendësimin e masës së sigurimit, të kundërshtuara nëpërmjet këtij ankimi kushtetues individual, të cilat janë dhënë në vijim të informacionit dymujor të prokurorisë, konsiderohen përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

22. Po në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka theksuar se ai kërkon që kërkuesi t’u jetë drejtuar të gjithave shkallëve të ankimit dhe që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se kërkuesi, në aspektin formal, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara gjykatave të zakonshme të të tria shkallëve të gjyqimit. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij, pasi në datën 30.7.2025, nisur nga gjendja e rënduar shëndetësore, ai i është drejtuar sërish GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me një masë më të butë, por me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka rrëzuar kërkesën e tij, duke vënë në rrezik të drejtpërdrejtë jetën e kërkuetit, për aq kohë sa IEVP-ja, Fier nuk mund t’i ofrojë atij kushte të përshtatshme për gjendjen e tij. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuesi, mbështetur në nenin 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës, pasi vendimi nr. 531, datë 31.7.2025, i GJKKO-së së Shkallës së Parë është ankimuar nga kërkuesi dhe është për shqyrtim në GJKKO-në e Apelit.

24. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konstaton se vendimi nr. 531, datë 31.7.2025, i GJKKO-së së Shkallës së Parë, me të cilin nuk është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues, ndaj,



në këto rrethana, çdo pretendim për këtë vendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata, pasi kërkuesi ka mjete të tjera në dispozicion në lidhje me të.

25. Për pretendimet e tjera që lidhen me kundërshtimin e vendimeve të cituara në objektin e vendimit, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë dhe në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

26. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 4.12.2024, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 6.1.2025, që rezulton të jetë gjithashtu data në të cilën përfaqësuesit ligjor të kërkuesit i është njoftuar në mënyrë elektronike vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

27. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* në ankimin kushtetues individual, kërkuesi i ka parashtruar pretendimet e tij në drejtim të cenimit të: a) lirisë personale në aspekt të mungesës së dyshimit të arsyeshëm dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit personal; b) së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të paanshmërisë, sigurisë juridike dhe prezumimit të pafajësisë.

28. Gjykata, në rastin e masave të sigurimit, ka pohuar se ajo i trajton pretendimet në drejtim të lirisë personale, si e drejtë substanciale, ndërsa pretendimet për proces të rregullt i trajton si aspekte procedurale të lirisë personale, duke u ndalur në aspekte të veçanta, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon të analizojë në themel pretendimet për cenimin e lirisë personale në aspektin procedural dhe në aspektin

substancial lidhur me vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, bazuar në informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme. Në aspektin procedural, Gjykata vëren se ndonëse kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, parimit të sigurisë juridike dhe të prezumimit të pafajësisë, në thelb, pretendimet e tij kanë të bëjnë me vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale, ndaj Gjykata çmon t’i analizojë në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme. Në aspektin substancial, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, Gjykata çmon t’i analizojë në drejtim të parimit të proporcionalitetit për përshtatshmërinë e vazhdimin të masës së kufizimit të lirisë personale.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për aspektin procedural

B.1.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme

29. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit në gjykatën e apelit, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori dhe as nga gjykata e shkallës së parë, duke e rikualifikuar faktin penal, duke rënduar pozitën e kërkuesit e duke caktuar një masë sigurimi ekstreme në mungesë totale të arsytimit. Sipas tij, ndonëse çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë, GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimmarrjen e saj të mëparshme, me doza të thella paragjykimi dhe me bindje të plotë për fajësinë e kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar kërkuesin dhe personat nën hetim si fajtorë, ndonëse çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve, si dhe ka vlerësuar se ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tij dhe të personave të tjerë nën hetim.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi, nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, si dhe e kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarit në fazën e caktimit të masës së



sigurimit. Sipas subjektit të interesuar, parimi i sigurisë juridike nuk qëndron, pasi shkaqet e parashtruara nga kërkuesi kanë për objekt vendimin nr. 18, datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, për më tepër është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 232, datë 26.9.2024, ndaj nuk prodhon efekte të një vendimi gjyqësor për sa i përket arsyes së prishjes së tij.

31. Lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si elementë të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset për këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. GJEDNJ-ja, gjatë shqyrtimit të ankimeve për lirinë personale, ka pohuar se parimi i sigurisë juridike mund të cenohet në rast se gjykatat vendase bëjnë një interpretim të gjerë që mohon garancitë procedurale të parashikuara me ligj (*shih Aydin Sefa Akay kundër Turqisë, datë 23.4.2024, § 115*).

33. Gjykata vëren se në procesin gjyqësor për shqyrtimin e informacionit periodik të prokurorisë dhe të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me një masë më të butë, objekt i ankimit kushtetues individual, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 24.7.2024, nuk është shprehur për kualifikimin e faktit penal, ndërsa GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 31.7.2024, ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme se personat e proceduar penalisht, ndër të cilët edhe kërkuesi, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal si formë bashkëpunimi e posaçme e parashikuar nga nenet 28, pika e katërt, dhe 334, pika e parë, i këtij kodi.

Sipas asaj gjykate, ndryshe nga informacioni në gjykimin për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin, në procesin penal për zëvendësimin e saj, hetimet paraprake të Prokurorisë së Posaçme kanë identifikuar një rreth personash fizikë e juridikë që kanë bashkëvepruar me ata të proceduar tashmë penalisht ose të paproceduar, por të identifikuar, duke u qartësuar me shumë shkalla e lartë e realizimit të fajësisë, përmasat e mëdha të shtrirjes së bashkëpunëtorëve, jashtë dhe brenda institucioneve të shtetit, mënyra e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe kontributi i secilit prej tyre. Për rrjedhojë, sipas GJKKO-së së Apelit, duhet të ndryshohet mënyra sesi GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar dhe ka konkluduar për emërtimin ligjor të fakteve penale historike të provuara në këtë procedim penal, duke mos u pajtuar me kualifikimin juridik të realizuar për to nga Prokuroria e Posaçme. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 4.12.2024, objekt i ankimit kushtetues individual, ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për marrjen e kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprake nga GJKKO-ja e Apelit për kualifikimin ndryshe të bashkëpunimit nga ai i thjeshtë, në grup të strukturuar kriminal, janë marrë në shqyrtim në procesin gjyqësor për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal, në të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 26.9.2024, ka vendosur, ndër të tjera, prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, pasi ka evidentuar se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Prandaj, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit.

34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit për ekzistencën e elementeve të veprave penale të ndryshme nga ato të evidentuara fillimisht, nuk përbën ngritje të një akuze të re ndaj kërkuesit, por lidhet me vlerësimin e nevojave të sigurimit personal dhe analizën e rrethanave konkrete të çështjes. Nga ana tjetër, pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk e ka kthyer çështjen për rigjykim në rastin konkret, evidentimi prej saj i faktit se ky pretendim ishte



trajtuar tashmë dhe se i ishte dhënë përgjigje në procesin gjyqësor të caktimit të masës së sigurimit personal, përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme.

35. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se shkelja e pretenduar nuk ka ndikuar në mënyrë konkrete në vendimmarrjen e gjykatave për masën e sigurimit personal dhe as nuk ka sjellë rëndim të pozitës procedurale të kërkuarit. Për më tepër, për sa kohë kërkuari ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe pretendimet e tij janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, nuk rezulton të jenë cenuar garancitë procedurale të parashikuara nga KPP-ja. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e lirisë personale, në aspektin procedural në drejtim të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, është i pabazuar.

B.2 Për aspektin substancial

B.2.1 Për cenimin e lirisë personale të lidhur me parimin e proporcionalitetit

36. Kërkuari ka pretenduar se GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë nuk e kanë pranuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës “Arresti në burg” me një masë më të lehtë, edhe pse gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve ai nuk ka ndërmarrë ose tentuar ndonjë veprim të çfarëdoshëm për të dëmtuar provat, apo për t’u larguar, duke e bërë masën e caktuar ndaj tij joproporcionale me akuzat në ngarkim të tij dhe me situatën faktike në momentin e caktimit të kësaj mase kur ishin kryer hetimet.

37. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë nuk kanë bërë një arsyetim stereotip për plotësimin e kushteve dhe të kriterëve të përgjithshme, por i kanë ballafaquar kërkesat ligjore me rastin në shqyrtim dhe me veprimet hetimore konkrete të ndërmarra në kuadër të këtij procedimi penal. Vendimmarrja e gjykatave referon në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe në vendimet unifikuese nr. 1/2009 dhe nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

38. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (pika 1) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të

arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (pika 2, shkronja “c”). Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

39. Gjykata ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat gjyqësore për rivlerësimin dhe zëvendësimin e arrestit në burg janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë së personit (shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një masë më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo është caktuar (shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).

40. Gjykata në jurisprudencën e saj gjithashtu ka pohuar se, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, caktimi i arrestit në burg kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një veprë penale (neni 228 i KPP-së), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (neni 230 i KPP-së). Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë edhe të vazhdimin të paraburgimit. Megjithatë ka një dallim të dukshëm midis situatës kur gjykatat shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në këtë rast të fundit, me kalimin e kohës, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk mjafton. Prandaj, organet proceduese duhet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal (shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese).

41. Po në këtë këndvështrim, në lidhje me kohëzgjatjen e arrestit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të



vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në përmbledhje të sa më lart dhe nisur nga konteksti i çështjes në shqyrtim, Gjykata thekson se, në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 27 të saj dhe nenin 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, kalimi i kohës në paraburgim përbën një faktor me rëndësi kushtetuese në kontrollin e vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”. Megjithatë, ai në vetvete nuk sjell automatikisht zëvendësimin ose revokimin e masës, por rëndon barrën e organeve proceduese për të provuar se vijojnë të ekzistojnë kushtet dhe nevojat e sigurimit që e justifikojnë vijimin e paraburgimit. Në këtë kuptim, prokuroria duhet të tregojë se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, ndërsa gjykata duhet të verifikojë, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, jo vetëm vazhdimësinë e dyshimit të arsyeshëm, por edhe nëse arsyet e tjera të paraqitura për mbajtjen e personit në paraburgim mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po ashtu, gjykata duhet të shqyrtojë nëse, me kalimin e kohës, nevojat e sigurimit që kanë përlligjur fillimisht masën vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale, si dhe nëse ato mund të garantohen nëpërmjet garancisë pasurore ose masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë duhet të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij. Kjo nuk përjashton detyrimin e personit të paraburgosur që rrethanat që zbusin nevojat e sigurimit, t’ua bëjë të ditura organeve proceduese konform nenit 260 të KPP-së.

43. Gjykata konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual lidhet me kërkesat e personave nën hetim, ndër të cilët edhe kërkuar,

me objekt shqyrtimin e informacionit dymujor të Prokurorisë së Posaçme për periudhën 28.3.2024–28.5.2024, për ecurinë e hetimeve dhe vlerësimin e kushteve e të kriterëve të zbatimit të masave të sigurimit, si dhe zëvendësimin e masës së sigurimit në zbatim ndaj tij, me një masë sigurimi më të butë. Prandaj, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm veprimet e kryera nga Prokuroria e Posaçme dhe të paraqitura në informacionin dymujor, pra nëse ky i fundit përbënte një informacion formal dhe të përgjithshëm, ose ishte i detajuar në drejtim të forcimit apo zbehjes së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe nëse është respektuar kriteri kushtetues i proporcionalitetit për justifikimin e vijimit të zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”.

44. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, në drejtim të kontrollit mbi ecurinë e hetimeve dhe vlerësimin të diligjencës së organit të hetimit në kryerjen e tyre gjatë zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj personave nën hetim, Prokuroria e Posaçme ka kryer një sërë veprimesh hetimore për procedimin në tërësi, sikurse vendimet e datave 2.4.2024, 22.4.2024, 29.3.2024 (8 vendime) për caktimin e ekspertëve për kryerjen e ekspertimeve teknike të pajisjeve elektronike dhe ato teknike vlerësuese për përcaktimin e marzhit të fitimit të shoqërisë, si dhe mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit objekt procedimi. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkimet e mbrojtjes për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nuk janë të bazuara, pasi kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre, nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime thelbësore e, për pasojë, personat nën hetim vijojnë të jenë në procedim hetimi për të njëjtat fakte, për të njëjtat vepra penale, por duke u paraqitur pozita e tyre në raport me dyshimin e arsyeshëm në një fazë më të avancuar, pasi për disa prej akuzave subjektet kanë marrë cilësinë e të pandehurve. Sipas asaj gjykate, kushtet e posaçme për caktimin e masave të sigurimit dhe ato lidhur me përshtatshmërinë e tyre që konsistojnë në prezencën e rrezikut të ikjes dhe të ndikimit në marrjen dhe vërtetësinë e provave, të vlerësuara më herët gjatë caktimit të masës, janë prezentë në të njëjtën mënyrë dhe masë edhe aktualisht, pasi nuk rezulton të kenë



pësuar ndryshime thelbësore dhe në atë masë që të mund t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndryshëm, për pasojë të jenë të afta të për të ndikuar për ridimensionimin e nevojave të sigurimit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore, pasi personat nën hetim vijnë të hetohen për të njëjtat vepra penale, të cilat mbartin të njëjten rrezikshmëri shoqërore të vlerësuar në momentin fillestar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe të gjetur të drejtë dhe nga gjykata më e lartë që ka shqyrtuar ankimin e personave nën hetim, duke miratuar masat e caktuara prej tyre. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nuk është pretenduar zbulimi i ndonjë rrethane që ka ekzistuar në momentin e caktimit ose të rivlerësimit të masave të sigurimit, e panjohur në atë moment për palët dhe për gjykatën dhe as i ndonjë rrethane të re të ndodhur gjatë zbatimit të masës, e aftë për të ndikuar në ridimensionimin e nevojave të sigurimit, në kuptim të nenit 260, pika 2, të KPP-së. Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkuesi nuk ka argumentuar dhe nuk ka provuar ndryshim të rrethanave faktike dhe/ose ligjore, nuk mund të rivlerësohet edhe njëherë, por në mënyrë të ndryshme, të njëjtat fakte dhe rrethana që janë vlerësuar më herët prej saj. Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nuk rezultojnë të jenë bërë ndryshime të cilësimit ligjor të faktit penal për të cilin procedohet kërkuesi dhe personat e tjerë të pandehur, duke mos përligjur ndryshimin e masës së sigurimit personal me pasojë ridimensionimin e nevojave të sigurimit drejt lehtësimit të tyre, si dhe çështja është ende në fazën e hetimit paraprak dhe nuk rezulton asnjë e dhënë që të përligjë nevojën e zëvendësimit të masës së sigurimit personal.

45. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me arsyetimin se në informacionin hetimor dymujor të Prokurorisë së Posaçme përmendet pikëpamja e ndryshme dhe më e rëndë për kualifikimin ligjor të fakteve nga GJKKO-ja e Apelit. Po kështu, sipas asaj gjykate, në materialin provues të mbledhur, çështja penale ndaj subjekteve të proceduara penalisht është gati për shqyrtim në themel dhe për dy personat nën hetim nuk ka asnjë rrethanë që ka relativizuar rëndësinë juridike dhe faktike të fakteve penale historike, të cilat u atribuohen, përkundrazi ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë

e tyre dhe për aktivizimin e përgjegjësisë penale të rezultuara deri më tani se janë konsumuar sipas pikëpamjes juridike të ndryshme të GJKKO-së së Apelit. Sipas asaj gjykate, pretendimet e kërkuesit për refuzimin ose pasivitetin e Prokurorisë së Posaçme për ta marrë në pyetje për sa dyshohet dhe mosdhënien e mundësisë për të sqaruar pozicionin e tij, janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka zgjedhur me vullnetin e tij të lirë të gjykohet në mungesën e tij fizike dhe të vijojë gjykimin në të dyja shkallët gjyqësore vetëm me prezencën e mbrojtësit të zgjedhur në gjykimin e verifikimit të masës së sigurimit personal, si dhe në gjykimin për zëvendësimin e masës, por edhe kur ka marrë pjesë ka refuzuar të marrë fjalën, të bëjë deklaratime në gjykim ose të pyetet nga gjykata, duke dëshmuar se kërkuesi nuk ka kërkuar të bashkëpunojë ose të kontribuojë në realizimin e hetimit të plotë e të gjithanshëm.

46. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim informacionin dymujor mbi gjendjen e procedimit penal, si dhe kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, ku gjerësisht është arsyetuar se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur. Sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së në kohen e depozitimit.

47. Në këndvështrim të sa më lart, në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të posaçme dhe të Gjykatës së Lartë për informacionin dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, Gjykata konstaton se ato kanë analizuar në mënyrë konkrete nevojën për vijimin e masës së sigurimit, duke vlerësuar se rrethanat që justifikuan vendosjen fillestare të saj vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në momentin e shqyrtimit periodik, si dhe Prokuroria e Posaçme ka treguar dilijencën e duhur



në ushtrimin e ndjekjes penale dhe mbledhjen e provave të mëtejshme.

48. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar kriterin e rrezikut të largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, duke dhënë arsye se përse në këtë rast plotësohet kriteri i nenit 228 të KPP-së, shkronja “b”, dhe të rrezikut për të ndikuar në marrjen dhe vërtetësinë e provave, duke argumentuar në këtë drejtim se kërkuesi në rast se do të gjykohej i lirë ose në një masë tjetër më të lehtë sigurie, do të ndikonte ose do të pengonte procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal, duke vënë kështu në rrezik dhënien e drejtësisë. Arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim është i mjaftueshëm, pasi ai evidenton edhe faktin se prokuroria nuk ka arritur të marrë të gjitha provat që lidhen me procedimin penal, duke mos u zbehur kësioj nevojat e sigurimit.

49. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme nuk janë mjaftuar me një ripërsëritje automatike të arsyeve që kanë justifikuar vendosjen fillestare të masës së sigurimit, por kanë ushtruar një kontroll të përditësuar për domosdoshmërinë e vijimit të saj, çka përmbush kriterin kushtetues të vlerësimit prej gjykatave të zakonshme të nevojave të sigurimit në mënyrë të individualizuar. Në rastin konkret, informacioni dymujor i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme nuk është trajtuar në mënyrë formale ose mekanike, por është analizuar si element i ri në funksion të këtij kontrolli periodik. Nga përmbajtja e vendimeve rezulton se gjykatat, nga pikëpamja kushtetuese, kanë kryer një vlerësim të mjaftueshëm të veprimeve hetimore të ndërmarra gjatë periudhës përkatëse, duke evidentuar personat e pyetur, natyrën e deklarimeve të tyre dhe provat e administruara. Ky informacion është konsideruar si tregues i progresit real të hetimit dhe si element që vazhdon të mbështesë dyshimin e arsyeshëm ndaj kërkuesit.

50. Në këto kushte, në rastin konkret, gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm për proporcionalitetin e vazhdimit të masës, duke arsyetuar edhe në drejtim të “masës së duhur”, pra nëse ajo vazhdonte të ishte e “përshtatshme” në raport me nevojat e sigurimit. Po kështu, ato (gjykatat) në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së vazhdimit të masës së sigurimit personal, krahas rrezikut që diktonte dhe justifikonte vazhdimin e saj, e kanë analizuar dhe vlerësuar atë edhe në raport me

rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe pasojat e ardhura prej saj si dhe pse nuk plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore për zëvendësimin e saj. Gjykatat e zakonshme, krahas analizës së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm dhe dilijencës së prokurorisë, kanë vlerësuar sesi dhe sesa koha e kaluar ka ndikuar dhe diktuar në nevojat e sigurimit, duke konkluduar vijimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Për pasojë, vazhdimi i kufizimit të lirisë personale të kërkuesit nuk rezulton të jetë në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të Kushtetutës, nenin 5, pika 3, të KEDNJ-së, dhe dispozitat ligjore përkatëse të KPP-së që përcaktojnë procedurat e kufizimit të kësaj lirie. Në përfundim të kësaj analize, Gjykata vlerëson se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë, nga pikëpamja kushtetuese, janë të mjaftueshme për të justifikuar vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Për rrjedhojë, pretendimi për *cenimin e lirisë personale në aspektin substancial të lidhur me parimin e proporcionalitetit*, është i pabazuar.

51. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.3.2026.

Shpallur më 10.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Asim Vokshi



VENDIM
Nr. 43, datë 31.3.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim, i,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 31.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 18 (K) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Klodian Rjepaj, përfaqësuar nga avokati Tritan Hamitaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1913, datë 21.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 27, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I”, 135, 141, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71, pika 3, shkronja “e”, dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit Klodian Rjepaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe

Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme, në kuadër të procedimit penal nr. 13, datë 13.1.2020, të regjistruar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim, dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 248 e 25, 258 e 25 dhe 260 të Kodit Penal (*KP*). Në vijim të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim me pasoja të rënda, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i tretë, dhe 25, si dhe 143, paragrafët e dytë dhe të tretë, të KP-së. Ajo prokurori ka regjistruar edhe emrat e autorëve të dyshuar të këtyre veprave, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkesit, ndërsa ky i fundit është dyshuar si autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë, dhe 25, 186, paragrafi i tretë, dhe 25, si dhe 248 dhe 25 të KP-së.

2. Objekt i hetimit janë veprimet/mosveprimet që lidhen me procedurën publike të finalizuar me kontratën e koncesionit të datës 10.12.2015, me objekt dhënien me koncesion/partneritet publik privat të shërbimit publik të ofrimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, me afat 10-vjeçar dhe vlerë totale 9.657.000.000 lekë (pa TVSH), të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë “SaniService” sh.p.k., sikundër edhe veprimet/mosveprimet për zbatimin e kësaj kontrate. Hetimi konsiston mbi dyshimet e ngritura për shkelje të ligjit për sa i përket: i. procedurës së identifikimit të projektit të mundshëm të



koncesionit/partneritet publik privat, nën dyshimin se studimi i fizibilitetit është në shkëlqje të kërkesave të ligjit, duke pasqyruar të dhëna të rreme; ii. procedurës së përgatitjes së dokumenteve standarde të tenderit/koncesionit, nën dyshimin e përcaktimit të kriterëve të zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit në shkëlqje të kërkesave të ligjit, duke paracaktuar fituesin; iii. procedurës së zhvillimit të tenderit/koncesionit dhe shpalljes së fituesit, nën dyshimin e përzgjedhjes së fituesit të paracaktuar; iv. procedurës së negocimit dhe lidhjes së kontratës së koncesionit, nën dyshimin e mospërputhjes së termave të saj me ato të dokumenteve standarde të tenderit/koncesionit në dëm të interesave të shtetit dhe në favor të shoqërisë koncesionare; v. procesit të zbatimit të kontratës së koncesionit, nën dyshimin e shkëlqjes së termave të kontratës në dëm të interesave të shtetit dhe në favor të shoqërisë koncesionare.

3. Kërkuesi ka qenë i ngarkuar me detyrën e zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe të kryetarit të Komisionit të Dhënies me Koncesion/Partneritet Publik Privat (PPP). Në ushtrim të këtij funksioni, kërkuesi ka pasur si detyrë të përgatiste situatën e fizibilitetit të kontratës së koncesionit të sterilizimit, të përlogariste vlerën e saj dhe të përgatiste dokumentet standarde të koncesionit. Ai dyshohet se në kundërshtim me ligjin, megjithëse ishte në dijeni të ekzistencës së strukturës për sterilizim dhe të instrumenteve kirurgjikale, ka vijuar me procedurën për koncesionin. Po kështu, ai dyshohet se, si kryetar i komisionit, ka vendosur miratimin e studimit të fizibilitetit për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale në bazë të të dhënave të pasakta. Në kryerjen e kësaj detyre për kërkuesin është ngritur dyshimi se nuk është bërë asnjë studim i saktë për elementet përbërëse të kostos së këtij shërbimi, duke paraqitur të dhëna të pasakta për numrin, llojin ose kriteret për klasifikimin e kategorive të intensitetit të ndërhyrjeve në spitale që reflektohen në pasqyrat financiare, duke krijuar dëm në buxhetin e shtetit. Po kështu, është ngritur dyshimi se nuk është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i instrumenteve kirurgjikale dhe i pajisjeve të sterilizimit, për të

nxjerrë më pas nevojat reale për plotësimin e nevojave ose zëvendësimin total të tyre. Për këto arsye, kërkuesi dyshohet se, si anëtar i komisionit të dhënies së koncesionit dhe njëkohësisht zëvendësministër i Shëndetësisë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij. Gjithashtu, kërkuesi dyshohet se nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, në kushtet kur më herët ka pasur njohje me një prej ortakëve të shoqërisë fituese të koncesionit, konkretisht me shtetasin I.Rr.

4. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar gjykatës caktimin ndaj personave nën hetim të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, ku për kërkuesin ka kërkuar masën “Arresti në burg”, si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë, dhe 25, 186, paragrafi i tretë, dhe 25, si dhe 248 dhe 25 të KP-së. Për këtë kërkesë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 49, datë 23.6.2023, ndër të tjera, ka vendosur ndaj kërkuesit caktimin e masës “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi është ekzekutuar në datën 17.8.2023 dhe, në vijim, në përputhje me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuesin e arrestuar, me qëllim verifikimin e kushteve dhe të kriterëve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim, me vendimin nr. 102, datë 18.8.2023, ajo gjykatë, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për caktimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 44, datë 4.10.2023, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për rekursin e kërkuesit, me vendimin nr. 00-2024-116, datë 25.1.2024, ndër të tjera, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.



6. Në datën 17.9.2024 kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-116, datë 25.1.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për masën e sigurimit “Arresti në burg”. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 260, datë 8.11.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet e kërkuksit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal të arrestit në burg të lidhur me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, janë haptazi të pabazuara, në kushtet kur masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, që është garantimi i mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, ajo nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me veprën penale për të cilën ai akuzohet, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e kësaj mase.

7. Në datën 27.7.2024 kërkuksi ka paraqitur kërkesë në GJKKO-në e Shkallës së Parë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me një masë më të lehtë. Kërkuksi, ndër të tjera, paraqet si shkaqe për ndryshimin e masës së sigurisë, arsye shëndetësore, faktin që nevojat e sigurimit janë zbutur për shkak të përfundimit të hetimit paraprak, pamundësinë për t’u mbrojtur në mënyrë efektive duke qenë se prej 17 muajsh është në izolim, si dhe rrethana të ndryshme familjare. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 464, datë 26.7.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se nuk ka shkaqe dhe rrethana që zbusin nevojat e sigurimit të kërkuksit, përkundrejt rrethanave të çështjes. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuksi.

8. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 183 (87-2024-262), datë 23.9.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 464, datë 26.7.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke e konsideruar të drejtë atë dhe duke argumentuar se nuk ka rrethana të reja për t’u marrë në konsideratë dhe se me mbylljen e hetimeve është konkluduar me ngritjen e tri akuzave të rënda penale ndaj kërkuksit.

9. Mbi rekursin e kërkuksit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1913, datë 21.11.2024, ka vendosur mospranimin e

rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

10. Në datën 16.6.2025 kërkuksi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, në datën 22.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 24.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuksi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi mungesa e arsyetimit të shkaqeve të rekursit dhe të ankimit në vendim i kanë mohuar atij të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare për problemet shëndetësore të paraqitura me certifikatë mjekësore (diabet mellitus tip 2 dhe obezitet e apne gjumi), të cilat nuk janë vlerësuar dhe nuk janë marrë parasysh nga gjykatat e zakonshme. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk i kanë dhënë përgjigje faktit se vepra penale e mashtrimit nuk konkurren me atë të falsifikimit, ku mashtrimi nuk mund të kryhet nga përfaqësuesi i shtetit, duke u përputhur të dyja cilësitë, ajo e autorit dhe e viktimës së veprës penale. Gjykata e Lartë gjithashtu nuk i ka dhënë përgjigje edhe faktit se në kushtet kur ishte ngritur akuzë për falsifikim dokumentesh, nuk gjente aplikim vepra penale e shpërdorimit të detyrës si dispozitë që zbatohet kur fakti nuk klasifikohet në vepra të tjera penale. Gjykatat e zakonshme nuk kanë disponuar edhe lidhur me faktin se paraburgimi i gjatë e ka rehabilituar kërkuksin dhe ka ulur mundësitë që të kryejë krim, si dhe faktin se me dërgimin e çështjes për gjykim nuk ekzistonte më rreziku për të dëmtuar provat.

11.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për llojet e veprave penale që i janë atribuar kërkuksit, duke anashkaluar edhe detyrimin e saj për t’u përgjigjur për çdo pikë të pretendimeve të tij. Nga ana e të tria gjykatave të zakonshme nuk është arsyetuar në



lidhje me nenin 230, pika 2, të KPP-së që parashikon mosvazhdimin e arrestit në burg për gjendje të rënduar shëndetësore.

11.2. *Liria personale*, pasi nga vendimet e gjykatave rezulton se pas rreth tre vjetësh ka ende konfuzion dhe paqartësi për veprën penale që i atribuohet kërkuesit, duke rënduar pozitën me vepra penale që nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Gjykatat e zakonshme nuk kanë kryer detyrën e tyre për kontrollin e ligshmërisë së akuzave në funksion të dyshimit të arsyeshëm, si dhe ekzistencën ose jo të interesit publik që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Gjykatat e zakonshme, duke mos bërë një vlerësim mbi faktet dhe provat që të provojnë dyshimin e arsyeshëm, bëjnë një shmangie nga misioni për dhënien e drejtësisë.

11.3. *Parimi i proporcionalitetit*, pasi vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë shkaqet që kanë orientuar ato në marrjen e vendimit dhe arsyet se përse vazhdimi i masës ishte i nevojshëm dhe proporcional. Nga aktet e çështjes rezulton se masa e lënë në fuqi është e papërshtatshme, e padrejtë dhe e pa mbështetur në prova të qarta, duke mos u arritur të vërtetohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm. Edhe për sa i takon rrezikut të largimit nga ana e kërkuesit, rrezikut për të kryer krime të tjera, ose situatës shëndetësore të tij, nuk ka pasur një vlerësim të drejtë nga ana e gjykatave që të përligjë masën e sigurimit personal të mbetur në fuqi. Gjykatat nuk kanë vlerësuar as personalitetin e tij duke mos marrë në konsideratë faktin që është familjar, zotëron biznes dhe është i orientuar drejt punës si dhe është në proces doktorature dhe i orientuar drejt studimeve.

12. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të

Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

15. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, si dhe zëvendësimin e saj, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Lidhur me këtë kriter, Gjykata çmon se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, ndaj ai i ka



shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete, Gjykata evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.11.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 16.6.2025. Nga ana e kërkuesit, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *email*-i i dërguar nga Gjykata e Lartë që i ka komunikuar mbrojtësit të tij vendimin e saj në datën 17.2.2025, pra kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

19. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar cenimin e lirisë personale për shkak të rrëzimit të kërkesës së tij, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me një masë më të lehtë, ndërsa ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke pretenduar edhe cenimin e së drejtës së aksesit, atë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e proporcionalitetit. Duke mbajtur parasysh thelbin e pretendimeve, Gjykata vlerëson që pretendimet e kërkuesit t'i analizojë në kuadër të lirisë personale si pasojë e vazhdimit të masës së sigurimit shtrëngues të dhënë ndaj tij, dhe që bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

20. Kërkuesi ka pretenduar se mungesa e arsyetimit të shkaqeve të rekursit dhe të ankimit në vendim i kanë mohuar atij të drejtën për të

marrë një përgjigje përfundimtare për problemet shëndetësore të paraqitura me certifikatë mjekësore, të cilat nuk janë vlerësuar dhe nuk janë marrë parasysh nga gjykatat e zakonshme. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk i kanë dhënë përgjigje për faktin se vepra penale e mashtrimit nuk konkurron me atë të falsifikimit, ku mashtrimi nuk mund të kryhet nga përfaqësuesi i shtetit, duke u përputhur të dyja cilësitë, ajo e autorit dhe e viktimës së veprës penale. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje edhe faktit se në kushtet kur ishte ngritur akuzë për falsifikim dokumentesh, nuk gjente aplikim vepra penale e shpërdorimit të detyrës si dispozitë që zbatohet kur fakti nuk klasifikohet në vepra të tjera penale. Gjykatat e zakonshme nuk kanë disponuar edhe për faktin se paraburgimi i gjatë e ka rehabilituar kërkuesin dhe ka ulur mundësitë që të kryejë krim, si dhe me faktin se me dërgimin e çështjes për gjykim nuk ekziston më rreziku për të dëmtuar provat. Gjykata e Lartë gjithashtu nuk është shprehur për llojet e veprave penale që i janë atribuar kërkuesit, duke anashkaluar edhe detyrimin e saj për t'u përgjigjur për çdo pikë të pretendimeve të kërkuesit. Nga ana e të tria gjykatave të zakonshme nuk është arsyetuar në lidhje me nenin 230, pika 2, të KPP-së që parashikon mosvazhdimin e arrestit në burg për gjendje të rënduar shëndetësore.

21. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se edhe nga vendimet e gjykatave rezulton se pas rreth tre vjetësh ka ende konfuzion dhe paqartësi për veprën penale që i atribuohet kërkuesit, duke rënduar pozitën me vepra penale që nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Gjykatat e zakonshme nuk kanë kryer detyrën e tyre për kontrollin e ligjshmërisë së akuzave në funksion të dyshimit të arsyeshëm, si dhe ekzistencën ose jo të interesit publik që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Gjykatat e zakonshme, duke mos bërë një vlerësim mbi faktet dhe provat që të provojnë dyshimin e arsyeshëm, bëjnë një shmangie nga misioni për dhënien e drejtësisë. Gjithashtu, vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë shkaqet që kanë orientuar ato në marrjen e vendimit dhe arsyet se pse vazhdimi i masës ishte i nevojshëm dhe proporcional. Nga aktet e çështjes rezulton se masa e lënë në fuqi është e papërshtatshme, e padrejtë dhe e pambështetur në



prova të qarta, duke mos u arritur të vërtetohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm. Edhe për sa i takon rrezikut të largimit nga ana e kërkuesit, rrezikut për të kryer krime të tjera, ose situatës shëndetësore të tij, nuk ka pasur një vlerësim të drejtë nga ana e gjykatave që të përligjë masën e sigurimit personal të mbetur në fuqi. Gjykatat nuk kanë vlerësuar as personalitetin e tij, duke mos marrë në konsideratë faktin që është familjar, zotëron biznes dhe është i orientuar drejt punës, si dhe faktin se është në proces doktorature dhe i orientuar drejt studimeve. Subjekti i interesuar nuk ka prapësuar lidhur me parashtrimet e kërkuesit.

22. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*). Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

23. Gjykata ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat gjyqësore për rivlerësimin dhe zëvendësimin e arrestit në burg janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë së personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo është caktuar (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata në jurisprudencën e saj gjithashtu ka pohuar se, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, caktimi i arrestit në burg kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale (*neni 228 i KPP-së*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (*neni 230 i KPP-së*). Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua*

non për vlefshmërinë edhe të vazhdimin të paraburgimit. Megjithatë, ka një dallim të dukshëm midis situatës kur gjykatat shqyrtojnë për herë të parë, "menjëherë" pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në këtë rast të fundit, me kalimin e kohës dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk mjafton. Prandaj, organet proceduese duhet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po në këtë këndvështrim, në lidhje me kohëzgjatjen e arrestit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në lidhje me zbutjen e nevojave të sigurimit për arsye shëndetësore, Gjykata ka përcaktuar tre elemente/kritere referuese: i. kushtet mjekësore të të burgosurit; ii. përshtatshmërinë e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore, të parashikuar sipas kushteve spitalore të burgut; iii. përshtatshmërinë e masës së sigurimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit (*shih vendimin nr. 40, datë 14.5.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në përmbledhje të sa më lart dhe nisur nga konteksti i çështjes në shqyrtim, Gjykata thekson se, në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 27 të saj dhe nenin 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, kalimi i kohës në paraburgim përbën një faktor me rëndësi kushtetuese në kontrollin e vijimit të masës së sigurimit "Arresti në burg". Megjithatë, ai në vetvete nuk sjell automatikisht zëvendësimin ose revokimin e masës, por rëndon barrën e organeve proceduese



për të provuar se vijojnë të ekzistojnë kushtet dhe nevojat e sigurimit që e justifikojnë vijimin e paraburgimit. Në këtë kuptim, prokuroria duhet të tregojë se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, ndërsa gjykata duhet të verifikojë, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, jo vetëm vazhdimësinë e dyshimit të arsyeshëm, por edhe nëse arsyet e tjera të paraqitura për mbajtjen e personit në paraburgim mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po kështu, gjykata duhet të shqyrtojë nëse me kalimin e kohës nevojat e sigurimit që kanë përlligjur fillimisht masën vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale, si dhe nëse ato mund të garantohen nëpërmjet garancisë pasurore ose masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë duhet të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij. Kjo nuk përjashton detyrimin e personit të paraburgosur që rrethanat që zbusin nevojat e sigurimit t'ua bëjë të ditura organeve proceduese konform nenit 260 të KPP-së.

28. Referuar nenit 260, pika 2, të KPP-së, gjykata e zëvendëson masën e sigurimit me një tjetër më të lehtë kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, ose dënimit që mund të caktohet. Ndërsa në pikën 2 të nenit 230 të po këtij kodi, mes të tjerave, parashikohet se “Arresti në burg” nuk mund të vendoset ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë.

29. Për sa më lart, si dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjkata vlerëson të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në gjykimin për kërkesën e zëvendësimit të masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për nevojën e vazhdimin të arrestit në burg dhe nëse kanë verifikuar pretendimet e kërkuarit për zbutjen e masës së sigurimit për shkak të problemeve të tij shëndetësore, si dhe për mungesën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, dhe rrezikun që ai të largohet. Gjithashtu, Gjkata do të analizojë nëse gjykatat e zakonshme i kanë

dhënë përgjigje kërkuarit për pretendimet e tij në lidhje me kualifikimin e veprave penale që i janë atribuar.

30. Duke iu rikthyer rastit konkret, konstatohet se procesi është vënë në lëvizje me kërkesën e kërkuarit si person nën hetim, për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë tjetër të përshtatshme (*in melius*). Kjo kërkesë u paraqit në kohën kur kërkuari ishte nën masën e sigurimit të arrestit në burg prej rreth 1 viti e 10 muajsh. GJKKO-ja e Shkallës së Parë për këtë kërkesë ka arsyetuar se ndryshe nga momenti procedural i caktimit të masës së sigurimit ndaj tij, kërkuarit ndërkohë i ishte komunikuar akuza, ndaj ai nuk gjendej më vetëm në kushtet e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprave penale, por se organi akuzës në këtë fazë kishte konkluduar mbi prova duke i komunikuar akuzën për tre veprat penale që i atribuoheshin. Gjithashtu, ajo gjykatë ka çmuar se pretendimi për mungesën e provave për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me veprën penale “Mashtrimi”, nuk mund të ishte objekt vlerësimi thelbësisht në këtë lloj gjykimi, por do të analizohej gjatë seancës paraprake.

31. GJKKO-ja e Shkallës së Parë gjithashtu ka arsyetuar se kërkuarit i ishte komunikuar akuza për tre vepra penale, të cilat, sipas asaj gjykate, paraqisnin një rrezikshmëri të lartë dhe parashikonin një marzh të lartë dënimi (deri në 10 vjet), çka, sipas saj, nuk sjellin zbutje faktike të çështjes, të tilla që të krijojnë bindjen te gjykata për zëvendësim të intensitetit të masës së sigurisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se rreziku për kontaminimin e provave nuk kishte përfunduar pavarësisht se kishin përfunduar hetimet paraprake duke u dërguar çështja në seancë paraprake, pasi në eventualitet gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë ta kthejë çështjen për hetime të mëtejshme. Gjithashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistonte edhe risku i ikjes jashtë vendit për sa kohë që kërkuari kishte jetuar për një periudhë jashtë vendit edhe më parë. Ndërkohë, për sa u takon kushteve shëndetësore të kërkuarit, ajo gjykatë ka arsyetuar se diagnozat e tij janë të tilla që mund të trajtohen edhe në mjediset e spitalit të burgut. Në përfundim, duke analizuar faktet, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konkluduar se nuk ishin kushtet për zëvendësimin e masës së sigurisë (*in melius*).



32. GJKKO-ja e Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuarit, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. GJKKO-ja e Apelit, në të njëjtën linjë me shkallën e parë, ka konkluduar se në fazën procedurale ku ndodhesh çështja, nuk mund të konkludohej për parashtrimet e mbrojtjes mbi themelësinë e akuzave penale të njoftuara atij. Sipas saj, do të ishte proceduralisht në vlerësimin e gjyqtarit të seancës paraprake për të disponuar për kushtet e procedueshmërisë të gjykimit në themel të këtij procedimi penal. Nga ana tjetër, arsyeton ajo, do të jetë në juridiksionin e plotë faktik dhe ligjor të gjykatës së themelit për të disponuar qoftë mbi plotësimin e kushteve të procedueshmërisë dhe themelësisë ose meritave të akuzave që Prokuroria e Posaçme i ka kundërdrejtuar kërkuarit.

33. Gjithashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se në kushtet kur nuk ka rrethana të reja që të ndryshojnë kriteret e masave të sigurimit, gjykatat që do të gjykojnë kërkesat për zëvendësim mase janë të detyruara me fuqinë e gjësë së gjykuar të përmbahen në vendimet e dhëna. Për sa i takon gjendjes shëndetësore, ajo gjykatë ka argumentuar edhe faktin se nuk është provuar që infrastruktura shëndetësore penitenciare nuk mund të trajtojë problematikën shëndetësore të kërkuarit. Lidhur me shkaqet e apelit që evokojnë nevojën e kërkuarit për të vijuar studimet doktorale apo edhe për të drejtuar biznesin që ai ka, ajo gjykatë ka vlerësuar se këto kufizime në ushtrimin e së drejtës për arsim apo edhe të drejtës për realizimin e iniciativës së lirë ekonomike kufizohen nga masa e sigurimit e caktuar ndaj tij, ku sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe neneve 229 dhe 230 të KPP-së, kufizimi i lirisë personale të të pandehurit në këto kushte vlerësohet të jetë proporcional dhe i diktuar si nevojë dhe domosdoshmëri e gjendjes faktike penale historike që e ka shkaktuar atë.

34. Kolegji Penal, nga ana e tij, lidhur me rekursin e kërkuarit ka arsyetuar se vendimet e gjykatave të faktit kanë disponuar drejt dhe se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Ai Kolegji në vijim ka arsyetuar se vendimet e gjykatave të faktit kanë disponuar drejt për kërkimin për zëvendësimin e masës së sigurisë, duke u dhënë përgjigje të argumentuara të gjitha pretendimeve të kërkuarit dhe kryesisht atyre që kanë të bëjnë me shkaqet shëndetësore. Ai kolegji ka vlerësuar se

gjendja shëndetësore e kërkuarit është element i pranuar nga praktika gjyqësore që mund të sjellë zëvendësimin e masës së sigurimit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ka arsyetuar Kolegji Penal, në disa vendime ka përcaktuar tre kriteret referues: a) kushtet mjekësore të të burgosurit; b) përshtatshmërinë e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore të parashikuar në burg; c) garantimin e masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të kërkuarit. Nga tërësia e verifikimeve dhe akteve të shqyrtuara nga gjykatat e faktit, Kolegji Penal ka çmuar se kërkuari në këtë proces nuk përfshihet në asnjë nga këto situata. Gjykatat e posaçme, sipas tij, kanë verifikuar këtë pretendim, duke argumentuar se, referuar akteve të administruara, si dhe vetë deklarimeve të kërkuarit, nuk rezulton që ai të ketë pasur probleme të tilla shëndetësore që nuk janë trajtuar dot në mjediset e paraburgimit ose që paraburgimi të ketë përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore në raport me atë përpara paraburgimit. Pra, Kolegji Penal ka konkluduar se në rastin konkret nuk është arritur të provohet gjendja shëndetësore veçanërisht e rëndë dhe për me tepër nuk është provuar as pamundësia e organeve shëndetësore të paraburgimit për të monitoruar dhe trajtuar kërkuarin sipas protokolleve dhe standardeve në fuqi.

35. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë personale të kërkuarit është vendosur dhe lejuar të vijojë me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat fillimisht dyshohej e më pas akuzohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit në procesin e rishqyrtimit të masës së sigurimit, të nisur nga kërkuari, kanë arsyetuar mjaftueshëm duke konkluduar me të drejtë se nuk ekzistonin kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e saj. Ky vendim i tyre është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nëpërmjet mospranimit të rekursit të kërkuarit.

36. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerëson se në kushtet kur tashmë kërkuarit i ishte komunikuar akuza nga ana e Prokurorisë së Posaçme, organi akuzës kishte konkluduar me prova konkrete, duke e akuzuar atë për kryerjen e tri veprave penale. Në këtë kuadër, dyshimi i arsyeshëm nuk ishte zbehur, por forcuar në atë



nivel sa i kishte dhënë shkak komunikimit formal të tre akuzave, të cilat nga gjykatat e zakonshme janë shpjeguar se paraqisnin rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

37. Gjykata gjithashtu vëren se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet e kërkuarit për zbutjen e shkaqeve që diktonin vijimin e masës. Konkretisht, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar për pretendimin për mungesën e rrezikut të ikjes, duke e konsideruar atë prezent për sa kohë që kërkuari kishte jetuar për vite të tëra jashtë vendit. GJKKO-ja e Apelit, nga ana e saj, me të drejtë, ka arsyetuar se, për sa kohë që nuk kishte ndryshim rrethanash, nuk mund të kishte as ndryshim të kriterëve të masës së sigurimit. Këto konkluzione janë konsideruar të drejta edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vlerësuar se nuk kishin ndryshuar nevojat e sigurimit, pasi as nuk ekzistonin rrethana të reja të krijuara pas caktimit të masës, si dhe masa i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe marzheve të mundshme të dënimit të parashikuara në veprat penale për të cilat ai tashmë akuzohet. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk janë paraqitur fakte ose rrethana të reja të cilat do të ndryshonin nevojat e sigurimit të kërkuarit për kushtet e veçanta të përcaktuara në nenin 228, pika 3, të KPP-së.

38. Gjithashtu, lidhur me pretendimin e kërkuarit se gjykatat nuk janë shprehur për llojet e veprave penale që i janë atribuar atij, duke anashkaluar edhe detyrimin e tyre për t'u përgjigjur për çdo pikë të pretendimeve të kërkuarit, Gjykata evidenton faktin se në fazën procedurale ku ndodhej çështja, gjykatat e zakonshme nuk mund të konkludonin mbi parashtrimet e mbrojtjes, të cilat ishin kompetencë e gjyqimit të themelit të çështjes.

39. Për sa u takon pretendimeve të kërkuarit për situatën e tij shëndetësore, Gjykata vëren se të tria gjykatat e zakonshme kanë analizuar faktet dhe provat duke dhënë përgjigje të argumentuara për pretendimet lidhur me gjendjen shëndetësore të tij dhe mundësinë e trajtimit në sistemin shëndetësor penitenciar. Konkretisht, Gjykata vlerëson se nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është arsyetuar vazhdimi i masës së sigurimit të arrestit në burg, bazuar edhe në tre kriteret referuese të përcaktuara nga GJEDNJ-ja. Në rastin konkret, nga aktet e çështjes janë

konsideruar kushtet mjekësore të kërkuarit si jo të rënda, duke mos u arritur të provohet se paraburgimi i ka përkëqësuar situatën e tij shëndetësore (*kriteri i parë*); nuk është arritur të provohet pamundësia e mjekimit në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit, si dhe as pamundësia e institucionit mjekësor për ta monitoruar e trajtuar kërkuarin sipas protokolleve dhe standardeve mjekësore të duhura (*kriteri i dytë*); verifikimi i vazhdimësisë së masës së sigurimit të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore (*kriteri i tretë*).

40. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të vijimit të zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” janë të pabazuara për sa kohë që nuk ka ndryshim të ndonjë rrethane ose fakti, si dhe për arsye se masa vijon t'i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe marzheve të mundshme të dënimit mbi veprat penale për të cilat kërkuari i është komunikuar tashmë akuza. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuarit për nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e vijimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së. Në këtë optikë, arsyetimi i vendimeve nga ana e gjykatave të zakonshme nuk është abstrakt, por është i individualizuar sipas rrethanave të çështjes konkrete.

41. Për sa më sipër, masa e sigurimit e vendosur vijon të zbatohet për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, ndaj ajo nuk duket të jetë joproporcionale, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për vijimin e saj. Gjykatat e zakonshme, krahas analizës së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm dhe dilijencës së treguar nga prokuroria, kanë vlerësuar se si dhe sa koha e kaluar ka ndikuar dhe diktuar në nevojat e sigurimit, duke konkluduar për vijimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se urdhërimi i gjykatave të zakonshme për vazhdimin e paraburgimit të kërkuarit duket se është i justifikuar mbi tregues specifike të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë së tij, tejkalon rregullin e



respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së.

42. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 31.3.2026.

Shpallur më 11.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Klodian Rjepaj, me objekt shfuqizimin e vendimit gjyqësor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin, në përgjigje të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me një masë më të lehtë, është konfirmuar vijimi i masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuarit, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar, për shkak se pretendimet e kërkuarit për cenimin e lirisë personale në drejtim të parimit të proporcionalitetit janë të bazuara.

2. Në mbështetje të neneve 132, pika 3, të Kushtetutës dhe 72, pika 8, të Ligjit Organik të

Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

3. Në kuadër të hetimeve rreth kontratës me objekt dhënien me koncesion/partneritet publik privat të shërbimit publik të ofrimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë “SaniService” sh.p.k., Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar gjykatës caktimin ndaj kërkuarit të masës së sigurimit personal me karakter shtrengues “Arresti në burg”, si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë dhe 25, 186, paragrafi i tretë, dhe 25, si edhe 248 dhe 25 të KP-së. Mbi këtë kërkesë është vendosur masa e kërkuar, duke u konfirmuar në të tria shkallët e gjyqësorit. Në datën 27.7.2024 kërkuari ka paraqitur kërkesë pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” me një masë më të lehtë. Kjo kërkesë është rrëzuar në të tria shkallët e gjyqësorit, duke u bërë shkas për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues mbi vendimet përkatëse të gjykatave të zakonshme.

4. Kërkuari ka pretenduar para Gjykatës, në thelb, se vazhdimi i masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij nuk ishte më proporcionale, duke i cenuar atij, për pasojë, lirinë personale të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës. Në mbështetje të pretendimit të tij kërkuari ka sjellë, ndër të tjera, si argument edhe gjendjen e tij jo të mirë shëndetësore. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të vërtetojnë as dyshimin e arsyeshëm si kusht i përgjithshëm *sine qua non* për justifikimin e heqjes së lirisë, as proporcionalitetin e masës së sigurimit në kushtet kur gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar siç duhet për ekzistencën e kushteve të veçanta që justifikojnë heqjen e lirisë të parashikuar nga neni 228, pika 3, i KPP-së. Së fundi, kërkuari ka sjellë si argument rrethanat që lidhen me personalitetin e tij, faktin që është familjar, zotëron biznes dhe është i orientuar drejt punës, si dhe faktin se është në proces doktorature dhe i orientuar drejt studimeve.



5. Në shqyrtimin e kërkesës shumica ka dalë me përfundimin se pretendimet e kërkuarit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të vijimit të zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, janë të pabazuara për sa kohë që nuk ka ndryshim të ndonjë rrethane ose fakti, si dhe për arsye se masa vijon t’i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe marzheve të mundshme të dënimit mbi veprat penale për të cilat kërkuarit i është komunikuar tashmë akuza. Shumica e ka bazuar qëndrimin e saj në faktin se gjykatat e zakonshme i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuarit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e vijimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, duke arsyetuar në veçanti për rëndësinë e gjendjes shëndetësore të kërkuarit dhe mundësinë e trajtimit të saj brenda IEVP-së, rrezikun e ikjes së tij në rast të lirimit nga paraburgimi dhe mundësinë e dëmtimit të provave në hipotezën e një vendimi të gjyqtarit të seancës paraprake që e kthen çështjen për hetime të mëtejshme nga prokuroria (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Në këtë optikë shumica ka arritur në përfundimin se masa e sigurimit e vendosur vijon të zbatohet për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, ndaj ajo nuk duket të jetë joproporcionale, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për vijimin e saj. Sipas shumicës, gjykatat e zakonshme, krahas analizës së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm dhe dilijencës së treguar nga prokuroria, kanë vlerësuar se si dhe sa koha e kaluar ka ndikuar dhe diktuar në nevojat e sigurimit, duke konkluduar për vijimin e masës së sigurimit të arrestit në burg (*shih paragrafin 41 të vendimit*).

6. Përpara se të shtjellojmë qëndrimin tonë të pakicës, mendojmë të sjellim në vëmendje ato pjesë të jurisprudencës relevante të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, të cilat, në optikën tonë, i përshtaten më ngushtësisht veçorive të situatave kur objekt i kontrollit në gjykimin kushtetues janë pretendimet për cenimin e lirisë personale si rezultat i vendimeve gjyqësore që vendosin vijimin e kufizimit të lirisë në kontekstin e një procedimi penal në të cilin është vendosur më herët caktimi i masës së sigurimit personal “Arresti në burg”.

7. Kështu Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat

gjyqësore për rivlerësimin dhe zëvendësimin e arrestit në burg janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë së personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo është caktuar (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Po kështu, Gjykata ka pohuar se, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, caktimi i arrestit në burg kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një vepër penale (*neni 228 i KPP-së*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (*neni 230 i KPP-së*). Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë dhe vazhdimin e paraburgimit. Megjithatë ka një dallim të dukshëm midis situatës kur gjykatat shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në këtë rast të fundit, me kalimin e kohës, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk mjafton. Prandaj organet proceduese duhet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Po në këtë këndvështrim, në lidhje me kohëzgjatjen e arrestit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).



10. Për sa i takon vlerësimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, në kontekstin e shqyrtimit të pretendimeve për cenimin e nenit 5 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka theksuar se rreziku i largimit duhet të vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal (*shih Becciev kundër Moldavisë, datë 4.10.2005, §§ 58-59*). Sipas GJEDNJ-së, këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i autoriteteve për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip (*shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë, [DhM], datë 28.11.2017, § 222*). Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vendimi i saj, nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 5/3 të KEDNJ-së do të merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §§ 89-91*).

11. Në përmbledhje të standardeve të sipërcituara dhe në zhvillim të tyre, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi të mendimit se në interpretim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 27 të saj dhe nenin 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, kalimi i kohës në paraburgim përbën një faktor me rëndësi kushtetuese në vlerësimin nëse masa e sigurimit “Arresti në burg” duhet të vijojë ose të zëvendësohet me një masë më të butë. Thënë ndryshe, gjykatat duhet të vlerësojnë nëse, me kalimin e kohës, nevojat e sigurimit që kanë përligjur fillimisht masën e arrestit në burg vazhdojnë të jenë të pranishme në kohën kur shqyrtohet kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit. Po kështu, gjykatat duhet të vlerësojnë nëse nevojat e sigurimit dhe mbarëvajtja e procedimit penal mund të garantohen nëpërmjet garancisë pasurore ose masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë lypset të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, në referim të fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur për të provuar arsyet që justifikojnë lirin e tij.

12. Sigurisht që ne pajtohemi me qëndrimin e shumicës se faktori “kohë e kaluar në paraburgim” deri në çastin e shqyrtimit të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë më të lehtë siguri nuk sjell automatikisht zëvendësimin ose revokimin e masës. Por theksojmë se ky element duhet kuptuar si një

rrethanë që rëndon proporcionalisht me kohën e kaluar, duke ua kaluar barrën autoriteteve proceduese për të provuar se vijnë të ekzistojnë kushtet dhe nevojat e sigurimit që e justifikojnë vijimin e paraburgimit. Në vlerësojmë se në respekt të elementit kushtetues “kohë e kaluar në paraburgim”, në shqyrtimin e kërkesave për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” gjykatat duhet të sigurohen se prokuroria ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, dhe të sigurohen, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, jo vetëm për vazhdimësinë e dyshimit të arsyeshëm (si kusht i përgjithshëm e i domosdoshëm), por edhe nëse kushtet e tjera të parashikuara nga neni 228/3 i KPP-së, të vlerësuara nga gjykatat në kohën e caktimit të masës së arrestit, mbeten aktuale dhe, si të tilla, justifikojnë vijimin e mbajtjes së individëve në paraburgim. Thënë ndryshe, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë thelbësore të lirisë personale të individëve dhe, në këtë kuadër, të natyrës përjashtimore të paraburgimit si një masë që mund të justifikohet vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale, në kontekstin e shqyrtimit të kërkesave për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, gjykatat duhet të bëjnë një vlerësim *ex novo* të të gjitha kushteve dhe kriterëve të cilat ishin verifikuar prej saj menjëherë pas arrestimit.

13. Duke e parë çështjen e kërkuarit në prizmin e skicuar më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi të mendimit se arsyetimi i gjykatave të zakonshme në çështjen konkrete përmban mangësi në analizën e proporcionalitetit të masës në drejtim të nevojës për vazhdimin e zbatimit të paraburgimit. Në leximin që ne u bëjmë vendimeve të tyre, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar se ka dy rreziqe ose ndryshe nevoja siguri, referuar kushteve të veçanta të përcaktuara në pikën 3 të nenit 228. Ato gjykata kanë vlerësuar se kërkuari paraqet rrezik të largohet, fakt ky që në vlerësimin tonë nuk i përgjigjet situatës së fakteve të çështjes dhe personalitetit të tij, duke mbajtur parasysh këtu se ai është familjar, orientimin e tij drejt studimeve doktorale, faktin se është drejtues i një subjekti tregtar dhe në tërësi lidhjen e tij me vendin. Po ashtu, edhe argumentet se ekzistojnë rrethana nga të cilat krijohet vlerësimi se ka rrezik



eminent që liria e pakushtëzuar e kërkuarit mundet të helmojë provat ose të kontribuojë në prishjen e tyre, në një rast eventual të kthimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake për hetime të mëtejshme, është, së pari, hipotetik dhe, së dyti, nuk duket të jetë bindës aq më tepër në kushtet kur kërkuari nuk e ushtron më detyrën si zëvendësministër ose ndonjë funksion tjetër publik, gjë e cila mund t'i mundësonte atij helmimin, në një mënyrë ose tjetër, të provave ose intimidimin e dëshmitarëve.

14. Jemi të mendimit se ky argument përforcohet edhe nga fakti që dispozitat procedurale penale kanë përcaktuar se kur vihet në rrezik marrja e provave, masa e sigurimit caktohet me afat (*neni 245 i KPP-së*) dhe jo pa afat, siç ka ndodhur në rastin e kërkuarit.

15. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar sa duhet lidhur me praninë dhe aktualitetin e kushteve specifike konkrete që justifikojnë vijimin e masës “Arresti në burg”, ndërkohë që është kërkuar nga kërkuari zëvendësimi i saj me një masë më të lehtë *in melius*. Me fjalë të tjera, nuk duket që gjykatat e zakonshme të kenë vlerësuar përshtatshmërinë e ndonjë mase sigurimi alternative përtej deklarimeve të thjeshta formale të tyre, pavarësisht kërkesave të kërkuarit, ndërkohë që i kanë kaluar atij barrën e provës lidhur me efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit shëndetësor penitenciar në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore.

16. Duke mbajtur në konsideratë sa më lart, vlerësojmë se, në kushtet kur kriteret e mësipërme nuk janë analizuar mjaftueshëm në raport me nenin 17 të Kushtetutës nga gjykatat e zakonshme, vendimet e tyre nuk janë mjaftueshëmrisht të individualizuara në referencë të rrethanave dhe fakteve të rastit të kërkuarit dhe, si të tilla, nuk arrijnë të justifikojnë vijimin e masës më të rëndë të sigurimit “Arresti në burg”. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë, në rolin e saj si gjykatë ligji dhe në rolin e gjykatës që ushtron kontrollin subsidiar ndaj gjykatave të zakonshme, duke dështuar ta ushtrojë këtë funksion, nëpërmjet një vendimi *de plano*, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke i vlerësuar si të pabazuara pretendimet e kërkuarit. Në këtë kuadër, ne mendojmë se si procesi gjyqësor për

vijimin e masës së sigurimit “Arresti në burg, ashtu dhe qëndrimi i shumicës nuk kanë përmbushur qëllimin kushtetues të parandalimit të heqjes së pajustificuar të lirisë personale. Për rrjedhojë, vlerësojmë se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale, i parë në raport me parimin e proporcionalitetit, është i bazuar.

17. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuari është i bazuar, pasi masa e sigurimit që vijon të zbatohet ndaj tij nuk është proporcionale, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e pjesës së kërkesës dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 48, datë 8.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 8.4.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (I) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ilir Metaj, përfaqësuar nga avokatët Kujtim Cakrani dhe Dylejman Karaj, me akt përfaqësimi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Sotir Killapi dhe Arben Kraja.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, drejtues madhor Ilir Proda.

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.



OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 125, datë 20.10.2024, dhe nr. 130, datë 23.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 59 (87-2024-333), datë 19.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-364 (57), datë 27.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Ilir Metaj (*kërkuari*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*Policia e Shtetit*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, administroi materialet me shkrim nga Avokati i Popullit, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 55 të vitit 2019 (*procedimi penal nr. 55/2019*) për veprat penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 245/1, 248 dhe 260 të Kodit Penal (KP).

2. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale të emrit të

kërkuarit si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga neni 260 i KP-së.

3. Po kështu, në datat 10.6.2022 dhe 23.6.2022, mbi bazën e kallëzimit të një shtetasi, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar ndaj kërkuarit dhe personave të tjerë dy procedime penale me nr. 122 dhe nr. 125, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 190, paragrafi i tretë, 257/a, 259 dhe 287 të KP-së. Në vijim, Prokuroria e Posaçme, në datën 24.6.2022, ka bërë bashkimin e procedimeve nr. 122 dhe nr. 125 në një procedim të vetëm me nr. 122/2022.

4. Në datën 15.9.2022 Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimit të një shtetasi tjetër, ka regjistruar ndaj kërkuarit dhe bashkëshortes së tij procedimin penal nr. 165, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Fshehja e të ardhurave”, “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 180, 245, 257/a, 259 dhe 287 të KP-së. Në vijim, prokuroria ka vendosur bashkimin e procedimit nr. 165 me procedimin nr. 122/2022.

5. Në datën 7.10.2024 Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e procedimeve penale të emrit të kërkuarit si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” në tre raste, nga të cilat në dy raste të kryer në bashkëpunim; “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë; “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i



rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi i dytë dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së. Në datën 7.10.2024 prokuroria ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. 55/2019 dhe nr. 122/2022 në një të vetëm, duke e numërtuar atë me nr. 55/2019.

6. Në funksion të hetimit janë kryer veprimet hetimore përkatëse, për secilin nga faktet e pretenduara dhe në analizë të tyre organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kërkuesi ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të korrupsionit pasiv, të parashikuar nga neni 260 i KP-së, në tre raste: a) *rasti i parë* lidhet me një kontratë shërbimi në fushën e energjisë elektrike, për sigurimin e së cilës kërkuesi, përmes influencës dhe ndikimit që ka pasur, fillimisht si ministër i Jashtëm dhe më pas si ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, ka kërkuar dhe ka marrë përfitime të parregullta financiare në formën e shumave të konsiderueshme të parave që sipas deklarimeve të kallëzuesve kërkohej vlera 5.000.000 euro; b) *rasti i dytë* lidhet me marrjen e lejes për shtrirjen e fibrave optike të internetit dhe për një kontratë interkonjeksioni ndërkombëtare (terminimi i thirrjeve), për të cilën kërkuesi, përmes influencës dhe ndikimit që ka pasur si Kryetar i Kuvendit dhe si kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet (LSI), së bashku me bashkëshorten e tij kanë marrë përfitime të parregullta financiare në formën e mbulimit të shpenzimeve familjare të kryera jashtë vendit (Angli, San Marino, Austri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)) dhe transaksioneve monetare, përfitimit të kartave të kreditit, shpenzimeve për arsimimin e fëmijëve dhe përfitimeve të tjera; c) *rasti i tretë* lidhet me miratimin/ndryshimin e ligjit në sektorin minerar, me qëllim favorizimin e një subjekti në këmbim të përfitimit të paligjshëm të një vile. Po ashtu, organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kërkuesi ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, në prani të dy rrethanave cilësuese, më shumë se një herë dhe në bashkëpunim, lidhur me: *së pari*, nënshkrimin e kontratave të lobimit me kompani që vepronin në

SHBA, marrjen e shërbimeve nga këto kontrata, pagesat e padeklaruara për shërbimet e ofruara dhe financimin në shuma të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat jashtë Shqipërisë nga llogari të padeklaruara prej tij dhe mosdeklarimin e shpenzimeve sipas ligjit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ); *së dyti*, blerjen e banesës në vitin 2009, duke përdorur si truk marrjen e kredive bankare, shlyerja e të cilave është bërë më pas me shuma të konsiderueshme parash, të cilat as nuk i ka pasur dhe as nuk ka pasur mundësi t'i siguronte, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka arritur në konkluzionin se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kërkuesi (dhe bashkëshortja e tij) ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të mosdeklarimit të llogarive bankare dhe shpenzimeve në deklaratat e pasurive vjetore, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, si dhe mosdeklarimin e shpenzimeve të plota për shkollimin e fëmijëve, llogarive dhe depozitave bankare dyemërore në shumat 100.000 paunde (100.000 euro), shpenzimeve mjekësore të kryera në periudhën 2013–2019 në klinikat jashtë vendit (Austri dhe San Marino), si dhe shpenzimeve të tjera.

7. Në këto kushte, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar nga gjykata caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, sipas parashikimeve të neneve 228, 229, 230, 234, 237, 238 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë), me vendimin nr. 125, datë 20.10.2024 (*vendimi nr. 125/2024*), ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” për kërkuesin, me argumentin se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ai ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë, 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së, të kryera në disa raste edhe në bashkëpunim me persona të tjerë të dyshuar.

8. Në datën 22.10.2024, bazuar në nenin 248 të KPP-së, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë për marrjen në pyetje, si dhe verifikimin e kushteve dhe të kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit.



9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 130, datë 23.10.2024 (*vendimi nr. 130/2024*), ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, me argumentin se në gjendjen që janë aktet ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ai ka konsumuar elementet e veprave penale për të cilat dyshohet nga akuza.

10. Ndonëse kërkuesi ka ushtruar ankim, vendimet nr. 125/2024 dhe 130/2024 janë lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 59 (87-2024-333), datë 19.11.2024, mbështetur në të njëjtën linjë arsyetimi të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-364 (57), datë 27.2.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të rekursuar, me argumentin se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk janë të bazuara, si të tilla nuk cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit.

12. Në datën 10.7.2025 kërkuesi i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 18.7.2025. Me vendimin e datës 24.10.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 5.11.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Kërkuesi ka depozituar në datën 9.12.2025 parashtrimet e tij me shkrim, duke paraqitur në përmbajtje kërkesën paraprake për gjykimin e çështjes në seancë plenare publike me praninë e tij personalisht dhe të medias, si dhe shtimin në objekt të kerkimit për vleftësimin si antikushtetues e në kundërshtim të hapur me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) të arrestimit të tij në datën 21.10.2024 dhe lirimimin e menjëhershëm. Pas paraqitjes së prapësimeve të Prokurorisë së Posaçme, kërkuesi në datën 23.12.2025 ka depozituar sërish parashtrime me shkrim.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

13.1. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues*, të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, pasi në momentin e arrestimit nga agentët e Policisë së Shtetit është ushtruar dhunë ndaj tij. Arrestimi ka ndodhur në kohën kur automjeti me të cilin lëvizte u bllokua qëllimisht nga disa automjete private, pa shenja identifikuese dhe pa asnjë mbishkrim policor, nga shumë persona të armatosur rëndë e me maska, të veshur me uniforma të zeza, pa logo, pa distinktivë ose shenja dalluese, të cilët rrethuan zonën në një nga kryqëzimet më të ngarkuara të Tiranës, duke krijuar një atmosferë terrori për qytetarët e pranishëm. Ai u nxor forcërisht nga automjeti me të cilin udhëtonte, u rrëmbye me dhunë, u tërhoq zvarrë mes publikut, me një trajtim kriminal, denigrues dhe degradues, pa iu komunikuar asnjë vendim gjyqësor dhe pa iu lexuar të drejtat që i takonin dhe në mënyrë të dhunshme u detyrua forcërisht të hipte në një nga automjetet private që i bllokuan rrugën. Megjithëse mënyra e arrestimit është ankimuar përpara të gjitha gjykatave më të ulëta, përveç faktit që është publikisht e njohur, asnjë hetim, as administrativ, as gjyqësor, në asnjë lloj forme, nuk ka filluar në lidhje me të, ndaj i takon Gjykatës të japë një përgjigje si në aspektin material, ashtu edhe në atë procedural. Mënyra dhe forma e dhunshme e arrestimit të tij me filmime publike nuk ishin rreptësisht të nevojshme dhe nuk u shkaktuan nga sjellja e kërkuesit dhe asnjë nga gjykatat nuk ka vlerësuar karakterin absolutisht të nevojshëm të mënyrës së arrestimit. Kjo mënyrë synonte të poshtëronte dhe të ulte dinjitetin e tij, duke iu nënshtruar mjaftueshëm një trajtimi poshtërues dhe denigrues në prag të zgjedhjeve politike të 11 majit 2025 si mesazh frikësues për përkrahësit e opozitës. Kjo ka sjellë edhe cenimin e *së drejtës për respektimin e jetës së tij private dhe familjare*, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së. Po kështu, meqenëse rrethanat e ndalimit lidhen me veprimet e Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit (*BKH*) dhe/ose Policisë së Shtetit, barra e provës i takon prokurorisë që parimisht duhet të ofrojë një shpjegim bindës për to. Veprimet ndaj tij



përbëjnë një sulm personal ndaj integritetit politik e personal.

13.2. *Të drejtën për t'u informuar për kufizimin e lirisë*, të garantuar nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi nuk është informuar për arsyet e arrestimit dhe natyrën e akuzave kundër tij. Asnjë nga organet e ngarkuara me ligj nuk ka bërë një përshkrim të saktë të veprave penale dhe nuk ka përcaktuar natyrën e saktë të veprimit penal që i atribuohet atij. Akuza paraqitet me terma të përgjithshëm, të tillë si “dyshohet se ka bashkëpunuar me persona të tjerë në aktivitet kriminal”, por mungojnë veprimet konkrete që lidhen me aktin kriminal, çka nënkupton se veprat penale janë të paqartësuara dhe tërësisht mbi baza dyshimesh dhe hamendësimesh. Urdhri i prokurorit është mbështetur në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale të vitit 1998, i cili nuk është më në fuqi prej 4 vjetësh, pasi është shfuqizuar, duke e bërë atë ligjrisht të pavlefshëm.

13.3. *Të drejtën për liri dhe siguri*, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi, në aspektin procedural, ndaj tij është ushtruar dhunë nga forcat speciale në momentin e arrestimit dhe ka munguar komunikimi i akuzës, e drejta për kujdes shëndetësor, për kontakt me familjen dhe e drejta për t'u mbrojtur me një avokat. Në aspektin substancial, liria personale e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës është cenuar, pasi arrestimi në burg nuk i përgjigjet situatës faktike dhe as nevojave që justifikuan fillimisht caktimin e kësaj mase, si dhe nuk merr në konsideratë personalitetin, statusin e tij dhe funksionet kushtetuese që ai ka ushtruar si ish-President i Republikës, ish-Kryeministër, ish-Kryetar i Kuvendit, disa herë ministër dhe së fundmi president i Partisë së Lirisë, partia e dytë opozitare dhe partia e tretë politike në Shqipëri në 20 vjetët e fundit. Ai nuk ka tentuar të largohet dhe as të pengojë drejtësinë, madje është ndaluar duke hyrë në Shqipëri dhe nuk është përpjekur të rrezikojë ndonjë nga interesat në lidhje me paraburgimin.

13.4. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi masa e sigurimit “Arresti në burg” është më e rënda dhe duhet të përdoret vetëm kur masat më të lehta nuk janë të mjaftueshme, ndërkohë që asnjë nga gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm se përse nuk mund të aplikohet një masë më e lehtë. Gjykatat nuk mund të miratojnë automatikisht kërkesën e prokurorisë për

masën shtrënguese të heqjes së lirisë, pa bazë ligjore dhe pa akuzë të saktë dhe vazhdimi i paraburgimit me arsyetim të pamjaftueshëm është joproporcional. Arresti është arbitrar dhe pa bazë ligjore, ndërkohë që çdo kufizim duhet të jetë i ligjshëm, i domosdoshëm dhe jo arbitrar. Nuk tregohet lidhja direkte e personit nën hetim dhe veprave penale për të cilat pretendohet se po hetohet. Për më tepër, paraburgimi po zgjatet përtej një afati të arsyeshëm, pa justifikim konkret dhe pa baza. Autoritetet nuk tregojnë kujdes për të përparuar me hetimin ose gjykimin në mënyrë efikase, ndërkohë që masa e paraburgimit përdoret për të goditur indirekt një person pa vendim përfundimtar fajësie.

13.5. *Lirinë e shprehjes*, të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ-së, pasi për shkak të masës “Arresti në burg” atij i është kufizuar kjo liri si përfaqësues politik i opozitës. Për shkak të komunikimit të tij me avokatin dhe nëpërmjet tij me mediat, ai është dënuar me masë disiplinore nga komisioni disiplinor në institucionin ku mbahet i izoluar, ndërkohë që nuk ka asnjë dispozitë që ta ndalojë. Ky veprim ndëshkues është në vazhden e represionit dhe dhunës psikologjike që përdorin ndaj tij institucionet në varësi nga qeveria dhe posaçërisht nga Kryeministri. Po kështu, mosndërhyrja ose indiferenca e autoriteteve për këtë situatë vërteton se kjo sjellje është e koordinuar po nga vetë autoritetet më të larta të vendit, si Kryeministri dhe ministri i Drejtësisë, si persona që kanë në varësi institucionet e paraburgimit.

13.6. *Të drejtën për t'u zgjedhur*, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, pasi për shkak të kufizimit të lirisë ai është vënë në pamundësi për të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025 për të bërë fushatë në krye të partisë së tij dhe të udhëheqë opozitën që ai përfaqëson jo vetëm për të marrë vota si kandidat i veçantë, por edhe për partinë. Sjellja e prokurorisë dhe gjykatës haptazi ka një qëllim politik: të ndalojë kërkesën të bëjë fushatë dhe të drejtojë forcën e tij politike gjatë fushatës zgjedhore. Këtë e provon edhe fakti se gazetarët janë penguar të filmojnë momentin e votimit të tij në institucionin ku qëndron i izoluar. Izolimi i tij i pabazuar dhe i pajustificuar ka sjellë privimin e ushtrimit të funksionit publik si president i partisë së dytë opozitare në prag të zgjedhjeve të 11 majit 2025.

13.7. *Parimin e mosdiskriminimit për arsye politike dhe barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i



Kushtetutës, pasi arrestimi i kërkuesit është pjesë e një strategjie të përhershme për të goditur me anë procedurash gjyqësore kundërshtarët politikë. Aktet dhe veprimet kundër tij janë nxitur dhe motivuar politikisht në prag të zgjedhjeve parlamentare të datës 11 maj 2025. Prokuroria ka pasur një agjendë të fshehur dhe ka qenë mjaftueshëm e ndikuar politikisht nga shumica qeverisëse për diskreditimin politik të kërkuesit. Gjykatat, mbi të njëjtat fakte dhe dyshime për kryerjen e veprave penale, kanë vendosur masa të ndryshme ndaj të dyshuarve të tjerë që janë pjesë e të njëjtit hetim, edhe pse janë në të njëjtat kushte dhe dyshohen të kenë kryer vepra të njëjta.

13.8. *Të drejtën për proces të rregull ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

13.8.1. *Së drejtës së aksesit*, për shkak të mënyrës sesi gjykatat kanë trajtuar rastin e tij, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të rëndësishme lidhur me ligshmërinë e procesit të ndalimit, si dhe interpretimin e dispozitave procedurale që parashikojnë kriteret dhe kushtet për caktimin e masës. Edhe pse në dukje gjykatat kanë analizuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet, referuar përmbajtjes së tyre rezulton në mënyrë të qartë se në rastin e kërkuesit ka pasur vetëm disa kallëzime, aludime e dyshime, ndërkohë që nuk ka asnjë provë konkrete që të jetë në atë nivel që të mbështesë *dyshimin e arsyeshëm*. Nga ana tjetër, gjykatat nuk kanë analizuar rrezikun që paraqet kërkuesi për t'iu shmangur hetimit dhe për të kryer vepra të tjera më të rënda ose të të njëjtit lloj, cila është sjellja e mëparshme e tij e lidhur me personalitetin apo si ai i është shmangur më parë dënimit me burgim, si dhe se ekziston mundësia e rrezikut që ai të largohet. Aksesit duhet të jetë substancial dhe jo formal.

13.8.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykatat kanë favorizuar në mënyrë të dukshme prokurorinë, duke i marrë si plotësisht të mirëqena provat e paraqitura nga akuza dhe duke refuzuar pa arsye kërkesat e mbrojtjes; kanë gjykuar me paragjykim; kanë dhënë opinion për fajësinë pa përfunduar gjykimi; nuk kanë dëgjuar në mënyrë të barabartë palët, por kanë ndërprerë në mënyrë sistematike avokatin mbrojtës; nuk kanë përdorur gjuhë neutrale, pasi i janë referuar kërkuesit me termat “fajtor” ose “recidivist”, ndërkohë që gjykimi

nuk ka përfunduar dhe ai nuk ka qenë asnjëherë i dënuar më parë nga asnjë gjykatë. Kjo mënyrë sjelljeje ka cenuar edhe *parimin e prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës. Në aspektin institucional gjykatat që kanë shqyrtuar dhe vendosur për masën e sigurimit ndaj tij nuk janë të pavarura dhe të paanshme në sytë e një vëzhguesi objektiv, pasi gjyqtarët janë nën mbikëqyrje sistematike dhe sistematike nga hetuesit për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (ligji nr. 95/2016).

13.8.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk janë logjike, janë arbitrare dhe të njëanshme në arsyetimin e tyre, si dhe nuk paraqesin një vlerësim të drejtë dhe proporcional për akuzat që rëndojnë mbi kërkuesin, kohën e pretenduar të veprave penale të supozuara se janë kryer dhe rrezikshmërinë shoqërore të tij. Vendimet e gjykatës janë kopje e kërkesës së organit të prokurorisë. Gjykatat nuk kanë arsyetuar për vendosjen e masës duke mbajtur në konsideratë kuadrin e përgjithshëm të fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/ personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi, si dhe nëse masa është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Nuk ka asnjë element në arsyetimin e tyre që të tregojë se çfarë hetimesh synohen të kryhen dhe sesi kërkuesi mund të prishë ose të helmojë provat për sa kohë ai nuk ka asnjë funksion shtetëror dhe koha e kryerjes së këtyre veprave që pretendon akuza është shumë e largët. Gjykatat nuk kanë arsyetuar për ekuilibrin që duhet të ekzistojë midis të drejtave kushtetuese dhe interesit për mbarëvajtjen e procedimit penal ndaj tij, se përse masat e tjera të sigurimit nuk mund të përmbushin qëllimin legjitim, si dhe pse kërkuesi paraqet rrezik të largohet ose të helmojë/dëmtojë provat.

14. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1. Për sa i takon pretendimit për *cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtroar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues*, prokuroria nuk ka qenë pjesë e ekzekutimit të vendimit, ndërsa taktika e ndjekur dhe plani operacional i ekzekutimit nuk janë kompetencë e prokurorit, por e Policisë së Shtetit. Nuk ka asnjë praktikë që prokurori të vihet në dijeni



për këto plane. Çdo person i arrestuar ka të drejtën e një trajtimi dinjitoz në çdo fazë të procesit. Procesverbali i ekzekutimit është i vetmi akt procedural që dokumenton mënyrën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe në këtë rast ky akt është nënshkruar “pa vërejtje” nga kërkuesi, i cili është asistuar nga mbrojtësi i tij. Për ekzekutimin e urdhrit janë ngarkuar oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët gëzojnë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, ndaj nga pikëpamja procedurale janë respektuar kërkesat e parashikuara nga KPP-ja. Intensiteti i përdorur dhe veprimet e tjera janë objekt i procedimit penal që është regjistruar aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) me nr. 477 të vitit 2025, i cili vazhdon të jetë në fazën hetimore, ndaj është e nevojshme të priten konkluzionet e atij hetimi.

14.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u informuar për kufizimin e lirisë nuk qëndron, pasi në rastin konkret është ndjekur e njëjta procedurë standarde për ekzekutimin e urdhrit, duke iu dorëzuar vendimi gjyqësor dhe urdhri i prokurorit një oficeri të Policisë Gjyqësore të rolit të lartë drejtues në Policinë e Shtetit, i cili ka marrë shkresën përcjellëse dhe aktet bashkëlidhur kundrejt nënshkrimit. Urdhri i ekzekutimit nuk është i paligjshëm vetëm se në të është referuar një ligj i shfuqizuar, pasi bëhet fjalë për një lapsus, gabim material në numrin e ligjit, gjë e cila nuk e afekton vendimin për dhënien e masës së sigurimit dhe as vlefshmërinë e vet urdhrit. Për më tepër, urdhri është bazuar edhe në nenin 466 të KPP-së, i cili nuk ka ndryshuar që nga viti 1995 kur është miratuar kodi. Kërkuesi është njohur brenda një kohe të shkurtër me vendimin, ndërkohë nuk mund të pretendohet që atij t’i dorëzohej vendimi dhe të pritej deri sa të njihet me të në kushtet kur është arrestuar në një rrugë me qarkullim të shtuar. Urdhri i ekzekutimit nuk ka asnjë tejkallim të vendimit të gjykatës dhe çështja e pavlefshmërisë së tij mund të shqyrtohet nga gjykatat e zakonshme dhe jo nga Gjykata. Nga ana tjetër, kërkuesi brenda 72 orëve ka dalë para gjykatës, e cila ka vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit. Për më tepër, kërkuesi mbahet nën masën e sigurimit personal për shkak të urdhërimeve në dispozitivin e vendimit të gjykatës dhe jo mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit të prokurorit. Po kështu, është dokumentuar që

kërkuesit i është siguruar takimi me mbrojtësin menjëherë, pasi është shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë së Tiranës dhe mbrojtësi ka nënshkruar procesverbalin.

14.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për liri dhe siguri është i pabazuar, pasi vlerësimi i rrezikut për shmangien nga drejtësia dhe i helmimit të provave është vlerësuar edhe nga rrethanat e faktit. Kufizimi i lirisë së kërkuesit është bërë mbi bazën e një vendimi gjyqësor, i cili vazhdon të jetë në fuqi dhe është detyrues dhe i zbatueshëm.

14.4. Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar dhe prokuroria vijon të mbajë qëndrimin se masa e sigurimit personal ka qenë proporcionale jo vetëm në kohën e caktimit të saj, por edhe aktualisht, duke marrë në konsideratë jo vetëm ato që janë cituar nga gjykatat në vendimet e kundërshtuara, masën e dënimit të parashikuar nga dispozitat, dënimin e pritshëm në rast se do të rezultojë fajtor, por edhe sjelljen e kërkuesit gjatë hetimit dhe aktualisht në gjykimin para gjyqtarit të seancës paraprake. Për sa i takon proporcionalitetit të masës dhe respektimit të diligjencës, këto janë çështje që i takojnë vlerësimit të gjykimin të zakonshëm dhe jo gjykimin kushtetues, pavarësisht kësaj, masa e caktuar është proporcionale në lidhje me faktet që i atribuohen kërkuesit. Proporcionaliteti lidhet jo vetëm me marzhin e dënimit që parashikon vepra penale e pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, e cila është kryer dy herë dhe në bashkëpunim, por edhe me rrezikshmërinë, sjelljen dhe qasjen e kërkuesit ndaj hetimit, si dhe faktin që për të justifikuar pamjaftueshmërinë e burimeve financiare ai ka përfshirë edhe shtetas të tjerë që janë bërë pjesë e procesit penal. Mundësia e intimidimit të dëshmitarëve në rastin e kërkuesit ekziston për shkak të personalitetit të tij dhe se shumica e tyre kanë qenë në pozicione varësie me të, si në aspektin politik, ashtu edhe institucional. Gjithashtu, në rastin e kërkuesit nuk është konstatuar asnjë rrethanë për zbutjen e nevojës së masës së sigurimit personal të arrestit në burg.

14.5. Pretendimi për cenimin e lirisë së shprehjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur, që lidhet me trajtimin e kërkuesit në institucionin e paraburgimit, marrin përgjigje nga legjislacioni në këtë fushë dhe nuk mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues. Kërkuesi pretendon për ngjarje të ndodhura pas datës 20.10.2024 dhe 23.10.2024, kur janë marrë vendimet



e GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin dhe verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit personal. Për rrjedhojë, argumentet e kërkuarit nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi kushtetues, por ai si i paraburgosur ka të drejtat dhe instrumentet e duhura për t'i bërë ato objekt të vlerësimit dhe kontrollit gjyqësor jashtë këtij gjykimi.

14.6. Pretendimi për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi në rrethanat specifike: kërkuari akuzohet për më shumë vepra penale/episode /akuza se të gjithë të pandehurit e tjerë, në aspektin sasior; disa nga veprat penale ai i ka kryer me bashkëshorten e tij, e cila, sikurse rezulton e provuar nga aktet, ka pasur probleme shëndetësore dhe ka marrë trajtim mjekësor të specializuar; shkalla e fajësisë dhe e mendimit kriminal në disa nga akuzat e ngritura ndaj tij është më e rëndë në raport me të pandehurit e tjerë; dy prej të pandehurve janë në moshë të thyer, mbi 70 vjeç, kurse njëra nga të pandehurat ka rrethana familjare dhe ekonomike specifike.

14.7. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, sepse:

14.7.1. Gjykatat u kanë kthyer përgjigje të argumentuara pretendimeve të kërkuarit, duke i garantuar *të drejtën e aksesit*. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm është bazuar në provat e mbledhura gjatë fazës së hetimit dhe në kriteret e parashikuara në nenin 228 të KPP-së, të cilat janë trajtuar gjerësisht dhe mjaftueshëm nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë. Gjykatat nuk e kanë zhvendosur barrën e provës të kërkuarit dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, ndaj nuk qëndron as pretendimi për cenimin e parimit të *prezumimit të pafajësisë*.

14.7.2. Lidhur me *gjykimin e paanshëm*, për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, pretendimet kanë marrë tashmë përgjigje me vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës. Argumentet e kërkuarit se ai është nën masën “Arresti në burg” pa akuzë dhe se Gjykata e Lartë e ka paragykuar si “recidivist” për të njëjtat vepra penale nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Tashmë ka një praktikë të unifikuar se caktimi i masës së sigurimit si veprim procedural nuk lidhet me cilësinë e personit gjatë procesit, statusin e tij dhe as me ecurinë e procesit penal, por mjafton që personi të jetë nën hetim, pra të jetë regjistruar emri i tij në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Termi “recidivist” lidhet me një

cilësim të veçantë të autorit të veprës penale, kur ky i fundit kryen më shumë se një herë të njëjtën veprë penale, ndaj, në këto rrethana, ky term jo vetëm nuk është diskriminues/paragykues, pasi është një term doktrinar, por në rastin konkret nuk është përdorur në një kuptim (konotacion) të tillë gjuhësor. Ai është përdorur për faktin se kërkuari është akuzuar në tre raste për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv dhe në dy raste për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, në njërin rast në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë.

14.7.3. *Arsyetimi i vendimeve gjyqësore* përmbush standardet kushtetuese, pasi gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me mënyrën e arrestimit dhe se përse në rastin e kërkuarit nuk mund të aplikohet një masë sigurimi më e butë, si dhe për nevojën e vazhdimet të zbatimit të masës “Arresti në burg”. Gjykatat kanë pasqyruar tërësinë e fakteve/ngjarjeve ashtu siç janë administruar në gjykim, si dhe mënyrën sesi janë analizuar dhe vlerësuar provat. Vendimet gjyqësore nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese. Ato përmbajnë një arsyetim të plotë dhe të detajuar të pretendimeve të parashtruara para gjykatave. Vlerësimi i rrezikut për shmangien nga drejtësia dhe i helmimit të provave është vlerësuar edhe nga rrethanat e faktit. Në kohën që po kryheshin hetimet, të pandehurit e këtij procesi janë pyetur në cilësinë e personave që kishin dijeni për veprën penale dhe ata janë njohur me disa konkluzione të atëhershme të hetimit: pamjaftueshmërinë thelbësore të burimeve të ligjshme monetare dhe mospërputhjen e deklaratave të pasurisë me gjendjen financiare dhe me burimet e pasurive të krijuara. Po kështu, kërkuari dhe bashkëshortja e tij kanë pasur influencë mbi individë të tjerë, të cilët i kanë tërhequr në veprime të paligjshme. Rreziku për shmangien nga përgjegjësia penale nëpërmjet prishjes/helmimit të provave, por edhe ndikimit të persona të tjerë, qoftë edhe të dëshmitarët, ka qenë dhe mbetet eminent edhe 2 vjet pas nisjes së hetimeve.

15. *Subjekti i interesuar, Policia e Shtetit*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtuar trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues* nuk qëndron, pasi për sa i përket anës procedurale urdhri i Prokurorisë së Posaçme është ekzekutuar nga



oficerët e Policisë Gjyqësore të sektorit për hetimin e grupeve kriminale pranë drejtorisë për hetimin e krimit të organizuar në departamentin e policisë kriminale të Drejtorisë Vendore të Policisë së Tiranës. Ndërsa për sa u përket veprimeve në terren për gjetjen, ndalimin dhe shoqërimin e kërkuesit janë ngarkuar punonjësit e Policisë së Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale. Shkaqet dhe arsyet e përdorimit të forcës fizike nga punonjësit e policisë janë bërë për nxjerrjen nga automjeti dhe shoqërimin e kërkuesit, i cili ka kundërshtuar me veprime konkrete dhe ka përdorur fjalë ofenduese ndaj punonjësve të policisë. Nga ana e punonjësve të policisë është përdorur forca minimale e nevojshme në proporcion të drejtë me reagimin e kërkuesit për dërgimin në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë së Tiranës, pasi në momentin e ndërhyrjes kërkuesi ka filluar të mbahet, duke u shtrënguar në pjesë të ndryshme të automjetit. Në këto kushte ai është tërhequr nga krahët për ta dërguar në automjetin tjetër. Përdorimi i forcës ka qenë në proporcion të drejtë dhe të arsyeshëm nga pikëpamja e intensitetit, kohëzgjatjes dhe shkallës së shtrirjes së saj në përputhje me rezistencën fizike dhe verbale të bërë nga kërkuesi. Punonjësit e policisë kur kanë kryer shoqërimin e kërkuesit nuk kanë qenë të pajisur me kamera trupore dhe, për rrjedhojë, nuk disponohen pamje filmike të shoqërimit të tij, kurse lidhur me veshjen, simbolet dhe përdorimin e maskës nga punonjësit e policisë, ato janë të normuara në procedurat standarde të punës të miratuara me urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Arrestimi i kërkuesit është kryer mbi bazën e një vendimi gjyqësor, ndërsa kërkuesi ka kundërshtuar fizikisht ekzekutimin e vendimit, duke detyruar policinë të përdorë forcë të arsyeshme për neutralizimin e rezistencës. Videoja e publikuar në media tregon përdorimin e forcës, por ky veprim është i justifikuar nga rreziku i moszbatimit të vendimit gjyqësor dhe rezistenca e kërkuesit. Nuk ka elemente të sjelljes poshtëruese ose denigruese në veprimet e kryera nga policia, të cilat kanë qenë të kufizuara vetëm për ekzekutimin e urdhrit gjyqësor. Nuk ka prova që policia ka vepruar me qëllim poshtërimitin e kërkuesit, veprimet ishin teknike dhe të duhurat për ekzekutimin e urdhrit.

15.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u informuar për kushtetimin e lirisë është i pabazuar, pasi përveç procesverbalit të ekzekutimit të vendimit

penal dhe kontrollit personal, kërkuesit i është dhënë në kohë edhe karta e të drejtave të personave të ndaluar dhe arrestuar. Në momentin e ndalimit kërkuesit i është bërë qartësisht e ditur nga ana e punonjësve të policisë masa e sigurimit “Arresti në burg” e caktuar nga gjykata e posaçme, urdhri i prokurorit lidhur me këtë vendim dhe shoqërimi në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë së Tiranës. Ndonëse nga ana e policisë është kërkuar disa herë që kërkuesi të qetësohej dhe se duhej të njihej e të zbatonte vendimin e gjykatës, të cilin punonjësi kërkonte t’ia vinte në dispozicion, nga ana e kërkuesit është kundërshtuar vazhdimisht me ofendime, duke mos pranuar urdhrat e ligjshëm të policisë. Në përfundim të veprimeve procedurale është bërë dërgimi i kërkuesit në ambientet e dhomave të sigurisë dhe materialet i kanë kaluar Prokurorisë së Posaçme me shkresën e datës 21.10.2024.

15.3. Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit për ekzekutimin e urdhrit nuk qëndron, pasi forca është përdorur vetëm në masën e nevojshme dhe për të kapërcyer rezistencën. Përdorimi i forcës në rast rezistence nuk përbën shkelje kur është e justifikuar dhe e kontrolluar. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pranuar se përdorimi i forcës gjatë arrestimit është konsideruar i ligjshëm kur personi ka kundërshtuar autoritetin e policisë si në rastin e kërkuesit. Policia ka detyrimin të zbatojë vendimet gjyqësore dhe të garantojë rendin publik. Mosveprimi i policisë do të përbënte shkelje të ligjit dhe pengim të drejtësisë. Veprimet e kryera janë të dokumentuara dhe të kontrolluara nga organet e drejtësisë. Arrestimi i kërkuesit është kryer në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe vendimin gjyqësor. Përdorimi i forcës ka qenë i domosdoshëm dhe proporcional, pa elemente poshtërimit ose denigrimi. Kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e tij në nivel kushtetues, por është përqendruar në mënyrën sesi është ndjekur procedura gjyqësore.

16. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.



III

Procesi në gjykimin kushtetues

17. Kërkuesi në parashtrimet shtesë që mbajnë datën 9.12.2025, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, ka parashtruar dy kërtime të reja: i. gjykimin e çështjes në seancë plenare publike me praninë e tij personalisht dhe të medias; ii. vleftësimin si antikushtetues e në kundërshtim të hapur me KEDNJ-në të arrestimit të tij në datën 21.10.2024 dhe lirim të menjëhershëm.

18. Lidhur me *kërkimin e parë*, kërkuesi ka argumentuar se rasti i tij është unik jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë ku një ish-president, ish-kryeministër, ish-kryetar i Kuvendit dhe drejtues aktual i forcës së dytë opozitare në vend arrestohet në mënyrë brutale nga dhjetëra persona të maskuar e të armatosur rëndë që pasi bllokuan trafikun e prangosën me forcë atë dhe drejtuesin e automjetit, që është njëkohësisht funksionar politik i Partisë së Lirisë, pa asnjë urdhër gjyqësor. Kërkuesin e nxorën me dhunë nga automjeti, e tërhoqën zvarrë në publik, duke iu nënshtuar një trajtimi haptazi degradues dhe kriminal, ndërsa gjatë gjithë arrestimit nuk i është komunikuar asnjë vendim gjyqësor, as urdhërarrestit dhe as nuk i është lexuar karta e të drejtave, duke iu mohuar garancitë themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja. Sipas kërkuesit, gjykimi duhet të bëhet në prani të palëve dhe të tij për t'i dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe se qytetarët e Shqipërisë duhet të dinë më në fund dhe publikisht nëse arrestimi i bërë në mënyrë brutale është ose jo në përputhje me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe se shembulli i tij duhet të vendosë standardet që duhet të respektojë policia dhe cilito kryeministër ndaj cilito personi të akuzuar, në mënyrë që ky rast unik të shërbejë për të ardhmen.

19. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim në fillim të seancës së datës 8.4.2026, në kuadër të vlerësimit të kërkesave paraprake dhe në përfundim të shqyrtimit votat e gjyqtarëve u ndanë duke mos u arritur kuorumi i kërkuar nga neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 72, pika 2, i Ligjit Organik

të Gjykatës, ndaj, në këto kushte, bazuar në nenin 73, pika 4, të po këtij ligji, kërkimi konsiderohet i rrëzuar. Sipas *njërit qëndrim*, çështja duhej shqyrtuar në seancë plenare publike me praninë e palëve, duke mbajtur në konsideratë jo vetëm natyrën e pretendimeve, por edhe parashtrimet e kërkuesit për interesin publik që shfaqte çështja në raport me funksionet e larta shtetërore që ai ka mbajtur. Çështja e kërkuesit në mars të vitit 2026 ka kaluar në fazën e gjykimit dhe sipas rregullave të përgjithshme procedurale i nënshtrohet parimit të seancës publike. Në këtë kuptim, si dhe duke mbajtur në konsideratë aktet e paraqitura, nuk rezultojnë të dhëna që të evidentojnë nevojën e ruajtjes së sekretit hetimor ose mbrojtjen e të dhënave të tjerëve.¹ Ndërsa sipas *qëndrimit tjetër*, kërkimi duhej të rrëzohej, pasi forma e gjykimit, bazuar në nenin 21, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, është vendosur nga Mbledhja e Gjyqtarëve gjatë vendimmarrjes për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në përputhje me mënyrën e zakonshme të shqyrtimit të ankimeve kushtetuese individuale. Në këtë drejtim, është mbajtur parasysh, se: zhvillimi i seancës publike mund të ndikonte në mbarëvajtjen e procedimit penal, si dhe respektimin e sekretit hetimor dhe të të drejtave të personave të tjerë të përfshirë; kontrolli kushtetues përqendrohet në vlerësimin e akteve dhe të pretendimeve juridike të palëve; palët kishin mundësi efektive për të paraqitur pretendimet, prapësimet dhe provat me shkrim; çështja nuk paraqiste nevojë për debat dhe deklarime me gojë ose sqarime faktike që nuk mund të vlerësoheshin mbi bazën e materialeve të administruara. Në rrethanat e rastit nuk rezulton ndonjë element që të përlligjë ndryshimin e formës së gjykimit.²

20. Për sa i takon *kërkimit të dytë*, kërkuesi ka argumentuar se arsyeja e vetme për të cilën ai ndodhet nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ka humbur çdo bazë dhe objektivisht është e pamundur që ai të ndikojë në prova ose intimidimin e dëshmitarëve. Sipas kërkuesit: i. në datën 26.5.2025 ai është marrë në cilësinë e të pandehurit nga Prokuroria e Posaçme dhe po në

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Fiona Papajorgji dhe gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Asim Vokshi.

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimiri dhe Marjana Semini.



këtë datë i është komunikuar edhe akuza; ii. në datën 28.7.2025 Prokuroria e Posaçme ka njoftuar përfundimin e hetimeve në lidhje me çështjen, duke e njohur me aktin e përfundimit të hetimeve dhe duke e pyetur tashmë në cilësinë e të pandehurit; iii. në datën 29.8.2025 dosja hetimore së bashku me provat e mbledhura dhe kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq i janë dorëzuar gjykatës; iv. në datën 10.11.2025 Prokuroria e Posaçme ka nxjerrë vendimin për plotësimin/saktësimin e akuzës. Përballë këtyre fakteve, rezulton se Prokuroria e Posaçme i ka dorëzuar të gjitha provat që i përkasin një periudhe të mëparshme 10-vjeçare në zyrën e gjyqtarës së seancës paraprake dhe ai nuk ka asnjë funksion shtetëror, nuk ka asnjë imunitet dhe nuk ka asnjë mundësi për cenimin e tyre. Ndërkohë që për dy funksionarë të tjerë (S.B. dhe zëvendëskryeministren) gjykatat nuk kanë caktuar një masë të tillë shtrënguese kaq të ashpër. Kështu, për zëvendëskryeministren, në datën 22.11.2025 gjykata e posaçme ka vendosur vazhdimin e masave të sigurimit personal të ndalimit të daljes jashtë shtetit dhe të pezullimit të ushtrimit të detyrës. Për më tepër, masa e sigurimit “Arresti në burg” për një ish-president vështirë se mund të konsiderohet proporcionale në vendet demokratike dhe, siç tregojnë shembujt ndërkombëtarë, trajtimi i figurave të tilla shpesh përfshin masa më pak kufizuese, të tilla si arresti në shtëpi, pagimi i një shume garancie ose detyrim paraqitjeje.

21. Gjykata vëren se ndonëse kërkuesi nuk e ka parashtruar këtë kërkim në mënyrë të shprehur si shtesë të objektit të ankimit kushtetues individual, nga paraqitja formale e ka listuar si numërtim shtesë në objektin e parashtrimeve. Sipas nenit 43/b, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa. Ndërkohë, argumentet mbështetëse të këtij kërkitimi në thelb lidhen me antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore që kanë disponuar caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, pra të vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, Gjykata nuk e konsideron atë proceduralisht si kërkim të veçantë dhe vlerëson ta analizojë në vijim.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor penal ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

24. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se, në aspektin procedural, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka



shteruar në formë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, për rrjedhojë vendimi që ka përmbyllur procesin gjyqësor, ai i Gjykatës së Lartë, konsiderohet përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues.

26. Në lidhje me aspektin substancial, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtuar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, me argumentin se në momentin e arrestimit nga agjentët e Policisë së Shtetit është ushtruar dhunë ndaj tij (*shih paragrafin 13.1. të vendimit*). Përkundër këtij pretendimi, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se intensiteti i përdorur dhe veprimet e kryera janë objekt i procedimit penal që është regjistruar aktualisht në Prokurorinë e Tiranës me nr. 477 të vitit 2025, i cili vazhdon të jetë në fazën hetimore, ndaj është e nevojshme të priten konkluzionet e atij hetimi (*shih paragrafin 14.1. të vendimit*). Kurse subjekti tjetër i interesuar, Policia e Shtetit, ka prapësuar se përdorimi i forcës fizike nga punonjësit e policisë ka qenë i domosdoshëm dhe proporcional e ka pasur për qëllim nxjerrjen nga automjeti dhe shoqërimin e kërkuesit, i cili ka kundërshtuar me veprime konkrete dhe ka përdorur fjalë ofenduese ndaj punonjësve të policisë (*shih paragrafët 15.1. dhe 15.3. të vendimit*). Gjithashtu, Avokati i Popullit ka vënë në dispozicion materialet e administruara në kuadër të hetimit administrativ për vlerësimin e sjelljes, veprimeve dhe mosveprimeve të punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të vendimit penal për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, si dhe rekomandimet për rastin drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe për dijeni ministrit të Brendshëm, sipas të cilave mënyra e sjelljes nuk i plotëson kushtet e trajtimit dinjitoz.

27. Gjykata vëren, se: i. masa e sigurimit personal ndaj kërkuesit është ekzekutuar në datën 21.10.2024 dhe mënyra e veprimeve të kryera për këtë qëllim janë bërë publike për shkak të filmimit të ngjarjes në po të njëjtën ditë; ii. kërkuesi ka pretenduar dhunën e ushtruar ndaj tij përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë në seancën gjyqësore për marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve e të kriterëve për caktimin e masës së sigurimit personal, e cila nuk i ka kthyer ndonjë

përgjigje specifike lidhur me mënyrën e ekzekutimit të masës; para GJKKO-së së Apelit, e cila është shprehur se ligjshmëria e veprimeve të kryera nga ana e policisë nuk ka qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe si e tillë nuk mund të jetë as objekt kontrolli nga GJKKO-ja e Apelit; ndërsa Gjykata e Lartë ka argumentuar se këto pretendime mund të jenë objekt i një kallëzimi penal kundrejt punonjësve të policisë, por nuk ndikojnë në disponimet e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit ose ekzekutimin e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”; iii. Prokuroria e Tiranës, mbi bazën e kallëzimit penal të kërkuesit, ka regjistruar në vitin 2025 procedimin penal nr. 477 për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i KP-së, për të cilin hetimet janë në vijim.

28. Në analizë të këtyre fakteve, Gjykata vë në dukje se trajtimi i këtij pretendimi duhet të vlerësohet, fillimisht, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysht edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës, rregulli i shterimit të mjeteve juridike i detyron kërkuesit që, përpara se t'i drejtohen asaj, të përdorin mjetet e parashikuara nga sistemi juridik kombëtar, me qëllim që shteteve t'u jepet mundësia për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e pretenduara kundër tyre. Kërkuesi duhet t'u drejtohet normalisht mjeteve juridike që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të siguruar riparim në lidhje me shkeljet e pretenduara, ndërsa ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Megjithatë, nuk ekziston detyrimi për t'u drejtuar mjeteve juridike që janë të papërshtatshme ose jo efektive, ndërsa thjesht dyshimet për perspektivat e suksesit të një mjeti të caktuar, i cili nuk është dukshëm i pafrytshëm, nuk përbëjnë arsye të vlefshme për të mos e shteruar atë rrugë ankimi (*shih Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 16.9.1996, §§ 65-67; Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë [DhM], datë 25.3.2014, §§ 70-77*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se në një sistem ligjor ku ofrohet mbrojtje nga Kushtetuta ose ligji për të drejtat themelore, është detyra e individit të dëmtuar të testojë atë mbrojtje dhe t'u japë gjykatave vendase



mundësinë t'i mbrojnë ato të drejta përmes interpretimit (*shih A, B dhe C kundër Irlandës [DhM], datë 16.12.2010, § 142; Zibni kundër Turqisë, datë 29.11.2016, § 30*).

29. Për pretendimet që lidhen me nenin 3 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka theksuar se efektiviteti i mjetit juridik vlerësohet në varësi të natyrës së shkeljes së pretenduar. Kur një individ paraqet një pretendim të besueshëm se ka pësuar trajtim që cenon këtë nen nga policia ose autoritete të tjera të ngjashme, kjo dispozitë, e lexuar së bashku me detyrimin e përgjithshëm të shtetit sipas nenit 1 të Konventës, kërkon, me nënkuptim, një formë hetimi zyrtarë efektive. Qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që ndalojnë torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues, si dhe përgjegjësinë e agjentëve ose organeve shtetërore për keqtrajtimin e ndodhur nën përgjegjësinë e tyre. Për të qenë efektiv, hetimi duhet të kryhet nga institucione dhe persona të pavarur nga ata ndaj të cilëve drejtohet, jo vetëm në kuptimin hierarkik ose institucional, por edhe në praktikë; autoritetet duhet të veprojnë me nismën e tyre; hetimi duhet të jetë i aftë të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës; ai duhet të jetë mjaftueshëm i gjerë për të marrë në konsideratë jo vetëm veprimet e agjentëve shtetërorë që kanë përdorur drejtpërdrejt forcë, por edhe të gjitha rrethanat përreth; ai duhet të zhvillohet me shpejtësi dhe brenda një afati të arsyeshëm; viktimat duhet të ketë mundësi të marrë pjesë në mënyrë efektive; autoritetet duhet të bëjnë një përpjekje serioze për të zbuluar se çfarë ka ndodhur, pa u mbështetur në përfundime të nxituara ose të pabazuara (*shih Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 28.10.1998, § 102; Bouyid kundër Belgjikës [DhM], datë 28.9.2015, §§ 116-123*).

30. Nga ana tjetër, kur pretendimi sipas nenit 3 të KEDNJ-së lidhet edhe me mënyrën e veprimit të autoriteteve, e cila pretendohet se ka synuar poshtërimin e individit, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankimit sipas nenit 3, mjeti më i përshtatshëm që duhet shteruar mund të jetë padia civile për kompensim për cenimin e të drejtave personale, përmes së cilës kërkuesi mund të pretendojë se është ekspozuar ndaj trajtimit poshtërues dhe të kërkojë kompensim nga shteti (*shih Miroslaw*

Garlicki kundër Polonisë, datë 14.6.2011, § 77). Në këtë kuptim, mjeti penal dhe ai civil, ndonëse mund të synojnë mbrojtjen e së njëjtës të drejtë kushtetuese dhe konventore, kanë funksione dhe pasoja të ndryshme juridike. Procedimi penal shërben për verifikimin e paligjshmërisë së veprimeve, identifikimin e autorëve dhe, sipas rastit, përcaktimin e përgjegjësisë së tyre penale, ndërsa padia civile për dëmshpërblim shërben për konstatimin e cenimit dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore. Për këtë arsye, këto mjete nuk përjashtojnë domosdoshmërisht njëra-tjetrën, por mund të jenë relevante në mënyrë të kombinuar për vlerësimin nëse individ ka përdorur mjetet juridike të brendshme të disponueshme dhe efektive për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar. Megjithatë, GJEDNJ-ja ka theksuar se ekzistenca formale e një mjeti penal ose kompensues nuk mjafton, në vetvete, nëse ai nuk është realisht i aftë të adresojë pretendimin e ngritur dhe të ofrojë riparim të përshtatshëm në rrethanat e çështjes konkrete. Në këtë drejtim, një mjet penal nuk mund të konsiderohet efektiv kur, për shkak të mangësive të legjislacionit të brendshëm, ai është i destinuar të dështojë, ashtu sikurse një padi civile për dëmshpërblim nuk përbën mjet efektiv kur fusha e shqyrtimit të gjykatave të brendshme është e kufizuar dhe nuk mundëson verifikimin e shkeljes së pretenduar ose dhënien e një riparimi të përshtatshëm (*shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, §§ 88-97*).

31. Duke zbatuar këto standarde në rastin konkret, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit lidhet me veprimet konkrete të punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të masës së sigurimit personal, përfshirë mënyrën e planifikimit dhe ekzekutimit të ndërhyrjes, përdorimin e pretenduar të forcës, sjelljen e kërkuesit gjatë ndërhyrjes, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e forcës së përdorur, si dhe pasojat e pretenduara në integritetin, dinjitetin dhe gjendjen e tij. Këto rrethana, për nga natyra e tyre, kërkojnë verifikim faktik nga autoritetet kompetente dhe nuk mund të përcaktohen drejtpërdrejt nga Gjykata në këtë fazë të gjykimit kushtetues, pa u shteruar më parë mjetet e brendshme të parashikuara për këtë qëllim.



32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, në vendimet objekt të këtij ankimi kushtetues, janë thirrur të vlerësojnë kushtet dhe kriteret për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal, ndërsa ligjshmëria e veprimeve konkrete të punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të kësaj mase nuk ka qenë objekt i drejtpërdrejtë i atij gjykimi. Për rrjedhojë, fakti që kërkuesi e ka ngritur këtë pretendim gjatë procedurës për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit personal nuk mjafton, në vetvete, për të konsideruar se organet kompetente kanë përfunduar shqyrtimin e tij në substancë, aq më tepër kur vetë Gjykata e Lartë ka evidentuar se këto pretendime mund të jenë objekt i një kallëzimi penal kundrejt punonjësve të policisë.

33. Gjykata konstaton se, mbi bazën e kallëzimit penal të kërkuesit, Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. 477 të vitit 2025 për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i KP-së, dhe se hetimet janë ende në vijim. Sipas kësaj dispozite, kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare nga punonjësi që kryen funksion shtetëror ose shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës, që prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim. Ky procedim penal nuk lidhet me themelin e akuzave penale ndaj kërkuesit, por drejtpërdrejt me verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera gjatë ekzekutimit të masës së sigurimit personal dhe me përgjegjësinë eventuale të punonjësve të policisë. Për rrjedhojë, në këtë fazë, nga aktet nuk rezulton dhe as kërkuesi nuk provon se ky mjet është thjesht formal, dukshëm i pafrytshëm, i paefektshëm ose i papërshtatshëm për të adresuar në substancë pretendimin e tij sipas nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 3 të KEDNJ-së.

34. Gjykata vëren, gjithashtu, se në të drejtën shqiptare ekziston edhe mjeti civil i dëmshpërblimit për dëmet e shkaktuara nga aktet, veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore. Neni 44 i Kushtetutës garanton të drejtën e rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit në përputhje me ligjin, ndërsa ligji nr. 8510, datë 15.7.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” (ligji nr. 8510/1999) parashikon përgjegjësinë e organeve të administratës shtetërore për dëmet pasurore dhe jopasurore që u shkaktohen personave nga veprimet ose mosveprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve

publike, përfshirë edhe rastet e cenimit të paprekshmërisë trupore, shëndetit, lirisë ose personalitetit. Ky mjet nuk zëvendëson funksionin e hetimit penal për identifikimin dhe përgjegjësinë eventuale të personave të përfshirë, por shërben për konstatimin e cenimit dhe riparimin e pasojave të ardhura nga veprimet shtetërore, nëse paligjshmëria e tyre dhe dëmi i shkaktuar provohen sipas ligjit. Kërkuesi nuk ka provuar se e ka përdorur këtë mjet dhe as se ai është dukshëm i pafrytshëm ose i paefektshëm.

35. Për sa u përket materialeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Gjykata vlerëson se ato përbëjnë elemente relevante në drejtim të vlerësimit të sjelljes së punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të masës së sigurimit personal. Megjithatë, ato nuk zëvendësojnë hetimin penal që është në vijim dhe as përfundimet që duhet të nxirren nga organi kompetent hetimor për ligjshmërinë e veprimeve të kryera, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e forcës së përdorur, si dhe përgjegjësinë eventuale individuale të personave të përfshirë.

36. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, në rastin konkret, nuk rezulton që mjetet juridike të jenë, në mënyrë të dukshme, të paefektshme ose të papërshtatshme për të adresuar pretendimin e kërkuesit. Përkundrazi, procedimi penal në vijim është i lidhur drejtpërdrejt me verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të masës së sigurimit personal dhe me përgjegjësinë eventuale individuale, ndërsa mjeti civil i dëmshpërblimit ofron, sipas rastit, mundësinë për konstatimin e cenimit dhe riparimin e dëmit të pretenduar. Vlerësimi në këtë fazë nga Gjykata i rrethanave faktike të arrestimit, i mënyrës së veprimit të autoriteteve, i domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të forcës së përdorur, si dhe i pasojave të pretenduara, do të nënkuptonte zëvendësimin e autoriteteve kompetente në kryerjen e verifikimeve që u takojnë atyre, në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit. Kjo nuk përjashton detyrimin e autoriteteve kompetente për të garantuar që hetimi penal të jetë efektiv, i pavarur, i shpejtë, i plotë dhe i aftë për të përcaktuar përgjegjësinë eventuale të personave të përfshirë.

37. Në këto kushte, për sa kohë procedimi penal për mënyrën e ekzekutimit të masës së sigurimit personal është ende në vijim dhe mjeti civil i dëmshpërblimit nuk rezulton të jetë



ushtruar, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk i ka shteruar ende, në substancë, mjetet juridike të brendshme që, në parim, janë të disponueshme dhe të afta për të adresuar këtë pretendim. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, për aq sa lidhet me mënyrën e ekzekutimit të masës së sigurimit personal, është i parakohshëm dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

38. Për të njëjtat arsye, Gjykata çmon se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për *respektimin e jetës së tij private dhe familjare* nuk mund të merret në shqyrtim në kushtet kur kërkuesi nuk ka parashtruar argumente mbështetëse në drejtim të shkëljes së kësaj të drejte, por është bazuar vetëm mbi mënyrën e ekzekutimit të masës së sigurimit personal.

39. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *lirisë së shprehjes dhe të drejtën për t'u zgjedhur*, të garantuara nga nenet 22 dhe 45 të Kushtetutës, duke argumentuar, ndër të tjera, se për shkak të komunikimit të tij me avokatin dhe nëpërmjet tij me mediat, ai është dënuar me masë disiplinore nga komisioni disiplinor në institucionin ku mbahet i izoluar, ndërkohë që nuk ka asnjë dispozitë që ta ndalojë dhe se ky veprim ndëshkues është në vazhden e represionit dhe të dhunës psikologjike që përdorin ndaj tij institucionet në varësi nga qeveria dhe posaçërisht nga Kryeministri. Po kështu, sipas kërkuesit, sjellja e prokurorisë dhe e gjykatës haptazi ka një qëllim politik: të ndalojë kërkuesin të bëjë fushatë dhe të drejtojë forcën e tij politike gjatë fushatës zgjedhore dhe këtë e provon edhe fakti se gazetarët janë penguar të filmojnë momentin e votimit të tij në institucionin ku qëndron i izoluar (*shih paragrafët 13.5. dhe 13.6. të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi kërkuesi pretendon për ngjarje të ndodhura pas datës 20.10.2024 dhe 23.10.2024, kur janë marrë vendimet e GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin dhe verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit personal dhe si i paraburgosur ka të drejtat dhe instrumentet e duhura për t'i bërë ato objekt të vlerësimit dhe kontrollit gjyqësor jashtë këtij gjykimi (*shih paragrafin 14.5. të vendimit*). Gjykata vëren se këto pretendime kërkuesi i ka parashtruar për herë të parë në ankimin

kushtetues individual, ndërkohë nuk ka provuar se ndaj masave që janë zbatuar ndaj tij nga administrata e institucionit ku mbahet i izoluar të ketë ndjekur ndonjë procedurë ligjore dhe në këtë drejtim të ketë ushtruar mjetet e ankimit për kundërshtimin e këtyre masave. Për më tepër, faktet e referuara lidhen me veprimet e kryera gjatë kohës së izolimit të kërkuesit, pra që i takojnë periudhës gjatë të cilës masa e arrestit në burg ishte në ekzekutim e sipër, ndërkohë që shqyrtimi i çështjes nga Gjykata i referohet kohës së dhënies së vendimeve gjyqësore për caktimin dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës. Për rrjedhojë, siç me të drejtë ka prapësuar edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

40. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të mosdiskriminimit për arsye politike dhe barazisë përpara ligjit* (*shih paragrafin 13.7. të vendimit*), bazuar në dy argumente: i. aktet dhe veprimet kundër tij janë nxitur dhe motivuar politikisht në prag të zgjedhjeve parlamentare të datës 11 maj 2025; prokuroria ka pasur një agjendë të fshehur dhe ka qenë mjaftueshëm e ndikuar politikisht nga shumica qeverisëse për diskreditimin politik të kërkuesit; ndaj funksionarëve të tjerë politikë (S.B. dhe zëvendëskryeministres) nuk janë caktuar masa të tilla shtrënguese kaq të ashpra; ii. në rastin konkret, mbi të njëjtat fakte dhe dyshime për kryerjen e veprave penale, janë vendosur masa të ndryshme ndaj personave të dyshuar edhe pse ata janë në të njëjtat kushte, kanë mbajtur të njëjtat funksione të ngjashme me kërkuesin dhe dyshohen të kenë kryer të njëjtat vepra penale.

41. Lidhur me *argumentin e parë*, Gjykata konstaton se kërkuesi pretendimin për diskriminim për shkak të zgjedhjeve parlamentare të datës 11 maj 2025 dhe se ndaj politikanëve të tjerë shqiptarë janë dhënë masa më të lehta shtrënguese e ka parashtruar për herë të parë në gjykimin kushtetues, duke mos shteruar mjetet juridike që ka pasur në dispozicion, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim. Ndërsa lidhur me *argumentin e dytë*, për sa i takon pretendimit për barazinë përpara ligjit, referuar masave të dhëna ndaj të dyshuarve të tjerë që janë nën të njëjtin hetim dhe standardeve ndërkombëtare të ndjekura në raste të ngjashme



të politikanëve të vendeve të tjera (presidentë dhe kryeministra), kërkuesi i ka ngritur ato gjatë gjykimin në gjykatat e zakonshme. Përkundër këtij shkaku, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, e ka prapësuar atë si të pabazuar, për shkak të rrethanave specifike që i atribuohen kërkuesit (*shih paragrafin 14.6. të vendimit*). Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në thelb argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë me vlerësimin që gjykatat e posaçme i kanë bërë kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal, do t'i analizojë ato në pjesën që do të trajtojë proporcionalitetin e masës së caktuar.

42. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për gjykim të paanshëm mbështetur në dy linja argumentimi. Linja e parë lidhet me faktin se në aspektin institucional gjykatat e posaçme nuk janë të pavarura dhe të paanshme në sytë e një vëzhguesi objektiv, pasi gjyqtarët janë nën mbikëqyrje sistematike dhe sistemike nga hetuesi, gjë e cila mundësohet nga parashikimet e ligjit nr. 95/2016; linja e dytë lidhet me faktin se gjykatat kanë favorizuar në mënyrë të dukshme prokurorinë, duke i marrë si të mirëqena plotësisht provat e paraqitura nga akuza, gjë e cila ka sjellë për pasojë edhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafin 13.8.2. të vendimit*). Për sa i takon linjës së parë të argumenteve, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur këto argumente as në ankimin e paraqitur në GJKKO-në e Apelit, as në rekursin e depozituar në Gjykatën e Lartë, por i ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Pavarësisht kësaj, për sa i takon paanshmërisë për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, Gjykata në jurisprudencën e saj të mëparshme u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kësaj natyre dhe ka pranuar se legjislacioni që normon funksionimin e gjykatave të posaçme dhe statusin e magjistratit përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë situatë, sikurse me të drejtë ka prapësuar edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme (*shih paragrafin 14.7.2. të vendimit*), argumentet e kërkuesit kanë marrë tashmë përgjigje nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, duke u gjendur

në kushtet e nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Ndërsa për sa i takon linjës së dytë të argumenteve, duke qenë se ato në thelb lidhen me provueshmërinë e akuzave, do të trajtohen në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

43. Për pretendimet e tjera, për sa u përket të drejtave dhe lirive që lidhen me të drejtën për t'u informuar për kufizimin e lirisë, për liri dhe siguri, proporcionalitetin dhe procesin e rregullt ligjor (aksesi, prezumimi i pafajësisë dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor), Gjykata vëren se kërkuesi i ka parashtruar ato në substancë në mjetet e ankimit (apel, rekurs), ndaj nuk ka më mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

44. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.4.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur fillimisht në datën 10.7.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

45. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion përgjatë gjithë procesit të ekzekutimit të masës dhe shqyrtimit të çështjes në themel, ripohon se ajo në kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal i referohet momentit faktik kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar ose fakteve të ndodhura nga momenti i caktimit të masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë pikë, Gjykata rithekson se, bazuar në rrethanat e secilit rast, mund të paraqiten dallime të dukshme midis situatës kur autoritetet gjyqësore shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet rivlerësimi i rrethanave për vijimin e masës së arrestit. Në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, i paraburgosuri ka të drejtë që të kërkojë procedimin e tij në liri dhe gjykatat janë të detyruara të marrin në konsideratë nëse ka ende arsye që justifikojnë masën kufizuese të lirisë dhe



nëse nevojat e sigurimit mund të garantohen me garanci të tjera ose masa alternative, duke vlerësuar në çdo rast proporcionalitetin e masës së caktuar në drejtim të përshtatshmërisë së saj (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, pretendimet dhe argumentet e kërkuarit se masa e sigurimit ndaj tij ka humbur çdo bazë dhe objektivisht është e pamundur që ai të ndikojë në provat ose intimidimin e dëshmitarëve, pasi përgjatë periudhës maj – nëntor 2025, Prokuroria e Posaçme ka përmbyllur procedurat e hetimit dhe çështja është dërguar për gjyq (*shih paragrafin 20 të vendimit*), nuk mund të merren në shqyrtim, pasi Gjykata shqyrton vendimet gjyqësore për caktimin e masës dhe verifikimin e zbatimit të saj që janë objekt kundërshtimi i ankimit kushtetues të kërkuarit (që mbajnë datat 20.10.2024, 23.10.2024, 19.11.2024 dhe 27.2.2025) dhe që i referohen momentit faktik kur masa në fjalë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar ose fakteve të ndodhura nga momenti i caktimit të masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues.

46. Kërkuari ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për kufizimin e lirisë dhe për liri e siguri në aspektin procedural, me argumentin se nuk është informuar për arsyet e arrestimit dhe natyrën e akuzës kundër tij, ka munguar komunikimi i akuzës, kujdesi shëndetësor, komunikimi me avokatin dhe familjarët e tij, si dhe urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit është ligjërisht i pavlefshëm, për shkak se është mbështetur në një ligj të shfuqizuar (*shih paragrafët 13.2. dhe 13.3. të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuari është njohur brenda një kohe të shkurtër me vendimin; çështja e pavlefshmërisë së urdhrit mund të shqyrtohet nga gjykatat e zakonshme; kërkuari brenda 72 orëve ka dalë përpara gjykatës, e cila ka vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit; atij i është siguruar takimi me mbrojtësin menjëherë, i cili ka nënshkruar procesverbalin; kufizimi i lirisë është bërë mbi një vendim gjyqësor që është detyrues i zbatueshëm (*shih paragrafët 14.2. dhe 14.3. të vendimit*). Ndërsa, subjekti tjetër i interesuar, Policia e Shtetit, ka prapësuar se kërkuarit përveç procesverbalit të ekzekutimit të vendimit penal dhe kontrollit personal i është dhënë në kohë edhe karta e të drejtave të personave të ndaluar dhe arrestuar, si dhe materialet i kanë kaluar Prokurorisë së Posaçme me

shkresën e datës 21.10.2024 (*shih paragrafin 15.2. të vendimit*).

47. Në kuptim të neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, kujtdo që i hiqet liria ka të drejtën për t'u njoftuar menjëherë për shkaqet e kësaj mase dhe për akuzën që i bëhet.

48. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Prokuroria e Posaçme në datën 20.10.2024 ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuarit, në përmbajtje të të cilit, ndër të tjera, është referuar neni 466 i KPP-së, ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", si dhe vendimi i GJKKO-së së Shkallë së Parë nr. 125/2024. Me ligjin nr. 79/2020, datë 25.6.2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" është shfuqizuar ligji i vitit 1998 (neni 80). Ndërkohë, urdhri pasqyron të plotë dispozitivin e vendimit gjyqësor që do të vihej në ekzekutim dhe mënyrën e ekzekutimit. Gjithashtu, në datën 21.10.2024 (në të njëjtën ditë që kërkuari është arrestuar) Prokuroria e Posaçme ka administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit materialet procedurale për ekzekutimin e urdhrit për kërkuarin, ku gjendet letra e të drejtave të personit të arrestuar, procesverbali i ekzekutimit të masës, procesverbali i kontrollit personal dhe procesverbali për sekuestrimin e sendeve, të cilat janë nënshkruar rregullisht nga kërkuari. Në analizë të këtyre fakteve, Gjykata eidenton se ndonëse referimi në ligjin e vitit 1998 është i pasaktë, kërkuari nuk ka argumentuar konkretisht sesi kjo pasaktësi i ka sjellë atij pengesë në ushtrimin e të drejtave kushtetuese ose cenim të tyre. Nga ana tjetër, mangësitë procedurale lidhur me mungesën e kontrollit shëndetësor, mosnjoftimin në kohë të avokatit ose familjarëve, në thelb lidhen me (mos)veprimet e organeve ligjzbatuese (policisë), të cilat janë objekt verifikimi nga gjykata e zakonshme. Kurse argumentet e kërkuarit që lidhen me paqartësinë dhe dyshimet mbi akuzën do të analizohen në këndvështrim të cenimit të lirisë personale.

49. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, për shkak të sjelljes së gjykatave ndaj tij (*shih paragrafin 13.8.2. të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi gjykatat nuk e kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuari dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme (*shih paragrafin*



14.7.1. të vendimit). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një nga aspektet e parimit të prezumimit të pafajësisë është edhe e drejta e individit për të mos u paraqitur si fajtor nga autoritetet publike, përfshirë edhe nga gjykata, përpara se fajësia e tij të jetë vërtetuar sipas ligjit me vendim gjyqësor përfundimtar (*shih vendimet nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se argumentet e kërkuarit në thelb kanë të bëjnë me (mos)ekzistencën e *dysimit të arsyeshëm*, gjë e cila në këtë fazë ka sjellë vendosjen e masës shtrënguese “Arresti në burg”, Gjykata çmon të analizojë edhe këto argumente në drejtim të cenimit të lirisë personale.

50. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *lirisë personale* në aspektin substancial (*shih paragrafin 13.3. të vendimit*) kërkuari e ka argumentuar në drejtim të standardit të *dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova* dhe të parimit të proporcionalitetit (*shih paragrafin 13.4. të vendimit*). Nga ana tjetër, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pikërisht në lidhje me lirinë personale të pretenduar si të shkelur. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se liria personale ka dy anë: atë substanciale, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedurale, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Po kështu, Gjykata ka theksuar se në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga kjo premisë, Gjykata do të analizojë në themel pretendimet e kërkuarit për cenimin e *lirisë personale* si rezultat i shkeljes së *standardit të dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe parimit të proporcionalitetit*, të garantuara nga nenet 17, 27 dhe 28 të Kushtetutës, të cilat janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

B.1.1. Në lidhje me standardin e *dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova*

51. Kërkuari ka pretenduar se në caktimin ndaj tij të masës së sigurimit nuk është respektuar standardi i *dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova*. Në aspektin substancial, arrestimi me burg nuk i përgjigjet situatës faktike dhe as nevojave që justifikuan fillimisht caktimin e kësaj mase dhe nuk merr në konsideratë personalitetin, statusin e tij, si dhe funksionet kushtetuese që ai ka ushtruar (*shih paragrafin 13.3. të vendimit*).

52. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se vlerësimi i rrezikut për shmangien nga drejtësia dhe i helmimit të provave është vlerësuar edhe nga rrethanat e faktit. Kufizimi i lirisë së kërkuarit është bërë mbi bazën e një vendimi gjyqësor, i cili vazhdon të jetë në fuqi dhe është detyrues i zbatueshëm (*shih paragrafin 14.3. të vendimit*).

53. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*paragrafi 1*), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale (*paragrafi 2, shërkronja “e”*). Kurse neni 28 i Kushtetutës parashikon se personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim (*paragrafi 2*) dhe se i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit (*paragrafi 3*).

54. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkallë të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e



kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një veprë penale (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e organeve të procedimit penal për faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individ, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e organeve të procedimit penal (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson të analizojë faktin nëse gjykatat nëpërmjet arsyetimit të tyre kanë analizuar në mënyrë të mjaftueshme ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe nëse kanë vlerësuar kriteret kushtetuese e ligjore për të respektuar garancitë për lirinë personale të kërkuesit.

57. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë në vendimin për caktimin e masës së sigurimit personal ka argumentuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi në saje të pozicionit të tij si ministër, Kryetar i Kuvendit dhe kryetar i partisë politike LSI ka konsumuar: i. elementet e figurës së veprës penale të korrupsionit pasiv të parashikuar nga neni 260 i KP-së në tre raste, pasi ka influencuar për të ndërmjetësuar lidhjen e dy kontratave dhe ndryshimin e një ligji në këmbim të përfitimeve financiare dhe materiale; ii. elementet e figurës së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, të kryer në rrethana cilësuese, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, pasi ka synuar të përfshijë në sistemin bankar, përmes trukut të marrjes së kredisë për investim në pasuri të paluajtshme, shumën të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit; nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të lobimit, marrjes së shërbimeve nga këto kontrata dhe financimit me shumën të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat jashtë Shqipërisë nga llogari të padeklaruara prej tij dhe mosdeklarimi i shpenzimeve sipas ligjit në KQZ; iii. elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, të kryer kryesisht në

formën e deklaramit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme, pasi nuk ka deklaruar në deklaratat e pasurisë shumën të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese, ndërkohë që dyshohet se ka qenë në pamundësi për t'i siguruar këto shumën nga burime të ligjshme (*shih faqet 152–157 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë të datës 20.10.2024*).

58. Mbi të njëjtat argumente ka arsyetuar ajo gjykatë edhe kur ka vlerësuar vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, pasi, sipas saj, në gjendjen që janë aktet ka rrethana që tregojnë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova. Sipas saj: (a) faktet penale për të cilat dyshohet kërkuesi parashikohen nga ligji si vepra penale; (b) në rastin konkret “dyshimi i arsyeshëm” nuk është i supozuar, por i bazuar në prova; (c) provat e grumbulluara deri në këtë fazë të procedimit janë të tilla që përmbushin elementet e anës objektive të figurave të veprave penale të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi i dytë, dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së (*shih faqet 177–197 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë të datës 23.10.2024*).

59. Në përgjigje të shkakut të ankimit të kërkuesit për mungesën e dyshimit të arsyeshëm, GJKKO-ja e Apelit është pajtuar tërësisht me konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë dhe ka çmuar se provat e grumbulluara deri në këtë fazë të procedimit plotësojnë standardin provues të dyshimit të arsyeshëm për të dëshmuar ekzistencën e fakteve, veprat penale konkrete dhe elementet e nevojshme e të mjaftueshme që lidhin kërkuesin me faktet penale që atij i atribuohen, në kuptim të nenit 228, pika 1, të KPP-së (*shih faqet 141–174 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

60. Standardi i dyshimit të arsyeshëm mbi bazën e provave është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka argumentuar se masa e sigurimit personal në ngarkim të kërkuesit është caktuar nga gjykata në kuadër të procedimit penal dhe se të dhënat, informacionet ose faktet objekt prove në këtë fazë të procedimit penal nuk kërkohen që të jenë në të njëjtin nivel provueshmërie me ato mbi të cilat bazohet vendimi i themelit që ka të bëjë me (pa)fajësinë e kërkuesit dhe gjatë të cilit do të formësohen edhe provat që kanë të bëjnë me të provuarit e akuzës penale. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm se provat e grumbulluara deri në këtë fazë të procedimit janë të tilla, në standardin provues të “dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova”, për të dëshmuar ekzistencën e fakteve, veprat penale konkrete dhe elementet e nevojshme dhe të mjaftueshme që lidhin kërkuesin me faktet penale që i atribuohen (*shih paragrafet 34–38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).



61. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar veprimet ose mosveprimet të cilat kërkuesi dyshohet t'i ketë kryer në kuadër të elementeve të figurave të veprave penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe mosdeklarimit të pasurisë, të kryera disa herë dhe në bashkëpunim. Gjykatat e zakonshme kanë vënë theksin se në bazë të materialeve dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit ekziston dyshimi i arsyeshëm që kërkuesi të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Po kështu, gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në të njëjtat fakte me ato të parashtruara nga organi i prokurorisë dhe mbi të njëjtin kualifikim penal të bërë prej tij. Nën këtë këndvështrim, kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme të mbështetura në prova për kryerjen nga ai të veprave penale për të cilat dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë së tij personale, pasi është bazuar në fakte dhe informacione, të cilat u kanë krijuar bindjen gjykatave të zakonshme se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilat dyshohet.

62. Nisur nga këto premisa, Gjykata vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit ka fakte dhe informacione që arrijnë të bindin një vëzhgues të jashtëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet, ndaj nuk mund të arrihet në përfundimin se kufizimi i lirisë së tij është kryer në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së.

63. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova është i pabazuar.

B.1.2. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

64. Kërkuesi ka pretenduar se masa e sigurimit “Arresti në burg” është më e rënda dhe duhet të përdoret vetëm kur masat më të lehta nuk janë të mjaftueshme, ndërkohë që asnjë nga gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm se përse nuk mund të aplikohet një masë më e lehtë. Gjykatat nuk mund të miratojnë automatikisht kërkesën e prokurorisë për masën shtrënguese të heqjes së lirisë, pa bazë ligjore dhe pa akuzë të saktë dhe vazhdimi i paraburgimit me

arsyetim të pamjaftueshëm është joproporcional (*shih paragrafin 13.4. të vendimit*).

65. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se masa e sigurimit personal ka qenë proporcionale, duke marrë në konsideratë jo vetëm ato që janë cituar nga gjykatat në vendimet e kundërshtuara, masën e dënimit të parashikuar nga dispozitat, dënimin e pritshëm në rast se do të rezultojë fajtor, por edhe sjelljen e kërkuesit gjatë hetimit dhe në gjykimin përpara gjyqtarit të seancës paraprake (*shih paragrafin 14.4. të vendimit*).

66. Gjykata në jurisprudencën e saj në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal në drejtim të proporcionalitetit ka pohuar se ajo duhet të jetë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur dhe se arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë duhet të jenë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës ndaj qëllimit legjitim. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë sa ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, të përshtatshmërisë dhe të ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijuese të KPP-së. Në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata bazohet në arsyetimin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se u takon atyre që, përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

67. KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (*shkronja “a”*); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (*shkronja “b”*); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*shkronja “c”*). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me



shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (*pika 2*). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit (*pika 1*).

68. Për sa më lart, Gjykata vlerëson të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm se masa e kufizimit ndaj kërkuesit ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Për këtë qëllim, Gjykata do të mbajë në konsideratë kontekstin e fakteve të çështjes për të përcaktuar nëse masa e caktuar ndaj kërkuesit është e nevojshme dhe e arsyeshme dhe nëse është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur, si dhe nëse çdo masë tjetër është e papërshtatshme.

69. Gjykata çmon të evidentojë arsyet e veçanta që gjykatat e zakonshme kanë parashtruar për justifikimin e masës shtrënguese ndaj kërkuesit përtej ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe për sa u përket argumenteve të tyre rreth nevojës dhe përshtatshmërisë së kësaj mase. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë vendosjen e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit e ka lidhur vetëm me kushtin e parashikuar nga neni 228, pika 3, shkronja “a”, i KPP-së, pra me ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës. Ajo ka vlerësuar se caktimi i një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues ndaj kërkuesit është i domosdoshëm për të përmbushur nevojat e sigurimit bazuar në këto faktorë: i. ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të hetimit të kësaj çështjeje; ii. se për faktin e ndodhur po zhvillohen hetime në drejtim të sqarimit të rrethanave të faktit dhe duke marrë në konsideratë jo vetëm pozicionin zyrtar që kërkuesi ka pasur (deputet, Kryetar i Kuvendit, disa herë ministër, Kryeministër dhe së fundmi President i Republikës), për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit të këtyre funksioneve dhe influencave që mund të ketë te persona të tjerë

ekziston mundësia që të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, që do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Në këto kushte, sipas gjykatës, caktimi i një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues është i domosdoshëm në plotësimin e nevojave të sigurimit që kërkon hetimi i këtij procedimi penal (*shih faqe 161 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë të datës 20.10.2024*). Gjithashtu, sipas asaj gjykate, masa e sigurimit të arrestit në burg është më e përshtatshme në raport me rëndësinë e fakteve të kryera nga kërkuesi, si dhe masat e dënimit që parashikohen nga neni 260 i KP-së (4–12 vjet burgim), nga neni 287 i KP-së (7–15 vjet burgim) dhe nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së (deri në 3 vjet burgim) (*shih faqe 161 të vendimit po aty*).

70. Lidhur me llojin e masës së sigurimit personal, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ndaj kërkuesit mbahen në konsideratë edhe cilësitë personale dhe kushtet individuale, të tilla si: i. gjendja ekonomike, shoqërore e familjare; ii. rrezikshmëria shoqërore e veprave penale për të cilat dyshohet, duke u nisur nga masa e dënimit që parashikon secila prej tyre; iii. mënyra e kryerjes së secilës prej tyre; iv. rrezikshmëria shoqërore e tij; v. fakti që personi nën hetim po hetohet për disa vepra penale të ndodhura në kohë të ndryshme dhe disa herë, si dhe përbërja e gjendjes familjare të tij (*shih faqe 163 të vendimit, po aty*).

71. Po kështu, në vendimin për vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg”, gjykata e shkallës së parë ka konfirmuar se nuk rezulton asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 230, pika 2, të KPP-së për ndalimin ligjor të vendosjes dhe vazhdimin të një mase të tillë nga gjykata (*shih faqe 198 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë të datës 23.10.2024*).

72. Në të njëjtën linjë me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë ka arsyetuar edhe gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar se ndryshe nga sa parashtrohet në shkaqet e ankimit të kërkuesit, caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues është i lidhur vetëm me ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës. Sipas gjykatës së apelit, në rastin konkret evidentohet prania e rrethanave, se: i. ka rrezik eminent që liria e pakushtëzuar mund të helmojë provat ose mund të riskojë gjetjen dhe



fiksimit e gjendjes natyrore të tyre; ii. kërkuesi, për shkak të funksioneve që ka ose ka pasur, mund të ushtrojë influencën për të ndikuar në procesin e marrjes dhe të vërtetësisë së provave të ndryshme nga ato dokumentare, sikurse janë pyetja e personave që kanë dijeni për faktet objekt hetimi, duke qenë se po hetohet për disa vepra penale; iii. pushteti dhe lidhjet që kërkuesi ka krijuar për shkak të funksioneve që ka pasur ose pozitës së tij në shoqëri krijojnë mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar te dëshmitarët potencialë të faktit penal dhe gjithashtu edhe te subjektet e tjera publike, me qëllim “helmimin e provës” për të lehtësuar pozitën e tij në raport me procedimin (*shih faqet 174–175 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

73. Po kështu, gjykata e apelit ka arsyetuar se për kushtet legjitimuese të aplikimit të masave të sigurimit ligjvënësi parashikon në nenin 232 të KPP-së një listë taksative të masave të sigurimit, ndërmjet të cilave gjykata duhet të zgjedhë, sipas kriterëve të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit (neni 229, pika 1, i KPP-së). Të dyja parimet referojnë në shkallën e nevojave të sigurimit (vlerësimin e përshtatshmërisë) dhe rëndësinë e veprës penale dhe të sanksionit që parashikohet për të (vlerësimi i proporcionalitetit). Po kështu, në vlerësimin e përshtatshmërisë së masës mbahen parasysh edhe rrethanat që lidhen me personalitetin e të hetuarit, vazhdimësia dhe përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja. Sipas asaj gjykate, duke pasur parasysh rëndësinë e fakteve që i janë atribuar kërkuesit, përmasat e implikimit, rolin që ka pasur në kryerjen e veprimeve të paligjshme, për të cilat tashmë dyshohet, rrethanat e kryerjes së veprave penale, në caktimin e masës së sigurimit, vlerësohet përshtatshmëria e llojit të masës shtrënguese me nevojat e sigurimit, edhe se çdo masë tjetër është e papërshtatshme për t’u vendosur ndaj kërkuesit, sepse rrezikshmëria e tij dhe e veprave penale është e një shkalle të lartë (*shih faqe 176 të vendimit, po aty*).

74. Përveç sa më sipër, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se megjithëse kërkuesi ka qenë gjithmonë bashkëpunues dhe në dispozicion të organit të ndjekjes penale sa herë që është thirrur prej këtij të fundit, sërish ekziston rreziku i “helmimit të provës”, sipas parashikimit të pikës 3, shkronja “a”, të nenit 228 të KPP-së, rrezik ky që është dinamik. Prokuroria e Posaçme duhet të tregojë dilijencën dhe shpejtësinë e duhur për marrjen e provave dhe

të informojë gjykatën për hetimet e kryera dhe aktualitetin e nevojave të sigurimit sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 246 të KPP-së. Lidhur me statusin e kërkuesit (referuar standardeve ndërkombëtare të ndjekura ndaj presidentëve dhe kryeministrave të vendeve të tjera), gjykata e apelit ka vlerësuar se masat e sigurimit janë individuale dhe vendosen në raport me kushtet dhe kriteret që ekzistojnë në rastin konkret. Po ashtu, edhe lidhur me faktin se ndaj të dyshuarve të tjerë që janë nën të njëjtin hetim gjykata e apelit ka argumentuar se përzgjedhja e masave të sigurimit vlerësohet mbi ekzistencën e rrethanave personale që lidhen me gjendjen shëndetësore, masat janë individuale, rastet nuk janë identike dhe mbi kërkuesin rëndon dyshimi për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv në tre raste dhe të veprës penale të pastrimit të parave në dy raste (*shih faqet 177–178 të vendimit, po aty*).

75. Këto argumente janë gjetur të bazuara nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se lidhur me kriteret që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të sigurimit, GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim gjerësisht pretendimet e kërkuesit dhe u ka kthyer përgjigje të arsyetuara atyre në përputhje me objektin e shqyrtuar, që nuk lidhet me një gjykim themelor, por me zgjidhjen e një kërkesë për caktimin e një mase sigurimi gjatë hetimeve paraprake të procedimit objekt gjykimi. Sipas Gjykatës së Lartë, masat e sigurimit janë individuale dhe vendosen në raport me kushtet dhe kriteret që ekzistojnë në rastin konkret. Po kështu, Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm nevojën e vazhdimit të zbatimit të masës së sigurimit personal, ndaj shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi nuk e cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit (*shih paragrafët 39–44 dhe 49–50 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

76. Gjykata e Lartë evidenton se gjykatat e zakonshme nuk e kanë justifikuar caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg të kërkuesit vetëm mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprat penale, por kanë dhënë edhe arsye të tjera të veçanta, të tilla si rreziku i marrjes dhe helmimit të provave, arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e vazhdimit të paraburgimit të një individi. Argumentimi i gjykatave në këtë drejtim nuk është abstrakt, ato kanë listuar në mënyrë të detajuar dhe të zgjeruar në pjesën më të konsiderueshme të



arsyetimit të tyre burimet e provave që kanë shërbyer për krijimin e dyshimit të arsyeshëm, prova të cilat mund të “helmohen” nga përpjekjet e të pandehurit për dëmtimin e provueshmërisë së tyre (*shih faqet 3–151 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë të datës 20.10.2024*). Gjykatat e zakonshme kanë shpjeguar në mënyrë konkrete, të mjaftueshme dhe të arsyeshme mbi rrezikun e helmimit dhe prishjes së provave nëse kërkuesi do të ishte i lirë, duke evidentuar rrezikshmërinë e veprave penale, rrethanat cilësuese të kryerjes së tyre, si dhe kompleksitetin e hetimit për shkak të statusit dhe pushtetit të kërkuesit në shoqëri, të atilla që mund të krijonin mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar te dëshmitarët, por edhe te subjektet e tjera publike, me qëllim helmimin e provave.

77. Po kështu, Gjykata vë në dukje se gjykatat e zakonshme kanë parashtruar mjaftueshëm argumente edhe në drejtim të përshtatshmërisë së masës “Arresti në burg” të kërkuesit dhe përfundimi i tyre se çdo masë tjetër nuk është e përshtatshme nuk duket e paarsyeshme në raport me nevojat e sigurimit që janë evidentuar në rastin konkret. Për rrjedhojë, urdhërimi i gjykatave të zakonshme për masën shtrënguese ndaj kërkuesit është i justifikuar mbi tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë së tij, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së.

78. Në këtë kontekst, për qëllime të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata çmon se caktimi i masës së sigurimit personal “Arresti në burg” nuk është në raport të zhdrejtë me qëllimin legjitim të mbarrëvajtjes së procedimit penal dhe mbajtjes së tij në paraburgim në dispozicion të organit procedues, duke rezultuar në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe me rëndësinë e fakteve penale për të cilat ai dyshohet, si dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për veprat penale përkatëse. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe llojin e masës së sigurimit personal, atë të “Arresti në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së. Po kështu, për sa i takon kundërshtimit nga ana e kërkuesit të termave të përdorur në vendimet gjyqësore, sikurse ai

“recidivist”, Gjykata çmon se nuk kanë ndonjë rëndësi të atillë sa të kenë ndikuar në vendimmarrjen e tyre ose t’i bëjë vendimet të cënueshme vetëm për këtë shkak.

79. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale për shkak të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” janë të pabazuara. Për sa kohë që masa e sigurimit personal ndaj kërkuesit është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarrëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, ajo nuk është joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe nevojave të sigurimit, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

80. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.4.2026.

Shpallur më 11.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi

Anëtare pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

Anëtare kundër: Sonila Bejtja

**MENDIM PAKICE**

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Ilir Metaj, me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg, ne, gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Marjana Semini, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa për pretendimin që lidhet me cenimin e ndalimit të trajtimit poshtërues, sipas nenit 25 të Kushtetutës, ishte e bazuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar, parashitrojmë qëndrimin tonë kundër.

2. Shumica nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuarit, me arsyetimin se ai nuk ka shteruar ende në substancë mjetet juridike në dispozicion dhe se nuk rezulton që këto mjete të jenë në mënyrë të dukshme të paefektshme ose të papërshtatshme. Sipas shumicës, pretendimi lidhet me veprimet konkrete të punonjësve të policisë gjatë ekzekutimit të masës së sigurimit personal, të cilat kërkojnë verifikim faktik nga autoritetet kompetente dhe nuk mund të vlerësohen drejtpërdrejt nga Gjykata pa u shteruar më parë mjetet juridike efektive në dispozicion. Në këtë drejtim, shumica ka theksuar se ligjshmëria e veprimeve të punonjësve të policisë gjatë arrestimit nuk ka qenë objekt i drejtpërdrejtë i shqyrtimit nga gjykatat e zakonshme, ndërkohë që edhe Gjykata e Lartë ka evidentuar se këto pretendime mund të trajtohen përmes një kallëzimi penal ndaj punonjësve të policisë (*shih paragrafin 32 të vendimit*).

3. Lidhur me shterimin e mjeteve juridike në dispozicion të kërkuarit, shumica ka identifikuar dy të tilla. Së pari, procedimi penal i vënë në lëvizje nga vetë kërkuari përmes kallëzimit penal, për të cilin ka vlerësuar se nga aktet nuk rezulton dhe as kërkuari nuk ka provuar se është thjesht formal, dukshëm i pafrytshëm, i paefektshëm ose i papërshtatshëm për të trajtuar në substancë pretendimin e tij sipas nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 3 të KEDNJ-së. Së dyti, padia civile për dëmshpërblim për pasojat e shkaktuara nga aktet, veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës dhe ligji nr. 8510/1999. Edhe në

lidhje me këtë mjet, shumica ka vlerësuar se kërkuari nuk ka provuar as përdorimin e tij dhe as se ai është dukshëm i pafrytshëm ose i paefektshëm. Në fund, shumica ka çmuar se raporti dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, megjithëse dokumentojnë rrethanat e arrestimit të kërkuarit, nuk mund të zëvendësojnë hetimin penal që vijon të zhvillohet (*shih paragrafët 34–35 të vendimit*).

4. Nuk pajtohem me këtë vlerësim, pasi çmohet se ai mbështetet në një qasje tepër formaliste, e cila rrezikon ta shndërrojë të drejtën themelore për të mos iu nënshtuar trajtimit poshtërues në një garanci iluzore dhe joefektive. Duke kërkuar nga kërkuari që, përpara se pretendimi i tij të shqyrtohet në plan kushtetues, të ndjekë dhe të përfundojë procedura të tjera me objekt dhe qëllim të ndryshëm, të cilat në vetvete sjellin vonesa të konsiderueshme deri në konstatimin e mundshëm të shkeljes, shumica vendos mbi të një barrë të tepruar dhe joproporcionale. Njëkohësisht, ajo rrezikon ta zhveshë nga efektiviteti praktik mbrojtjen kushtetuese ndaj trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, duke e kthyer atë në një garanci thjesht teorike. Një qasje e tillë nuk pajtohet me natyrën dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura nga nenet 25 dhe 28 të Kushtetutës. Shkëputja artificiale e këtij pretendimi nga procedura e caktimit dhe e ekzekutimit të masës së arrestit në burg nuk është në përputhje me thelbin e garancisë së *babeas corpus*, të sanksionuar në nenin 28, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo që privohet nga liria ka të drejtë të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos për ligjshmërinë e arrestimit. Kjo garanci nuk kufizohet vetëm në verifikimin formal të bazës ligjore të privimit nga liria, por përfshin edhe shqyrtimin e rrethanave konkrete në të cilat arrestimi është kryer, veçanërisht kur ngrihen pretendime të besueshme për cenim të dinjitetit njerëzor.

5. Qasja e shumicës rrezikon ta vonojë mbrojtjen kushtetuese deri në atë masë sa ta zhveshë atë nga efektiviteti praktik dhe ta kthejë në një garanci thjesht teorike dhe duke e shtyrë situatën konkrete *quasi* në kufijtë e pamundësisë për t'u mbrojtur nga kjo shkelje. Për më tepër, ajo nuk pajtohet me kërkesat që burojnë nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, të cilat



kërkojnë që pretendimet e besueshme për trajtim çnjerëzor ose poshtërues të trajtohen me prioritet dhe pa vonesa që mund të kompromentojnë efektivitetin e mbrojtjes së garantuar. Kërkesa për ta shtyrë shqyrtimin e këtyre pretendimeve deri në përfundimin e procedurave të tjera, të cilat, siç u verifikua në gjykim, janë dukshëm në vonesë, rrezikon të cenojë vetë efektivitetin e mbrojtjes që këto dispozita synojnë të garantojnë. Për këto arsye, vlerësojmë se pretendimi i kërkuarit nuk duhet të shmangej për arsye formale, por duhet të shqyrtohet në themel, siç parashtrohet në vijim.

6. Neni 25 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund t'i nënshtrohet, ndër të tjera, trajtimit poshtërues. Sipas nenit 175, pika 1, të Kushtetutës, kjo e drejtë nuk mund të kufizohet as gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, që do të thotë se kjo e drejtë themelore ka karakter absolut.

7. Ndalimi për t'iu nënshtrohet trajtimit poshtërues garantohet shprehimisht edhe në një numër aktesh ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kështu, neni 3 i KEDNJ-së e ndalon në mënyrë absolute atë, pavarësisht sjelljes së personit të përfshirë. Neni 5 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 7 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike gjithashtu përcaktojnë se askush nuk duhet t'i nënshtrohet, ndër të tjera, trajtimeve poshtëruese. Neni 16 i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese detyron çdo shtet palë të parandalojë në territorin dhe juridiksionin e tij veprime që përbëjnë, ndër të tjera, trajtime poshtëruese që janë kryer nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me titull zyrtar, ose me nxitjen e tij, ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur.

8. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, për shqyrtimin në themel të pretendimit të kërkuarit duhet të ishin verifikuar rrethanat e arrestimit të tij, duke analizuar, në aspektin substancial, nëse ai i ishte nënshtrohet trajtimit poshtërues dhe, në aspektin procedural, nëse hetimi i pretendimit për trajtim poshtërues ishte i shpejtë dhe efikas.

9. Në lidhje me *aspektin substancial*, GJEDNJ-ja ka pranuar se konsiderohet trajtim “poshtërues” kur poshtëron ose përçmon një individ, duke treguar mungesë respekti për dinjitetin e tij njerëzor, ose duke zvogëluar dinjitetin e tij

njerëzor, ose kur ngjall ndjenja frike, ankthi apo inferioritet të aftë për të thyer rezistencën morale dhe fizike të një individi. Mund të mjaftojë që viktima të poshtërohet në sytë e tij, edhe nëse jo në sytë e të tjerëve (*shih Gäfgen kundër Gjermanisë [DhM], datë 1.6.2010, § 89; Ilascu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Rusisë [DhM], datë 8.7.2004, § 425; M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë [DhM], datë 21.1.2011, § 220*).

10. Në një shoqëri demokratike keqtrajtimi nuk është kurrë përgjigjja e duhur ndaj problemeve me të cilat përballen autoritetet. Policia, në mënyrë të veçantë, duhet “të mos shkaktojë, nxisë ose tolerojë asnjë akt torture ose trajtimi apo dënimi çnjerëzor, ose degradues në asnjë rrethanë” (*Kodi Evropian i Etikës Policore, § 36*).

11. Ndërsa në lidhje me *aspektin procedural*, Gjykata, bazuar në nenin 25 të Kushtetutës, duke pohuar se çdo trajtim poshtërues është i ndaluar, ka evidentuar se është detyrë e shtetit të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara, pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). GJEDNJ-ja ka theksuar se ndalimi i përgjithshëm i trajtimit poshtërues nga agjentët e shtetit në mënyrë të veçantë do të ishte joefektiv në praktikë në qoftë se nuk do të ekzistonte procedura për hetimin e keqtrajtimit të pretenduar të personave të mbajtur prej tyre. Kështu, duke pasur parasysh detyrën e përgjithshme të shtetit, parashikimi i nenit 3 të KEDNJ-së kërkon se duhet të ketë një formë hetimi zyrtar efektiv kur një individ bën një konstatim të besueshëm që ai ka pësuar trajtim që shkel këtë nen. Qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve vendase që ndalojnë trajtimin poshtërues në çështje ku përfshihen agjentët ose organet e shtetit, si dhe të garantojë llogaridhënien e tyre për keqtrajtimin e ndodhur nën përgjegjësinë e tyre (*shih Bouyid kundër Belgjikës [DhM], datë 28.9.2015, §§ 115–123*).

12. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, fillimisht duhet evidentuar se kërkuari ka filluar jetën politike që prej vitit 1990. Ai ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (nënkryetar partie, themelues dhe kryetar i një partie tjetër politike), funksione shumë të larta politike në organet e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës (Kryeministër,



ministër, deputet dhe Kryetar i Kuvendit) dhe është zgjedhur edhe President i Republikës. Kërkuesi ka ushtruar rol aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Ndërkohë, pas përfundimit të mandatit të tij si President i Republikës në vitin 2022, kërkuesi ka vazhduar jetën politike si drejtues i një partie politike në opozitë me shumicën qeverisëse.

13. Në këtë kontekst, nga të dhënat e administruara në dosje, nuk rezulton që kërkuesi të ketë shfaqur sjellje të dhunshme, prirje agresive ose rrezikshmëri që do të justifikonte trajtimin e tij si person me potencial për rezistencë të dhunshme gjatë arrestimit. Ky përfundim lidhet natyrshëm me profilin publik dhe institucional të kërkuesit dhe forcon argumentin se autoritetet nuk kishin bazë të dukshme për ta trajtuar atë si subjekt me rrezik të shtuar dhune.

14. Prokuroria e Posaçme, bazuar në disa kallëzime penale (të paraqitura në vitet 2018 dhe 2022), ka filluar procedimin penal, duke ngritur dyshimet se kërkuesi ka kryer veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”; “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale” dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi i dytë, dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së. Duke pasur parasysh natyrën e veprave penale për të cilat ai hetohet, si dhe mungesën e çdo elementi konkret që të tregonte prirje për sjellje të dhunshme, nuk rezulton që kërkuesi të paraqiste rrezikshmëri të tillë që të justifikonte trajtimin e tij si person i dhunshëm.

15. Gjatë hetimeve paraprake, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë në datën 20.10.2024 ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në burg. Masa e sigurimit është ekzekutuar të nesërmen, më 21.10.2024, rreth orës 13:00, në një kryqëzim rrugësh me trafik të rënduar në hyrje të qytetit të Tiranës. Vendi dhe koha e ekzekutimit të masës së sigurimit nuk ngrenë dyshime për ekzistencën e ndonjë rreziku dhune ndaj punonjësve të policisë.

16. Automjeti me të cilin lëvizte kërkuesi është bllokuar nga disa automjete private, pa shenja

identifikuese dhe pa asnjë mbishkrim policor dhe është rrethuar nga shumë persona të armatosur dhe me maska, të veshur me uniforma të zeza, pa logo, pa distinktivë ose shenja dalluese. Kërkuesi është nxjerrë forcërisht nga automjeti në të cilin udhëtonte dhe në mënyrë të dhunshme është detyruar të hipte në një nga automjetet private që i bllokuan rrugën. Mënyra dhe veprimet e kryera gjatë momentit të ekzekutimit të masës janë filmuar dhe janë publikuar menjëherë me anë të transmetimit pothuajse në të gjitha mediat televizive duke tërhequr vëmendje të gjerë publike, me fokus te personaliteti dhe detyrat e larta që kërkuesi kishte ushtruar. Këto rrethana janë tregues se veprimtaria e punonjësve të Policisë së Shtetit është ushtruar me qëllim për të përçmuar kërkuesin publikisht, duke zvogëluar dinjitetin e tij njerëzor dhe duke i ngjallur atij inferioritet dhe frikë për të thyer rezistencën morale dhe fizike.

17. Ndërkohë, nisur nga transmetimi i gjerë televiziv i rrethanave të arrestimit të kërkuesit, Avokati i Popullit me nismën e tij ka kryer hetim administrativ të veprimtarisë së punonjësve të policisë, që është finalizuar me raportin e datës 7.8.2025. Sipas raportit, veprimet në terren për gjetjen, ndalimin dhe shoqërimin e tij u kryen nga punonjësit e Policisë së Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale, pa pasur të pranishëm oficerë të BKH-së (struktura e Prokurorisë së Posaçme). Po kështu, sipas raportit, kërkuesi është ndaluar nga një numër i konsiderueshëm punonjësish policie të veshur me uniformë, me maska në fytyrë dhe të armatosur, të shoqëruar me automjete civile, të cilët kanë komunikuar dhe debatuar midis tyre, kanë nxjerrë forcërisht kërkuesin nga mjeti i tij dhe e kanë shoqëruar në mjediset e policisë. Në analizën e gjetjeve, Avokati i Popullit ka evidentuar, se: i. nuk është argumentuar pse ndalimi dhe arrestimi i kërkuesit është cilësuar si operacion special dhe pse ai paraqiste rrezikshmëri të lartë shoqërore për përfshirjen e Forcës Speciale Operacionale. Gjatë kohës që kanë nisur hetimet dhe është kërkuar paraqitja e tij në Prokurorinë e Posaçme, ai është paraqitur vullnetarisht kur është thirrur, sikurse është pasqyruar edhe në media; ii. punonjësit e policisë nuk kanë qenë të pajisur me kamera trupi për të bërë të mundur dokumentimin e veprimeve të tyre gjatë ndalimit të kërkuesit dhe



komunikimin me të (policia ka informuar se nuk ka parashikime nënligjore për këtë qëllim, si dhe ka pasur probleme për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e këtyre kamerave); iii. Policia e Shtetit nuk ka sqaruar se cilat kanë qenë mjetet e identifikimit të punonjësve të policisë që kanë kryer shoqërimin, si dhe nuk kanë dhënë shkaqet dhe arsyet e shoqërimit të kërkuesit të prangosur, dhe se ky fakt nuk rezulton të jetë pasqyruar në regjistrat përkatës e të jetë mbajtur dokumentacioni i parashikuar; (iv) Policia e Shtetit nuk disponon dhe nuk ka vënë në dispozicion të Avokatit të Popullit kopje të dokumentacionit të mbajtur për shoqërimin e kërkuesit dhe nuk ka argumentuar se cila ka qenë domosdoshmëria e rrethimit të tij nga forcat e shumta të policisë, ose përse forcat e policisë që kanë kryer shoqërimin kanë qenë me maska dhe me jelekë ku vetëm në pjesën e pasme shkruhej “Policia”, ndërkohë që në pjesën e përparme nuk rezulton të ketë numër identifikimi dhe shenja dalluese, si edhe automjetet e policisë nuk kanë qenë të pajisura me stema dhe logot përkatëse; (v) kërkuesi është tërhequr forcërisht (sipas pamjeve filmike) dhe momenti i ndalimit të ish-Kryetarit të Kuvendit dhe ish-Presidentit e kryetarit të një nga paritë politike opozitare nuk i plotëson kushtet e trajtimit dinjitoz. Po kështu, edhe përdorimi i prangave brenda ambienteve të policisë përbën trajtim denigrues.

18. Në datën 23.10.2024 kërkuesi është marrë në pyetje nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e cila ka verifikuar kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit, si dhe nevojat e sigurimit, duke vlerësuar në përfundim vijimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, masa e sigurimit të arrestit në burg është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit në datën 19.11.2024, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në datën 27.2.2025.

19. Përgjatë gjithë procedurave gjyqësore kërkuesi ka pretenduar përpara gjykatave të zakonshme se ekzekutimi i masës ka qenë i dhunshëm deri në masën e poshtërimit, denigrimit dhe trajtimit çnjerëzor, duke sjellë, për pasojë, cenimin e së drejtës së garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së.

20. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në vendimin e datës 23.10.2024, është shprehur se ajo ka për detyrë të marrë në pyetje të arrestuarin, si dhe të

verifikojë kushtet e zbatimit të masës së sigurimit dhe nevojave të saj. Sipas saj, pavarësisht se pjesë e këtij gjykimi është verifikimi i kushteve të zbatimit të arrestit dhe nevojave të sigurimit, nisur nga kërkesa e prokurorit dhe pretendimeve të personave nën hetim, ajo do të analizojë kushtin e rëndësishëm për caktimin e masës, atë të dyshimit të arsyeshëm në raport me personat nën hetim (*shih faqet 176 – 177 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

21. Edhe GJKKO-ja e Apelit nuk e ka marrë në shqyrtim pretendimin për trajtimin poshtërues, me arsyetimin se veprimtaria e Policisë së Shtetit për ekzekutimin e masës së sigurimit nuk kishte qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ndaj nuk mund të kontrollohej as prej saj. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka shqyrtuar as pretendimet mbi paligjshmërinë e urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e masës së sigurimit, duke u shprehur se ato pretendime nuk ndikojnë në vendimmarrjen për caktimin dhe vazhdimin e arrestit në burg (*shih faqet 136–138 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

22. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se pretendimet ndaj veprimeve të kryera nga agjentët e policisë, të cilët vepruan në bazë të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale dhe të urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, mund të jenë objekt i një kallëzimi penal kundrejt punonjësve të policisë, por nuk ndikojnë disponimet e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose ekzekutimin e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg (*shih paragrafin 33 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

23. Nga arsyetimi i gjykatave të zakonshme, rezulton se ato nuk kanë verifikuar rrethanat e arrestimit, me argumentin se ishin jashtë objektit të çështjes që po shqyrtonin. Ato nuk kanë marrë ndonjë masë aktive për t'i kërkuar prokurorit në seancë verifikimin e pretendimeve të kërkuesit. Përkundrazi, e kanë zhvendosur detyrimin të kërkuesit, duke u shprehur se ai mund të paraqiste vetë kallëzim, edhe pse fakti penal është i tillë që duhet të hetohet kryesisht dhe me shpejtësi, pa pasur nevojë për kallëzim nga i dëmtuari.

24. Në këtë situatë, kërkuesi ka paraqitur vetë kallëzim penal, i cili është regjistruar në vitin 2025, pra pothuajse pas një viti nga ngjarja. Gjykata për qëllime të gjykimit kushtetues kërkoi informacion



nga Prokuroria e Tiranës për ecurinë e hetimeve, megjithatë kjo e fundit paraqiti vetëm të dhëna sintetike, duke pamundësuar vlerësimin e diligjencës dhe efikasitetit të hetimeve penale. Konkretisht, Prokuroria e Tiranës, duke mos hedhur dritë mbi veprimet hetimore të kryera dhe rezultatet e tyre, informoi vetëm se ka regjistruar procedimin penal nr. 477 të vitit 2025, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i KP-së, se kërkuesi është evidentuar në cilësinë e kallëzuesit në librin e njoftimeve të veprave penale dhe se çështja ndodhet në fazën e hetimeve paraprake.

25. Në analizë të sa më sipër, konstatojmë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ushtruar funksionin e tyre kushtetues subsidiar. Megjithëse kërkuesi e kishte ngritur në mënyrë të vazhdueshme këtë pretendim në të gjitha shkallët e procedimit dhe, nga ana tjetër, rrethanat e ekzekutimit të masës ishin bërë publike, ato nuk e shqyrtuan atë. Argumenti se ky pretendim nuk lidhet me objektin e vlerësimit të masës është i papranueshëm, pasi e drejta kushtetuese e personit të arrestuar për t’u dëgjuar menjëherë nga gjykata përfshin edhe verifikimin e rrethanave të arrestimit. Këto rrethana, të bëra tashmë publike, ngrinin *prima facie* dyshime serioze se kërkuesi ishte ekspozuar ndaj një trajtimi poshtërues, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, i cili përbën një nga vlerat themelore të rendit kushtetues dhe duhet të respektohet nga çdo organ shtetëror.

26. Ky vlerësim mbështetet edhe në mënyrën e veprimit të Policisë së Shtetit, për të cilën Avokati i Popullit ka evidentuar se nuk dispononte asnjë të dhënë që kërkuesi të paraqiste rrezikshmëri ose prirje për sjellje të dhunshme, ndërkohë që ai ishte një figurë me profil të lartë publik dhe, në kohën e arrestimit, ushtronte aktivitet politik në opozitë me shumicën qeverisëse. Përkundrazi, ashtu siç ka evidentuar edhe Avokati i Popullit, rezultoi se kërkuesi ishte paraqitur vullnetarisht sa herë është thirrur nga organet e drejtësisë. Sjellja e Policisë së Shtetit, e orientuar drejt krijimit të një “spektakli mediatik” gjatë arrestimit të një individi që ka ushtruar funksionet më të larta shtetërore, prodhon pasoja negative në dy plane. Së pari, ajo cenon dinjitetin institucional të funksioneve publike që ai ka përfaqësuar, duke zbehur respektin që shteti duhet të ruajë për institucionet e veta. Së dyti, ajo dëmton besimin e publikut te

sistemi i drejtësisë, pasi krijon perceptimin se veprimet e autoriteteve synojnë ekspozimin dhe poshtërimin publik të individit, në vend të zbatimit të paanshëm dhe korrekt të ligjit.

27. Në këtë këndvështrim, kujtojmë se neni 15, pika 2, i Kushtetutës u ngarkon organeve të pushtetit publik jo vetëm detyrimin për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore, por edhe për të kontribuar në realizimin efektiv të tyre. Në rastin konkret, veprimet e ndërmarra ndaj kërkuesit dukshëm kanë cenuar dinjitetin e tij. Gjykata ka theksuar se dinjiteti njerëzor qëndron në themel të të gjithë sistemit të vlerave kushtetuese dhe gëzon përparësi ndaj çdo vlere tjetër kushtetuese, pasi përshton tërësinë e të drejtave të njeriut dhe luan rol përcaktues në interpretimin e rendit juridik e kushtetues (*shih vendimin nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Dinjiteti njerëzor përbën një vlerë themelore dhe të patjetërsueshme, e cila i përket çdo personi vetëm për shkak të qenies së tij njerëzore. Për rrjedhojë, respektimi i tij nuk mund të vihet në diskutim dhe as të kushtëzohet nga statusi i individit, rrethanat në të cilat ai gjendet ose dyshimet që mund të rëndojnë mbi të. Ai qëndron mbi çdo vlerësim që lidhet me sjelljen ose pozitën e personit dhe, për këtë arsye, duhet të respektohet në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, përfshirë rastet kur individi është subjekt i procedimeve penale, ose i masave shtrënguese të autoriteteve publike.

28. Për rrjedhojë, çdo veprim që mund të bjerë nën fushën e ndalimit të nenit 25 të Kushtetutës jo vetëm duhet të ndërpritet menjëherë, por edhe të hetohet me shpejtësi dhe efektivitet. Ky detyrim, në rastin konkret, rezultoi i papërmbyshur. Asnjë prej organeve kompetente nuk ndërmori masa të menjëhershme për sqarimin e ngjarjes, identifikimin e përgjegjësve dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë. Më tej, as GJKKO-ja e Apelit dhe as Gjykata e Lartë nuk dhanë një përgjigje të plotë ndaj këtij pretendimi, ndërsa prokuroria regjistroi procedimin penal vetëm pas afro një viti nga ngjarja, mbi bazën e kallëzimit të kërkuesit, duke shmangur njëkohësisht dhënien e informacionit për ecurinë e hetimeve.

29. Në një shoqëri demokratike, keqtrajtimi nuk mund të përbëjë kurrë një përgjigje të pranueshme ndaj sfidave me të cilat përballen autoritetet publike. Në veçanti, policia duhet të



përmbahet nga çdo veprim që shkakton, nxit ose toleron torturën apo trajtimin çnjerëzor, ose poshtërues, në çdo rrethanë. Po kështu, shteti ka detyrimin pozitiv të sigurojë që zyrtarët e zbatimit të ligjit të trajnohen dhe të veprojnë sipas standardeve më të larta të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë, në mënyrë që askush të mos ekspozohet ndaj dhunës ose keqtrajtimit. Në rastin konkret, pamjet e transmetuara gjatë ekzekutimit të masës së arrestit ishin të tilla që mund të shkaktonin te kërkuesi, por edhe te çdo person tjetër në të njëjtën situatë, ndjenja frike, ankthi, poshtërimi dhe denigrimi, duke cenuar respektin për dinjitetin njerëzor. Për këtë arsye, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se mënyra e ekzekutimit të masës përmbush elementet e trajtimit degradues, pasi shkaktoi poshtërim dhe cenoi dinjitetin e kërkuesit, duke ngjallur ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti të afta për të thyer rezistencën e tij morale. Madje, rrethanat konkrete e afrojnë këtë trajtim edhe me konceptin e trajtimit çnjerëzor, i cili karakterizohet nga veprime të qëllimshme ose të kryera me shpërfillje të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor, që tejkalojnë kufijtë e sjelljes së pranueshme të autoriteteve publike dhe shkaktojnë vuajtje serioze fizike ose psikologjike. Sipas vlerësimit tonë, pikërisht këto elemente ishin të pranishme në mënyrën e ekzekutimit të masës së arrestit ndaj kërkuesit.

30. Në kushtet kur ekzekutimi i masës së sigurimit ka cenuar standardet dhe garancitë kushtetuese, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit dhe konstatimin e cenimit të së drejtës, të parashikuar nga neni 25 i Kushtetutës.

Anëtare: Marjana Semini, Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Ilir Metaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimin që kanë caktuar masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, kam mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në vlerësimin tim, kërkesa duhej të pranohej, pasi pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës,*

dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, si rezultat i mënyrës së ekzekutimit të masës së sigurimit personal atij dhe për cenimin e *lirisë personale,* si rezultat i shkeljes së standardit të dyshimit të arsyeshëm, janë të bazuara. Po kështu, unë mbaj qëndrimin që për shkak të natyrës së shkeljeve në rastin konkret, e vetmja mënyrë për riparimin/korrigjimin e tyre do të ishte kthimi i çështjes për shqyrtim në GJKKO-në e Apelit. Në vijim do të parashtoj argumentet mbi të cilat është mbështetur qëndrimi im si gjyqtare në pakicë.

2. Fillimisht, lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues,* të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, në këtë qasje i jam bashkuar qëndrimit të mbajtur nga gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Marjana Semini, bazuar mbi të njëjtat argumente të parashtruara në mendimin e tyre në pakicë për këtë aspekt të procedurës. Megjithatë, pa dashur të bie në përsëritje, në mënyrë të përmbledhur, parashtoj se sjellja dhe veprimet e autoriteteve shtetërore të ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e masës së sigurimit janë të tilla që përbëjnë sjellje poshtëruese dhe denigruese ndaj kërkuesit. Momenti i ekzekutimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit është bërë publik për shkak se ai është filmuar dhe më pas këto pamje janë shfaqur dhe publikuar në të gjitha mediat dhe rrjetet sociale, pamje nga të cilat është e dukshme mënyra e sjelljes së autoriteteve dhe mënyra e ekzekutimit të masës së arrestit nëpërmjet ushtrimit të forcës ndaj kërkuesit për ta detyruar atë të dalë nga automjeti në të cilin ndodhej në momentin e ndalimit.

3. Në vlerësimin tim, këto pamje janë të mjaftueshme për të konstatuar se sjellja e autoriteteve ka qenë joproporcionale në raport me qëllimin e synuar, duke shkuar deri në kufijtë e poshtërimit dhe denigrimit të kërkuesit, duke sjellë për pasojë cenimin e dinjitetit të tij. Publikimi i këtyre pamjeve dhe të dhënat që përftohen prej tyre, nga njëra anë, përbënin arsye të mjaftueshme edhe për hetimin (kryesisht) me nismë të ngjarjes nga autoritetet e ndjekjes penale dhe, nga ana tjetër, u kanë dhënë mundësinë gjykatave të zakonshme që të merrnin në shqyrtim dhe të vlerësonin pretendimin e kërkuesit në këtë drejtim, të paraqitur përpara tyre gjatë kohës së



vlerësimit të masës së sigurimit personal. Kjo sepse çështja e mënyrës së ekzekutimit të masës së sigurimit personal është pjesë e pandashme e kontrollit kushtetues që ushtron Gjykata për verifikimin e kushtetutshmërisë së procedurës për vlerësimin dhe ekzekutimin e masës dhe respektimin e të drejtave e lirive individuale të kërkuesit. Ndonëse ka rezultuar se organet e ndjekjes penale kanë nisur një procedim penal, ku hetimi ka nisur pas pothuajse 1 viti nga ngjarja dhe vetëm mbi kallëzimin e kërkuesit, qëllimi dhe natyra e këtij procedimi synojnë të verifikojnë ligjshmërinë e veprimeve të personave që kanë ekzekutuar masën e sigurimit, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë penale të tyre, ndërkohë që pretendimi i parashtruar përpara gjykatave të zakonshme dhe në ankimin kushtetues ka të bëjë me liritë dhe të drejtat kushtetuese, pra me kushtetutshmërinë e procedurave penale të zbatuara në këtë rast. Për rrjedhojë, gjykatat nuk kishin asnjë pengesë ligjore dhe kushtetuese të analizonin, vlerësonin dhe arsyetonin në mënyrë shteruese se deri në çfarë mase ka shkuar ndërhyrja e autoriteteve shtetërore ndaj të drejtave dhe lirive themelore të kërkuesit për ekzekutimin e masës së sigurimit personal. Me fjalë të tjera, gjykatat duhet të merrnin në shqyrtim, pa i hyrë analizës së elementeve të fajësisë ose të veprave penale për të cilat akuzohet kërkuesi, mënyrën e ekzekutimit të masës, duke dhënë argumente të plota nëse ajo kishte tejkaluar garancitë kushtetuese, duke sjellë për pasojë edhe cenimin *per se* të vet ligjshmërisë së masës së sigurimit personal. Porë nga kjo optikë, kam vlerësuar se gjykatat e zakonshme kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues të merrnin në shqyrtim pretendimin e kërkuesit, i cili ka qenë një nga shtyllat bazë të mjeteve të tij të ankimit dhe t'i jepnin atij një përgjigje shteruese. Për këtë arsye, për nga natyra e pretendimit dhe e rrethanave konkrete, kthimi i çështjes për shqyrtim në gjykatat e faktit, konkretisht në GJKKO-në e Apelit, edhe për këtë pretendim me natyrë kushtetuese, do të ishte mjeti më i përshtatshëm për rivendosjen në vend të së drejtës së kërkuesit, duke i dhënë mundësinë që ajo gjykatë të shqyrtonte në themel pretendimin për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues*, bazuar në garancitë dhe standardet kushtetuese të normuara në nenin 25 të Kushtetutës dhe të

elaboruara gjerësisht nga jurisprudenca e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së.

4. Për sa i takon pretendimit tjetër për cenimin e *lirisë personale* të parë në aspektin e standardit të dyshimit të arsyeshëm, vlerësoj se ai është i bazuar, pasi, në qasjen time, gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse në drejtim të ekzistencës së provave që justifikojnë dyshimin se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet, të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi i dytë dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së.

5. Për qëllim të analizës sime sjell në vëmendje se neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*paragrafi 1*), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale (*paragrafi 2, shkronja "c"*). Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se synimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Kërkesa "dyshime të arsyeshme" për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkallë të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një vepër penale (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për caktimin e masës ekstreme të arrestit në burg të një individ, mbahet në konsideratë konteksti i



përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuarit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e organeve të procedimit penal (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, gjykatat e zakonshme në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm, si një nga elementet kryesore në caktimin e një mase sigurie, e sidomos “Arresti në burg” kanë parashtruar disa fakte, veprime dhe mosveprime të atribuara kërkuarit, duke i lidhur me ushtrimin e funksionit të tij si ministër, si Kryetar i Kuvendit dhe kryetar i partisë LSI. Kështu, sipas gjykatave, në gjendjen që janë aktet në ngarkim të kërkuarit ka rrethana që tregojnë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se:

i. në sajë të pozicionit të tij zyrtar si ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë, e cila ushtronte të drejtat dhe administronte aksionet e shtetit shqiptar pranë shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. ka arritur të ndërmjetësojë lidhjen e një kontrate midis CEZ Shpërndarje dhe shoqërisë D.I.A., me administrator në atë kohë shtetasin K.I., me qëllim që kjo e fundit t’i ofronte shërbime CEZ-it, duke identifikuar debitorët dhe shumat monetare që ata i detyroheshin kompanisë. Sipas gjykatave, kërkuari ka përdorur influencën e tij për të bërë të mundur lidhjen e kontratës me një shoqëri të drejtuar nga K.I., pikërisht për shkak të lidhjeve të mëparshme që ai kishte me këtë person dhe me qëllim ndërtimin e një marrëdhënieje korruptive. Sipas arsyetimit të gjykatave, nga provat e siguruar nga Prokuroria e Posaçme dokumentohet se të paktën në një rast ai ka kërkuar dhe ka marrë nga shtetasi K.I. shuma të konsiderueshme parash, duke krijuar te gjykata bindjen se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ka konsumuar në këtë mënyrë elementet e figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë dhe i të zgjedhurve”, të parashikuar nga neni 260 i KP-së;

ii. në sajë të detyrës që ai ka mbajtur si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, por edhe si kryetar i partisë LSI, ai ka ushtruar ndikimin e tij te kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, person nën hetim (i zgjedhur nga Kuvendi në kohën e drejtimit nga kërkuari, me propozim të partisë të drejtuar prej tij), si dhe së bashku me

bashkëshorten e tij, personi tjetër nën hetim, kanë ushtruar ndikim te drejtori i kompanisë të telefonisë celulare V., në mënyrë që të lidhej kontrata midis V. dhe U.C.Inc., administrator i së cilës ka qenë A.Sh., me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/interkonjeksionin. Sipas gjykatave, si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, kërkuari, në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim - njëkohësisht edhe bashkëshorte e tij - kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, por edhe një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes. Në këto kushte, shprehen gjykatat, krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuari ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë dhe i të zgjedhurve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 260 e 25 i KP-së;

iii. në kohën që personi nën hetim, kërkuari, ka qenë Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personi tjetër nën hetim, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Sipas gjykatave, si rezultat i marrëdhënies së krijuar, kërkuari dhe bashkëshortja e tij kanë pranuar propozimin e biznesmenit S.M. për të përfituar një vilë të ndërtuar në një kompleks rezidencial. Në analizë të gjykatave, pasi ky fakt është marrë vesh edhe nga persona të tjerë, duke përfshirë dhe ambasadorin grek në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi, duke mos e finalizuar marrëdhënien. Sipas vlerësimit të gjykatave, si rrjedhojë e sa më lart, krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuari ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë dhe i të zgjedhurve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 260 e 25 i KP-së;

iv. në arsyetimin e gjykatave, nëpërmjet blerjes së banesës së tij në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personi tjetër nën hetim, kërkuari ka përdorur si mekanizëm marrjen e kredive bankare, shlyerja e të cilave është bërë më pas nga vjehrra e tij me shuma të konsiderueshme parash, të cilat as i ka pasur dhe as ka pasur mundësi t’i siguronte. Në këtë mënyrë është bërë përfshirja në sistemin bankar dhe investimi në pasuri të paluajtshme i shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të



prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit. Në këtë mënyrë, kanë vlerësuar gjykatat, krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi në bashkëpunim me personat e tjerë nën hetim, bashkëshorten dhe vjehrrën e tij, kanë konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së;

v. në lidhje me pozicionin e tij si kryetar i partisë LSI, nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të lobimit, marrjes së shërbimeve nga këto kontrata dhe financimit me shuma të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat e SHBA-së nga llogari të padeklaruara prej tij, dhe mosdeklarimit të shpenzimeve sipas ligjit në KQZ-së, sipas gjykatave, krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në këtë mënyrë me shumë se një herë, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së;

vi. sipas analizës së gjykatave, nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht në deklaratën e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në ILDKPKI në vitin 2020, sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurive, ndërkohë që dyshohet se nuk ka pasur mundësi për t'i siguruar këto shuma parash nëpërmjet burimeve të ligjshme, por edhe për përfshirje në veprimtari kriminale të korrupsionit, pra paligjshmëria e burimeve, kërkuesi dyshohet se ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të kryer kryesisht në formën e deklarimit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së.

8. Siç mund të evidentohet edhe nga renditja e analizës sa më lart për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në lidhje me secilën nga veprat penale të atribuara kërkuesit në gjykimin kushtetues, gjykatat e faktit kanë vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” në 3 (tre)

raste, nga të cilat në dy raste është kryer në bashkëpunim, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dhe “Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi i dytë 2 dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së.

9. Konkretisht, gjykatat në analizën e tyre kanë listuar rreth 179 prova, si: procesverbale, vendime për këqyrje, kontrata, dokumente, shkresa, mandate arkëtimi etj. (*shih faqet 184–196 të vendimit të GJKKO-së Shkallës së Parë të datës 23.10.2024*), pra kryesisht të natyrës dokumentare, por pa përcaktuar në asnjë moment se cilat prej tyre u përkasin rrethanave dhe fakteve penale që i atribuohen kërkuesit, ndërkohë që duhet evidentuar se së bashku me kërkuesin janë përfshirë në proces edhe më së paku 4 persona të tjerë të afërm dhe bashkëpunëtorë të tij.

10. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, provat e administruara gjatë hetimit vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm se veprimet e kryera nga kërkuesi përmbushin anën objektive të figurave të veprave penale për të cilat ai akuzohet (*shih faqet 154–155 të vendimit të datës 20.10.2024 dhe faqen 184 të vendimit të datës 23.10.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

11. Me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë është pajtuar tërësisht edhe GJKKO-ja e Apelit, e cila ka çmuar se provat e grumbulluara deri në këtë fazë të procedimit janë të afta, në standardin provues të “dyshimit të arsyeshëm”, për të dëshmuar ekzistencën e fakteve, veprat penale konkrete dhe elementet e nevojshme që lidhin kërkuesin me faktet penale që i atribuohen atij (*shih faqe 146 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

12. Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të mjaftueshëm këtë arsyetim të gjykatave të faktit, duke u shprehur njësoj si gjykata e apelit se provat e grumbulluara deri në këtë fazë të procedimit janë të afta, në standardin provues të “dyshimit të arsyeshëm”, për të dëshmuar ekzistencën e fakteve, veprat penale konkrete dhe elementet e nevojshme dhe të mjaftueshme që lidhin kërkuesin me faktet që i atribuohen atij (*shih paragrafin 38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

13. Ky arsyetim i gjykatave të zakonshme është gjetur i drejtë dhe i bazuar nga shumica, e cila ka lënë të pacenuar vendimarrjen e kundërshtuar në



ankimin kushtetues, duke rrëzuar si të pabazuara pretendimet e kërkuarit. Sipas shumicës, në çështjen penale ndaj kërkuarit ka fakte dhe informacione që arrijnë të bindin një vëzhgues të jashtëm se kërkuari mund të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet, ndaj nuk mund të arrihet në përfundimin se kufizimi i lirisë së tij është kryer në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së (*shih paragrafin 62 të vendimit*).

14. Duke pasur parasysh se bazuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli kushtetues për verifikimin e kushtetutshmërisë së masës kufizuese të lirisë personale ushtrohet përmes verifikimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore në drejtim të mënyrës sesi kanë vlerësuar dhe zbatuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masës ekstreme “Arresti në burg”, si dhe referuar këtij arsyetimi në drejtim të atyre fakteve dhe provave të nevojshme për të justifikuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, si standardi kushtetues që duhet të respektohet në rastet përjashtimore të kufizimit të lirisë, unë jam e qëndrimit se gjykatat e zakonshme kanë dështuar në këtë drejtim.

15. Bazuar edhe në sa është referuar më sipër (*shih paragrafin 7 të mendimit tim të pakicës*) unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se arsyetimet e të tria gjykatave për veprimet ose mosveprimet të cilat dyshohet se i ka kryer kërkuari bazohen mbi fakte të përgjithshme, të pakonkretizuara e sidomos në drejtim të lidhjes së veprave penale individualisht me kërkuarin. Në vlerësimin tim, gjykatat janë bazuar në arsyetime *de plano*, të përgjithshme, duke shkuar deri në analizën se për këtë shkak dhe në ushtrim të funksioneve të larta shtetërore të kryera nga kërkuari, ai mund të ketë përdorur ndikimin ose influencën e tij, por pa e konkretizuar këtë dyshim me sjellje ose veprime konkrete që përbëjnë elemente të veprave penale. Kjo analizë, duke qenë kaq formaliste dhe e përgjithshme, bën që kontrolli i gjykatave të jetë tërësisht formal, thjesht duke renditur, listuar dhe evidentuar në mënyrë mekanike provat, por pa kryer ndonjë analizë të thelluar se në ç’mënyrë për çdo rast funksioni i mbajtur nga kërkuari ndërhynte deri në masën që të konfigurohej në veprën penale të atribuar atij. Kontrolli i tyre ka qenë formal, pra ato kanë listuar dhe evidentuar provat, por pa verifikuar nëse ato japin të dhëna të

mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm.

16. Lidhur me sa më lart, sjell në vëmendje standardet e zhvilluara nga GJEDNJ-ja në praktikën e saj të konsoliduar, sipas së cilës “arsyeshmëria” e dyshimit mbi të cilin duhet të bazohet një arrestim përbën një pjesë thelbësore të mbrojtjes së përcaktuar në nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së (*shih Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 314; Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë, datë 20.3.2018, § 124; Fernandes Pedrosa kundër Portugalisë, datë 12.6.2018, § 87*). Fakti që një dyshim mbahet me mirëbesim është i pamjaftueshëm në vetvete (*shih Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 10.11.2020, § 145*). Sipas GJEDNJ-së, një “dyshim i arsyeshëm” se është kryer një veprë penale supozon ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të bindte një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë penale (*shih Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 314; Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit, datë 22.5.2014, § 88*). Dyshimet duhet të justifikohen me prova të verifikueshme dhe objektive. Referencat e paqarta dhe të përgjithshme në vendimet dhe dokumentet e autoriteteve për një dispozitë ligjore ose “material të çështjes” të paspecifikuar nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të justifikuar “arsyeshmërinë” e një dyshimi, në mungesë të ndonjë deklarate, informacioni ose ankese specifike (*shih Akgün kundër Turqisë, datë 20.7.2021, §§ 156 dhe 175*).

17. Sipas GJEDNJ-së, si rregull, problemet me “arsyeshmërinë e dyshimit” lindin në nivelin e fakteve. Pyetja atëherë është nëse arrestimi dhe ndalimi janë bazuar në elemente të mjaftueshme objektive për të justifikuar një “dyshim të arsyeshëm” se faktet në fjalë kanë ndodhur në të vërtetë. Përveç anës së saj faktike, ekzistenca e një “dyshimi të arsyeshëm” kërkon që faktet të mund të konsiderohen në mënyrë të arsyeshme se bien nën një nga nenet e ligjit që merret me sjelljen kriminale (*shih Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 317; Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 10.11.2020, §§ 146-147*).

18. Në kontekst të këtyre standardeve dhe referuar arsyetimit të gjykatave të zakonshme në vendimet objekt të ankimit kushtetues, ritheksoj se pavarësisht numrit të konsiderueshëm të provave dhe akteve të mbledhura dhe të referuara, gjykatat



nuk kanë qenë në gjendje të argumentojnë se cilat janë ato të dhëna që përftohen nga këto prova, të cilat vetëm për kërkuesin (jo për të hetuarit e tjerë) janë të mjaftueshme dhe në gjendje që të justifikojnë “arsyeshmërinë” e dyshimit se ai mund të ketë kryer veprat penale në fjalë. Në vlerësimin tim, i cili bazohet vetëm mbi sa është arsyetuar/ argumentuar/parashtruar nga gjykatat e faktit e të ligjit dhe jo mbi ndonjë vlerësim ose analizë të vet këtyre provave e akteve, duke mos qenë ky as rasti konkret (ndonëse në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se në disa raste vlerësimi i provave bën pjesë në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 26, datë 29.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*)), as qëllimi im nën këtë analizë kushtetuese të çështjes së shtruar për shqyrtim përpara kësaj Gjykate. Në vendimet gjyqësore shumë voluminoze gjykatat nuk kanë mundur të dalin as në këtë rast përtej formalizmit në arsyetimin e kësaj kategorie vendimesh për caktimin e masës së sigurimit, pa mundur të dëshmojnë provat dhe lidhjet mes tyre që u kanë krijuar bindjen se për kërkuesin dhe vetëm për atë ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer ndonjë vepër penale ai vetë ose në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim. Në të kundërt, me çfarë pretendohet nga shumica, në referim të vendimeve gjyqësore, është e evidentueshme se ato nuk kanë mundur të dëshmojnë qoftë edhe në nivelin e indicieve minimale faktet penale që i janë ngarkuar kërkuesit.

19. Vlerësoj me rëndësi të theksoj se pjesa më e madhe e provave në mënyrë të dukshme janë dokumente shkresore administrative lehtësisht të aksesueshme dhe qartësisht transparente se gjithçka e kryer ka qenë brenda ushtrimit të detyrave normale nga kërkuesi në cilësinë e ministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarit të një partie politike dhe gjykatat kanë aluduar për ushtrimin e influencës prej tij pa mundur të tregojnë mundësinë që një gjë e tillë të ketë ndodhur.

20. Në situatën që vlerësimi i gjykatave të zakonshme ka qenë formal, i takonte gjykimit kushtetues të bënte kontrollin efektiv të zbatueshmërisë së standardeve në rastin konkret. Në këtë pikë ritheksoj se dyshimet duhet të lindin dhe të bazohen në prova dhe nuk duhet të prezumohen bazuar në natyrën/rëndësinë e veprave penale të dyshuara si të kryera ose në aludimet e paqartësitë e akuzës, pasi përfundojnë hetimet. Kjo do të thotë se nëse provat mbi të cilat mbështetet fillimisht kërkesa për caktimin e masës e pas kësaj vendimet që

kufizojnë lirinë përmes paraburgimit të personit të hetuar janë të mangëta/të paplota/të paqarta ose të paafta të lindin dyshimin e arsyeshëm, masa shndërrohet në haptazi arbitrare. Kjo konstatohet edhe në rastin e kërkuesit sa kohë gjykatat nuk kanë argumentuar mbi prova të plota/të mjaftueshme e bindëse që të japin të dhëna se dyshimet kanë bazë të arsyeshme për përfshirjen e kërkuesit në një veprimtari kriminale që legjitimon kufizimin e lirisë së tij.

21. Parë nga kjo optikë çmoj se të dhënat që referojnë gjykatat se përbëjnë elemente të mjaftueshme për të vendosur kufizimin e lirisë së kërkuesit nuk arrijnë të përmbushin as atë prag minimal që është i nevojshëm për të lindur dyshimin te një vëzhgues objektiv se ka pasur një vepër penale dhe se autor i saj mund të jetë kërkuesi. Përkundrazi, e ritheksoj se veprimet e kërkuesit të analizuar nga gjykatat kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të disa funksioneve prej tij, si në pozitën e funksionarit publik, ashtu edhe të drejtuesit të partisë politike, por nuk përmbajnë ato elemente objektive që duhet të jenë të mjaftueshme për të justifikuar “dyshimin e arsyeshëm” se ato fakte të pretenduara kanë ndodhur vërtet dhe se i atribuohen kërkuesit. Për më tepër, arsyetimi i gjykatave është bazuar në të njëjtat fakte dhe argumente të parashtruara nga organi i prokurorisë dhe mbi të njëjtin kualifikim penal të bërë prej tij, pa analizuar dhe vlerësuar në themel bazueshmërinë e kërkesës për caktimin e masës sipas standardeve kushtetuese në drejtim të dyshimit të arsyeshëm.

22. Për sa më sipër, në vlerësimin tim është e dukshme se gjykatat kanë dështuar që të arsyetojnë, në përputhje me praktikën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në këtë aspekt, pra në këndvështrim të përmbushjes së garancisë kushtetuese sipas nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, që lejon përjashtimisht kufizimin e lirisë personale të individit, duke mos ushtruar rolin e tij subsidiar të kontrollit kushtetues të veprimeve të autoriteteve publike dhe të ndalimit të arbitraritetit në ushtrimin e veprimtarisë së këtyre të fundit. Duke iu referuar standardit të përdorur në këto raste, në çështjen e kërkuesit arsyetimi i gjykatave nuk bind qoftë edhe një vëzhgues objektiv se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

23. Në kontekst të fakteve të parashtruara nga gjykatat e zakonshme në vendimet objekt të ankimit kushtetues individual, çmoj se gjykatat nuk kanë



mundur të argumentojnë dhe të parashtrojnë ekzistencën e fakteve dhe informacioneve që e lidhin kërkuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të paekuivokë me veprat penale për të cilat ai dyshohet, rrjedhimisht rezulton se kërkuesi është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, duke i sjellë atij cenimin e nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së. Në kushtet kur kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bërë në shkelje të standardit të dyshimit të arsyeshëm, pasi nuk është bazuar në prova dhe fakte konkrete dhe të individualizuara, çmoj se nuk është më e nevojshme analiza e aspektit të proporcionalitetit të ndërhyrjes.

24. Për të gjitha argumentet e parashtruara më sipër kam votuar për pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimeve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe të GJKKO-së Apelit, duke u vendosur kthimi i çështjes pranë GJKKO-së së Apelit për shqyrtimin e saj dhe rivendosjen në vend të të drejtave dhe lirive kushtetuese të cenuara sipas pretendimeve të kërkuesit.

Anëtare: Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 49, datë 8.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 7.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 33 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Altina Nasufi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Presidenti i Republikës, në mungesë.

Këshilli i Larë Gjyqësor, përfaqësuar nga kryetari

Ilir Rusi.

Vojsava Kola, Në Mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 44 (86-2023-775), datë 14.7.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 537, datë 14.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”, dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për rimarrjen në shqyrtim të vlerësimit etik dhe profesional të kërkueses për vitin 2021.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Altina Nasufi (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLJG*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, Presidentit të Republikës dhe Vojsava Kolës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimet nr. 535, 536 dhe 537 të datës 17.11.2021, KLJG-ja ka vendosur hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicione të lira, një në fushën e së drejtës administrative (vendimi nr. 535/2021) dhe dy të tjera në fushën e së drejtës civile (vendimet nr. 536/2021 dhe 537/2021). Për këto pozicione ka aplikuar pranë KLJG-së edhe kërkuesja, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit. Në kuadër të këtyre procedurave, KLJG-ja ka kryer vlerësimet e kandidatëve dhe me vendimin nr. 537, datë 14.12.2022, “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”, e ka vlerësuar kërkuesen



në nivelin “shumë mirë”, me 382 pikë. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19 (86-2023-362), datë 27.3.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuësës për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021 (*vendimi nr. 19/2023*), vendim i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5489 (316), datë 11.7.2024. Më parë, me vendimin nr. 00-2023-1966, datë 22.5.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuësës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 19/2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka rrëzuar padinë e saj lidhur me vlerësimin etik dhe profesional.

2. Ndërkohë, pas njoftimit të vendimit të mësipërm të Gjykatës Administrative të Apelit, KLGJ-ja ka vijuar procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionet e shpallura dhe, me vendimin nr. 212, datë 28.4.2023, ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535/2021 të saj, dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion kandidaten të renditur të parën, e cila, më pas, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë me dekretin nr. 78, datë 6.6.2023 të Presidentit të Republikës. Ky vendim i KLGJ-së është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuësja. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 28, datë 19.5.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë (*vendimi nr. 28/2023*). Çështja rezulton e regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 31003-00452-00-2025, me status “*në proces*”.

3. Me vendimin nr. 315, datë 14.6.2023, KLGJ-ja ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536/2021 të saj, dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion subjektin e interesuar Vojsava Kola, e renditur e para. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuësja, e cila ka pretenduar se për kërkuësen nuk ka ende një vendim përfundimtar për vlerësimin e saj etik dhe profesional, në kushtet kur vendimi nr. 19/2023 i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e padisë së kërkuësës, me të cilën ka kundërshtuar vlerësimin etik e profesional të dhënë me vendimin e KLGJ-së nr. 537, datë 14.12.2022, nuk është një vendim përfundimtar, përderisa ende nuk është gjykuar nga Gjykata e Lartë.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 44 (86-2023-775), datë 14.7.2023 (*vendimi nr. 44/2023*) ka vendosur të rrëzojë padinë e kërkuësës. Pasi ka evidentuar se për këto lloj vendimesh, kundërshtimi mund të motivohet vetëm me shkelje në procedurën e ndjekur, ajo gjykatë ka konstatuar se në aktin administrativ të kundërshtuar nuk ka elemente të pavlefshmërisë absolute nga ato që përcaktohen në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) ose ligje të tjera. Pretendimet për paligjshmëri të aktit, ajo gjykatë i ka gjetur të pambështetura në ligj, duke argumentuar, se: kriteri i parë që dallon dhe rendit kandidatët e kualifikuar për ngritje në detyrë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë është rezultati i arritur prej tyre në dy “vlerësimet e mëparshme” dhe se në rastin konkret këto vlerësime etike dhe profesionale për të gjithë kandidatët e kualifikuar janë realizuar nga KLGJ-ja përpara fillimit të procedurës për renditjen dhe propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit të renditur i pari; KLGJ-ja nuk ka filluar dhe vijuar me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar dhe vlerësuar, si edhe me vendimmarrjen për renditjen dhe propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë përpara përfundimit të afatit ligjor të posaçëm të ushtrimit të së drejtës së kundërshtimit në gjykatë të akteve të saj për vlerësimin etik dhe profesional për secilin kandidat të kualifikuar, sikurse edhe përpara sesa Gjykata Administrative e Apelit të dispononte me vendim lidhur me padinë e ngritur nga kërkuësja; vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit është menjëherë i ekzekutueshëm, me shpalljen e tij, pra KLGJ-ja ka detyrimin ligjor të mbajë parasysh disponimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Me dekretin nr. 185, datë 3.8.2023 të Presidentit të Republikës, subjekti i interesuar, Vojsava Kola, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

6. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs kërkuësja. Pas marrjes dijeni për përbërjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtonte çështjen e saj, ajo ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e tyre. Me vendimin nr. 00-2024-4869, datë 10.12.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk është vërtetuar interes i drejtpërdrejtë i kryesueses në çështjen përkatëse, ndërsa për dy gjyqtarët e tjerë, ai kolegji ka vlerësuar



se kërkuesja nuk ka paraqitur argumente konkrete për përjashtimin e tyre.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkueses kundër vendimit nr. 44/2023 dhe me vendimin nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024 ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Gjykata e Lartë ka analizuar pretendimin lidhur me fuqinë ekzekutive të vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit, referuar në nenin 451 të KPC-së, nenin 41 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*) dhe në jurisprudencën e kësaj Gjykate dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka asnjë dyshim se vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit - si çdo vendim gjyqësor i formës së prerë - përbën një vendim të ekzekutueshëm, duke mos konstatuar asnjë pengesë ligjore për vijimin e veprimtarisë administrative të KLGJ-së në nxjerrjen e akteve objekt gjykimi, për sa kohë që gjykimi mbi vlerësimin etik dhe profesional të kërkueses ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit. Pretendimin për paanshmëri të anëtarëve të trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar, pasi ka çmuar se anëtarët e trupit gjykues kanë përmbushur detyrën funksionale duke interpretuar ligjin dhe kanë mbajtur qëndrim për mënyrën e zbatimit të ligjit material, për rrjedhojë nuk mund të ngrihet pretendimi mbi paanshmëri vetëm për shkak të mënyrës si gjykata interpreton ligjin. Sipas asaj gjykate, pretendimeve të kërkueses u është dhënë përgjigje e qartë dhe shteruese nga ana e gjykatës së apelit, ndërsa për pjesën e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, ka evidentuar se del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 29.5.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë rrëzuar padinë e saj për shfuqizimin e vendimit nr. 315, datë 14.6.2023 të KLGJ-së, me të cilin është miratuar renditja e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.

536/2021 të saj, si dhe është propozuar për emërim subjektin e interesuar, Vojsava Kola. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 13.6.2025. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, në datën 13.6.2025 kërkuesja ka hequr dorë nga pika 3 e objektit të tij, që lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 537, datë 14.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”, duke paraqitur një ankim kushtetues individual të ri për këtë pikë. Në lidhje me ankimin e ri, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 282, datë 7.11.2025, ka vendosur moskalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare, pasi i ka gjetur pretendimet e kërkueses haptazi të pabazuara.

9. Për sa i takon këtij ankimi kushtetues individual, Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak në datën 30.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

10. Në datën 26.3.2026 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se kishte qenë në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 7.4.2026, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar themelin e pretendimeve të kërkueses, por ka disponuar me një vendim mospranimi me vlerësim sipërfaqësor për ekzistencën ose jo të shkaqeve të parashikuara në ligj, pa bërë analizë reale nëse keqzbatimi i ligjit është i një rëndësie të tillë që ndikon sigurinë juridike dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, nëse trajtimi i çështjes ka ndikuar në të drejtën për karrierë ose



nëse janë shkelur parime procedurale për shkak të mospezullimit të ekzekutimit të një akti me pasoja të pakthyeshme, çka ka bërë që *rekursi i kërkuësës të mos jetë një mjet efektiv*. Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar një analizë për pasojat e pakthyeshme të veprimit të KLGJ-së, pavarësisht pretendimeve të qarta në rekurs se veprimtaria e këtij organi është marrë pa pritur vendimin përfundimtar për vlerësimin e kërkuësës, duke sjellë një dëm real dhe të parikuperueshëm në të drejtën e saj për karrierë.

11.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, duke paraqitur argumentet e mëposhtme:

11.2.1. Lidhur me formimin e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, dy gjyqtarë të trupës, individualisht ose së bashku, kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka rrëzuar padinë e kërkuësës për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional, si dhe të trupit gjykues që ka rrëzuar padinë e saj për shfuqizimin e vendimit të KLGJ-së për renditjen e kandidatëve për pozicionin në fushën e së drejtës administrative. Pretendimet në këto procese janë të njëjta, pasi janë të lidhura me efektin e ekzekutimit të vendimit të KLGJ-së për vlerësimin etik dhe profesional të kërkuësës. Gjyqtarët janë shprehur për këto pretendime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtit fakt dhe të njëjtit shkak ligjor, në çështje që u përkasin të njëjtave palë. Interpretimi i ligjit nga ata gjyqtarë nuk është bërë në një kontekst të përgjithshëm, por ka prodhuar efekte konkrete mbi kërkuësen, duke e vendosur në një pozicion më të ulët renditjeje, një rast klasik i konfliktit të interesit. Njëri prej gjyqtarëve ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, çka do të thotë se ai vetë ka vlerësuar me ndërgjegje ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme që nuk e lejojnë atë të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Refuzimi i kërkesave për dorëheqje është bërë nga gjyqtarja tjetër pjesë e trupës, në atë kohë kryetare në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe vetë palë e interesuar.

11.2.2. Lidhur me formimin e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, kryesuesja ka konkurruar për të tria pozicionet e lira që ka konkurruar edhe kërkuësja (duke u përzgjedhur në pozicionin e së drejtës administrative) dhe ka interes të drejtpërdrejtë në gjykimin e padive të kërkuësës lidhur me këto procedura. Dy gjyqtarët e tjerë kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e saj për pezullimin e efekteve të vendimit nr. 19/2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, si edhe të trupit gjykues që me vendimin nr. 00-2024-5489 (316),

datë 11.7.2024, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të apelit (nr. 19/2023) nëpërmjet të cilit është rrëzuar kërkesëpadia e kërkuësës për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional, pra janë shprehur negativisht për pretendimet e parashtuara nga kërkuësja. Këto gjykime, në thelb, lidhen me të njëjtin fakt, renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, dhe me të njëjtat subjekte. Pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja këto çështje cenon besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme. Gjykata e Lartë që ka rrëzuar kërkesën e kërkuësës për përjashtimin e anëtarëve të Kolegjit Administrativ (vendimi 4896/2024) është mjaftuar me një analizë formale dhe jo substanciale, duke mos hetuar fare rreth kontekstit të konfliktit të interesit të gjyqtarës kryesuese për shkak të kandidimit të saj në të njëjtën procedurë me kërkuësen.

11.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi kërkuësja, në shkelje të hapur dhe flagrante të procedurës ligjore, nuk është njoftuar ose informuar në procesin e renditjes së kandidatëve të kualifikuar për të marrë pjesë në garën për plotësimin e pozicionit të lirë. Gjykata e Lartë duhet të kishte vlerësuar nëse gjatë procesit administrativ kërkuësës i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar për pretendimet e saj përpara nxjerrjes nga KLGJ-ja të vendimit të propozimit të renditjes, megjithatë ajo nuk ka analizuar dhe arsyetuar rreth këtyre shkaqeve të ngritura në rekurs, edhe pse të lidhura me cenimin e parimeve të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor.

11.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe fuqisë ekzekutive të vendimeve gjyqësore*, pasi vendimet e kundërshtuara kanë lejuar vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë nga KLGJ-ja pa përfunduar me vendim përfundimtar vlerësimi etik dhe profesional i kërkuësës. Në këtë rast, KLGJ-ja kishte detyrimin që të pezullonte ekzekutimin e vendimit për vlerësimin etik-profesional derisa vendimi të ishte jo vetëm i ekzekutueshëm, por edhe përfundimtar, duke pasur parasysh pasojën, plotësimin e vendit të lirë në Gjykatën e Lartë.

12. *Subjekti i interesuar, KLGJ-ja*, ka paraqitur prapësime me shkrim si vijon:

12.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuësës në rekurs, duke analizuar konceptin e vendimit të formës së



prerë dhe forcën ekzekutive të tij, legjitimitetin e procedurës së ndjekur nga KLGJ-ja në lidhje me vijimin e veprimtarisë në nxjerrjen e aktit të renditjes së kandidatëve në Gjykatën e Lartë, pretendimet për përbërjen e trupit gjykues dhe pretendimet për vendimin e kundërshtuar të KLGJ-së. Pretendimi se nuk janë analizuar pasojat që vendimmarrja e KLGJ-së ka sjellë për kërkuesen nuk qëndron, Gjykata e Lartë ka përmendur faktin se ka përfunduar gjykimi për vlerësimin etik dhe profesional të kërkueses, duke e lënë të pacenueshme renditjen e kandidatëve të bërë nga KLGJ-ja, ndaj rrethanat aktuale në të cilat është marrë vendimi i Gjykatës së Lartë nuk do të sillnin pasoja të ndryshme të kërkuesja.

12.2. *Pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim* nuk qëndrojnë dhe mbeten në nivel hipotetik. Nga ana e kërkueses nuk është paraqitur asnjë provë ose fakt bindës që të mund të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve. Gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjeve me objekt “kundërshtimin e vlerësimit etik-profesional” dhe “kundërshtimin e renditjes së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë”, të cilat kanë objekt dhe shkak ligjor të ndryshëm dhe thjesht fakti se janë të njëjtat palë në proces nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshësisë së tyre. Fakti i thjeshtë se gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshësisë së tij, ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Për më tepër, mbajtja e qëndrimeve të njëjta për çështje të ngjashme nga trupat gjykues jo vetëm që nuk përbën shkak për paanshmëri, por garanton dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike, duke krijuar një praktikë të qëndrueshme gjyqësore. Shqyrtimi i kërkesave për dorëheqje nga gjyqtarja, në cilësinë e zëvendëskryetares të atëhershme në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk përbën konflikt interesi, pasi: i. gjykimet kanë objekt dhe shkak ligjor të ndryshëm; ii. interesi i pretenduar nga kërkuesja nuk ishte më aktual; iii. kryetari është i vetmi autoritet i ngarkuar nga ligji për të shqyrtuar kërkesat për dorëheqje. Anëtarët e Gjykatës së Lartë kanë marrë në shqyrtim çështje me objekte të ndryshme.

12.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar* nuk është ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk duhet pranuar. Procedura e ngritjes në detyrë ka qenë transparente dhe kërkueses i janë njoftuar të

gjitha aktet dhe fazat e kësaj procedure (fillimi i procedurës dhe caktimi i relatorit, diapozitivi i vendimit të KLGJ-së, njoftimi për vendimin e arsyetuar (paraprak)), për të cilat ajo ka marrë dijeni. Që nga momenti i njoftimit të fillimit të procedurës, kërkuesja ka pasur mundësinë për të paraqitur një kërkesë ose shpjegime lidhur me këtë proces, të drejtë të cilën ajo nuk e ka ushtruar. Vetë KLGJ-ja nuk e ka vlerësuar të nevojshme në asnjë fazë të procedurës të paraqesë shpjegime në lidhje me kriteret e renditjes ose të kërkojë depozitimin e dokumenteve shtesë. Gjithashtu, asnjë akt ligjor ose nënligjor nuk përmban parashikime mbi bazë të të cilave KLGJ-ja të jetë e detyruar të njoftojë kandidatët për ecurinë e kandidatëve të tjerë në procesin e ngritjes në detyrë. E drejta për t'u dëgjuar publikisht nuk është konsideruar nga Gjykata si një e drejtë absolute. Në çdo rast, Gjykata ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, por ndikim në proces kanë ato shkelje, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit.

12.4. *Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe fuqisë ekzekutive të vendimeve gjyqësore* është i pabazuar, për shkak se vendimi i gjykatës së apelit ishte i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm, ndaj KLGJ-ja ka vijuar me procedurat e ngritjes në detyrë, duke pasur parasysh interesin publik për të bërë të mundur funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, nevojë që ishte imediate. KLGJ-ja nuk ka qenë në kushtet e pezullimit të parashikuara nga neni 66 i KPA-së, i cili i referohet pezullimit të procedurës derisa të merret një vendim i formës së prerë për çështjen paraprake. Lidhur me pretendimin se KLGJ-ja ka mbajtur qëndrime të ndryshme në raste të ngjashme, në asnjë rast KLGJ-ja nuk e ka pezulluar procedurën e saj, por në një rast i ka kërkuar Gjykatës së Lartë që ta trajtojë çështjen me prioritet. Kërkueses i janë respektuar të gjitha të drejtat për sa u përket procedurave të ngritjes në detyrë, i janë komunikuar të gjitha aktet procedurale dhe është bërë renditja e kandidatëve në bazë të trajtimit të barabartë dhe objektiv. E gjithë procedura është konfirmuar më tej nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

12.5. *Pretendimin për cenimin e së drejtës për karrierë*, kërkuesja e lidh me faktin se KLGJ-ja duhet të kishte pritur shqyrtimin e rekursit para se të vijonte me ngritjen në detyrë të kandidatës tjetër. Për këtë



pretendim, ajo nuk ka arritur të argumentojë sesi zbatimi i parashikimeve ligjore për të kandiduar si anëtare e Gjykatës së Lartë përbën cenim të këtij parimi. Vendimmarrja e KLGJ-së e konfirmuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë provon ligjshmërinë e të gjithë procesit në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë nga KLGJ-ja.

13. **Subjektet e interesuara, Presidenti i Republikës dhe Vojsava Kola**, ndonëse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se kërkuarja i ka shtrirë pretendimet e saj në lidhje me dy kërkitime kryesore: i. për vlerësimin etik dhe profesional të saj për vitin 2021 të kryer nga KLGJ-ja, të materializuar me vendimin nr. 537, datë 14.12.2022; ii. për procesin gjyqësor administrativ të përfunduar me vendimin e datës 12.12.2024, të Gjykatës së Lartë, në të cilin kërkuarja ka kundërshtuar miratimin nga KLGJ-ja të renditjes së gjyqtarëve që kandidonin për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile.

16. Në lidhje me kërkimin e parë, sikurse është theksuar në rrethanat e çështjes, kërkuarja, pasi ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, në datën

13.6.2025 ka paraqitur kërkesë me objekt “Për heqje dorë pjesërisht nga objekti i kërkesës”, në të cilën ka parashtruar se heq dorë nga pika 3 e objektit të kërkesës së saj: “*Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit të KLGJ-së nr. 537, datë 14.12.2022, “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”, me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shumë mirë” dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në KLGJ për rimarrjen në shqyrtim të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës Altina Nasufi për vitin 2021”*”, për shkak se do të paraqiste kërkesë të veçantë për të.

17. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit. Neni 31/b i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon të drejtën e kërkuarës për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimin të çështjes. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuarës në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

18. Në rastin konkret, Gjykata eidenton se kërkuarja pas heqjes dorë nga kërkitimi i parë ka paraqitur një ankim të ri kushtetues, për të cilin ka marrë përgjigje me vendimin nr. 282, datë 7.11.2025 të Kolegjit të Gjykatës. Në këto kushte, bazuar në nenin 31/a, pika “dh”, të Ligjit Organik të Gjykatës, Gjykata vlerëson se përveçse kërkuarja ka hequr dorë nga ky kërkitim, ai është objekt i një vendimi të mëparshëm të Kolegjit të Gjykatës, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa i takon kërkitimit të dytë, në drejtim të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se kërkuarja ka kundërshtuar procesin gjyqësor administrativ në përfundim të të cilit është vendosur mospranimi i rekursit të saj, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit që ka rrëzuar padinë e kërkuarës, për rrjedhojë, në aspektin procedural të këtij kriteri legjitimitimi, kërkuarja rezulton të ketë qenë palë në procesin



gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se çdo individ, person fizik ose juridik, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkesja duhet të provojë se është bartëse edhe e së drejtës kushtetuese që pretendohet se i është cenuar nga procesi gjyqësor objekt kërkesë.

21. Sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin 14 të vendimit*), kërkitimi i dytë i kërkuësës ka të bëjë me kundërshtimin gjyqësor të vendimit të KLGJ-së që ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e së drejtës civile (*shpallja nr. 536/2021*) dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion subjektin e interesuar, Vojsava Kola. Duke pasur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, Gjykata do të ndalet në verifikimin e së drejtës kushtetuese që vihet në diskutim dhe, më tej, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur kërkuësës në atë të drejtë, në kuptim të justifikimit prej saj të statusit të viktimës. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësës janë fokusuar në aspektet procedurale të procesit të kundërshtuar, duke e lidhur në mënyrë të përciptë atë me të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojtë përmes ushtrimit të së drejtës kushtetuese me natyrë procedurale, me të drejtën për punë dhe karrierë.

22. Sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë plotësohen nëpërmjet ngritjes në detyrë (neni 48, pika 1). KLGJ-ja i shqyrton kandidimet dhe i rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas: i. dy vlerësimeve të mëparshme; ii. në rast se ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, KLGJ-ja i rendit këta kandidatë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; iii. në rast se sërish ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, KLGJ-ja i rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist (neni 48, pika 9). Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, KLGJ-ja propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar

përmbushjen e këtyre kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve (neni 48, pika 11). Propozimi për emërim është i ankimueshëm (neni 48, pika 11). Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e KLGJ-së në gjykatën kompetente vetëm për shkelje të rënda procedurale (neni 95, pika 7).

23. Në dritën e dispozitave të ligjit të zbatueshëm si më sipër, Gjykata vëren se procesi i renditjes së kandidatëve dhe i propozimit për emërim është i ndërlidhur dhe vjen si pasojë e përmbushjes së një sërë kriteresh, ku kriteri i parë është jo një, por dy vlerësime të mëparshme të magjistratit. Në këtë drejtim, Gjykata ka vendosur të mos marrë në shqyrtim kërkimin e parë të kërkuësës, për vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2021 nga KLGJ-ja, për shkak të heqjes dorë prej tij, si dhe të vendimmarrjes së mëparshme të Kolegjit të saj. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkesja nuk e ka argumentuar cenimin e së drejtës substanciale për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar, sepse, në vetvete, efektet ligjore të vendimeve të kundërshtuara nga kërkesja nuk kanë sjellë dhe as mund të sjellin pasojat të drejtpërdrejta në të drejtën për punë dhe karrierë, për sa kohë që procesi i renditjes së kandidatëve dhe propozimi për emërim janë të ndërlidhur dhe ndërvarur nga procesi i vlerësimit të kandidatëve, kërkim nga i cili kërkesja ka hequr dorë dhe, që në çdo rast është gjetur i pabazuar nga Kolegji i Gjykatës, ndaj procesi i kundërshtuar duket se nuk ka cenuar ndonjë të drejtë themelore të kërkuësës. Për pasojë, Gjykata vlerëson se neni 42 i Kushtetutës nuk merr në mbrojtje procesin gjyqësor për të cilin kërkesja ka ngritur pretendimet, pra “renditjen”, e cila në vetvete nuk lidhet me të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojtë kërkuësja.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se, mbështetur në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar, për rrjedhojë ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.4.2026.

Shpallur më 10.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 68, datë 4.6.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 28.4.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 17 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Diana Kademi, Sutë Kademi, përfaqësuar nga avokati Hysni Beti, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2512 (80-2017-2536), datë 6.6.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.7.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-968, datë 3.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 23, pikat 1 e 2, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja

“I”, dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuueseve Diana Kademi dhe Sutë Kademi (*kërkueset*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tiranë-Veri (*ASHK*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 2.2.2017 dy kërkuueset kanë ngritur padi në gjykatë, me objekt detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive (*ZVRPP*) për t’i dhënë kopje të dokumentacionit të dy pasurive të paluajtshme (truall dhe banesë), si dhe pajisjen e tyre me kartelat e pronësisë dhe të hartave treguese të tyre. Ato kanë pretenduar se janë pronare të dy pasurive, të cilat i kanë fituar me trashëgimi ligjore nga gjyshërit dhe se, në kundërshtim me ligjin, nuk pajiseshin me aktet e pronësisë. Gjithashtu, ato kanë pretenduar se prej vitit 2008 i janë drejtuar vazhdimisht *ZVRPP*-së, për regjistrimin e dy pasurive në emër të tyre, por kanë marrë përgjigjen se ato figuronin të regjistruara në emër të personave të tjerë.

2. Konkretisht, në vitin 2010 kërkuësja Diana Kademi ka aplikuar për regjistrimin fillestar të pasurive, duke paraqitur edhe planin e rlevimit, por *ZVRPP*-ja i është përgjigjur se sipërfaqja ishte regjistruar në emër të shtetit dhe disa shtetasve të tjerë, ndaj ajo duhej të paraqiste skicë të vjetër të pozicionimit të pronës, ose t’u drejtohej organeve kompetente për saktësimin e saj. Në vijim, kjo kërkuuese ka kërkuar nga *ZVRPP*-ja vënien në



dispozicion të dokumentacionit të mënyrës sesi pasuritë ishin regjistruar në emër të shtetasve të tjerë. ZVRPP-ja e ka sqaruar se nuk dispononte të dhëna për një pjesë të pasurive të kërkuara, ndërsa për të tjerat i ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, sipas regjistrimeve ekzistuese.

3. Në vitin 2016 kërkesja Diana Kademi i ka kërkuar ZVRPP-së ta pajiste me certifikatat e pronësisë për dy pasuritë e trashëguara, por kërkesa nuk është pranuar, me argumentin se ajo nuk kishte paraqitur dokumentet tekniko-ligjore të pronësisë dhe se gjendja e pronave kishte ndryshuar, tashmë aty ishte ndërtuar një pallat, i cili, së bashku me truallin, ishte regjistruar në pronësi të një shoqërie ndërtimi. Gjithashtu, ZVRPP-ja i është përgjigjur se pasuritë në fjalë nuk i ishin nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, ndaj nuk kishte dokument hartografik për pozicionimin e tyre në hartën treguese digjitale të pasurisë.

4. Po në vitin 2016 kërkesja Diana Kademi ka kërkuar nga ZVRPP-ja informacion për procedurat e aktet për kalimin e pasurive subjekteve të tjera, si dhe pajisjen me kopje të hartës treguese e kartelës së pasurive. Kësaj kërkesë ZVRPP-ja i është përgjigjur duke dërguar aktet e fitimit të pronësisë dhe të dhënat e regjistrimit hipotekar të viteve 1939 dhe 1942. Me pretendimin se përgjigjja ishte e paplotë, pasi nuk shpjegonte se përse nuk ishte pajisur me kartelat e pasurisë dhe me hartat treguese të tyre, kërkeset kanë paraqitur ankesa pranë Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa në vitin 2017 i janë drejtuar gjykatës (*shih paragrafin 1 të këtij vendimi*).

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2512 (80-2017-2536), datë 6.6.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se: i. ZVRPP-ja kishte paraqitur në gjykim aktet dhe dokumentet që pasqyronin ndryshimet në sipërfaqen dhe të drejtat e pronësisë për të dyja pasuritë, ndaj kërkimi për vënien në dispozicion të akteve të regjistrimit të pasurive në emër të personave të tjerë ishte realizuar; ii. pretendimet e kërkuarëve për titujt e pronësisë të personave të tretë ishin rrëzuar në një proces tjetër gjyqësor, me vendim të formës së prerë, ndaj kërkimi që ZVRPP-ja t'i pajiste me kartelën dhe hartën treguese të pasurisë ishte i pabazuar. Ndonëse kërkeset kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.7.2024, me të njëjtin arsyetim.

6. Kërkeset kanë paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 21.8.2024. Në rekurs ato kanë pretenduar, ndër të tjera, se vendimet e gjykatave të faktit binin ndesh me provat e administruara gjatë gjykimit, legjislacionin në fuqi, qëndrimet njëseuese të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë e jurisprudencën kushtetuese, ligjin për të drejtën e informimit dhe të drejtën e pronës. Po sipas tyre, vendimet ishin kontradiktore dhe alogjike, ndërkohë që gjykata e apelit nuk u kishte dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura prej tyre në parashtrimet e datës 13.6.2024, në cenim të së drejtës së aksesit. Pas kryerjes së veprimeve administrative, dosja së bashku me rekursin janë përcjellë në Gjykatën e Lartë dhe çështja është regjistruar për shqyrtim në datën 7.11.2024.

7. Në datën 24.2.2025 kërkeset kanë depozituar në Gjykatën e Lartë shtesë rekursi, në të cilën kanë parashtruar, ndër të tjera, se arsyetimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njëseues nr. 00-2018-216, datë 13.2.2018, (*vendimi nr. 216/2018*) të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-968, datë 3.3.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarëve, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*).

9. Në datën 3.7.2025 kërkeset, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 18.7.2025.

10. Në datën 22.10.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 24.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, kurse në datën 21.4.2026 ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari kushtetues.

11. Me ligjin nr. 111/2018, datë 7.2.2019, “Për Kadastrën”, kompetencat e ZRPP-së i kanë kaluar ASHK-së. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës në të cilën janë kryer veprimet.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkueset, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi i gjykatës së apelit bie ndesh me vendimin njësores nr. 216/2018, sipas të cilit ZVRPP-të kryejnë veprime në regjistrat e pasurive vetëm për subjektet që rezultojnë në regjistrë dhe mbi bazën e një akti administrativ, ose vendimi gjyqësor të formës së prerë.

12.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimit për mënyrën e fitimit dhe të regjistrimit të pronave në emër të personave të tretë. Ato kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme për të dyja pasuritë, ndërkohë që duhej të arsyetonin më vete për secilën prej tyre. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se pretendimet për pronën e trashëguar ishin rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë është i pabazuar, pasi procesi i mëparshëm kishte si objekt zgjidhjen e pasojave të regjistrimit të kontratës së dhurimit dhe jo pavlefshmërinë e saj. Gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për parashtrimet e depozituara në datën 13.6.2024. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimet e parashtruara në shtesën e rekursit dhe për vendimin nr. 1698, datë 12.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (të depozituar me shtesën e rekursit), që tregonte se ishte vendosur pushimi i gjykimit për njohjen e pronësisë së shtetasve të tjerë mbi truallin.

12.2. *E drejta e informimit*, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë anashkaluar faktin se në procesin administrativ barra e provës i takon organit administrativ. Në gjykim ato nuk kanë pretenduar mosdhënien e informacionit nga ZVRPP-ja, por informacioni i dhënë ka qenë i paplotë, pasi nuk informonte për mënyrën ose subjektet të cilave u kishin kaluar pasuritë dhe veprimet përkatëse. Edhe në prapësimet e paraqitura në gjykimin kushtetues, ASHK-ja nuk ka vënë në dispozicion praktikën e bashkimit të të dyja pasurive të trashëgimlënësve të tyre, kopje të fletëve të regjistrat hipotekar ku janë pasqyruar transkripti i pasurive, data e regjistrimit të tyre, kartelat dhe hartat treguese; aktin e fitimit të pronësisë së truallit nga

shtetasit e tjerë; vërtetimin e pronësisë, mbi bazën e të cilit është lidhur kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese; vërtetimin e pronësisë së kësaj shoqërie për regjistrimin e pasurive objekt gjykimi në emër të saj. Dokumentet e depozituara nga ASHK-ja nuk kanë lidhje me çështjen dhe nuk identifikojnë pasuritë për të cilat është kërkuar informacioni.

12.3. *E drejta e pronës*, pasi edhe pse që prej vitit 2008 i janë drejtuar ZVRPP-së për t'i pajisur me vërtetim pronësie për pronat e gjyshërve dhe për kalimin e tyre të trashëgimtarët, ZVRPP-ja ua ka mohuar këtë të drejtë. Qëndrimet e këtij organi për pasuritë në fjalë e dokumentacionin, mbi bazën e të cilit prona u ka kaluar personave të tjerë, kanë qenë të ndryshme. Regjistrimi i pasurive në emër të palëve të treta është kryer në mungesë të dokumentacionit të plotë ligjor e në kundërshtim me rregullat procedurale të ZVRPP-së. Gjykatat nuk kanë përcaktuar vendimet gjyqësore të formës së prerë për kalimin e pasurive në emër të shtetasve të tjerë e aktet përkatëse të ZVRPP-së për regjistrimin e pasurive në emër të tyre, pronarin e truallit dhe bazën ligjore të regjistrimit dhe datën e kalimit të pronësisë të shoqëria ndërtuese. Kartela e pasurisë e paraqitur në gjykim nuk plotëson kushtet ligjore për të shërbyer si provë për vërtetimin e pronësisë dhe vendimi gjyqësor për njohjen e faktit të pronësisë i vitit 1995 bie ndesh me nenin 41, pika 2, të Kushtetutës dhe me nenin 193, shkronja "dh", të Kodit Civil. Gjykatat kanë interpretuar vendimet gjyqësore për kontratën e dhurimit si akte të fitimit të pronësisë, ndërkohë që gjyshërit e tyre nuk kanë qenë palë në këto procese dhe nuk kanë shprehur vullnetin për tjetërsimin e pasurive të tyre.

13. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar se:

13.1. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë haptazi të pabazuara, pasi vendimet e kundërshtuara janë të arsyetuara.

13.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së informimit* nuk qëndrojnë, pasi kërkueset kanë qenë në dijeni të plotë të faktit se në emër të kujt ka kaluar pasuria. Në kundërshtim nga sa pretendohet, ASHK-ja ka depozituar dokumentacionet dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe kërkueset kanë qenë në dijeni e janë pajisur me dokumentet objekt gjykimi.



13.3. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës*, për shkak të pavlefshmërisë së titullit të pronësisë, kanë rezultuar të pabazuara me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimet gjyqësore, veprimi juridik për kalimin e pronës në emër të shtetasve të tjerë, kartela e pasurisë e mëparshme dhe ajo e rifreskuar janë paraqitur si prova në gjykim. Këto akte provojnë se pasuria është regjistruar në emër të shoqërisë ndërtuese, e cila, me dhënien e lejes së ndërtimit, ka ndërtuar mbi të një objekt shumëkatësh. Aktualisht pasuria rezulton në emër të personave të tretë, të cilët e kanë fituar mbi bazën e titujve të ligjshëm të pronësisë.

14. Subjekt i interesuar, Avokatura e Shtetit, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata vëren se, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, kërkuaset legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar. Po kështu, ato plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, për rrjedhojë nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Kërkuaset në ankimin kushtetues individual kanë ngritur pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* (në aspektet e *parimit të sigurisë juridike* dhe të *standardit të arsytimit të vendimit*), *së drejtës së informimit* dhe *së drejtës së pronës*. Për këto pretendime ato legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 3.3.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 3.7.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Gjykata konstaton se pas kalimit të çështjes në seancë plenare (24.10.2025), kërkuaset kanë depozituar parashtrimet e datës 9.4.2026, në të cilat kanë ngritur edhe pretendimin për cenimin e së drejtës së *aksesit efektiv*, me argumentin se gjykatat e zakonshme kanë përdorur vendimin civil për titullin e pronësisë si pengesë për dhënien e informacionit, duke u hequr mundësinë atyre për të provuar tjetërsimin arbitrar të pasurive të trashëguara. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se, në mbështetje të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (të shtohen ose të pakësohen), deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimet nr. 28, datë 11.4.2024; nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit efektiv nuk mund të merret në shqyrtim, pasi është paraqitur pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuaset kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *së drejtës së informimit*, të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, duke parashtruar se ZVRPP-ja nuk i ka dhënë informacion të plotë, por informacion kontradiktor lidhur me pasuritë e tyre, ndërsa gjykatat e zakonshme nuk e kanë riparuar këtë cenim, por janë shprehur se gjatë gjykimit kërkuaset janë njohur me të gjitha aktet, ndërsa kanë anashkaluar faktin se në gjykimin administrativ barra e provës i takonte organit administrativ, pra ZVRPP-së. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, ka prapësuar se nuk qëndron ky pretendim, pasi kërkuaset kanë qenë në dijeni të plotë të faktit se në emër të kujt ka kaluar pasuria. Në kundërshtim nga sa pretendohet, ASHK-ja ka depozituar dokumentacionet dhe kartelat e pasurisë së



paluajtshme dhe kërkueset kanë qenë në dijeni e janë pajisur me dokumentet objekt gjykimi.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e informimit, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, përfshin të drejtën e individit, që në përputhje me ligjin, të aksesojë fakte dhe të dhëna që lidhen me ushtrimin e pushtetit publik, në mënyrë që individ i informuar të ketë mundësinë të marrë pjesë në jetën publike. Në thelb, njohja e individit me informacion e ndihmon atë të formojë pikëpamje për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, ndërsa autoritetet publike i nxit në drejtim të integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë (*shih vendimin nr. 7, datë 20.2.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Gjykata çmon se argumentet e kërkueseve nuk mbrohen nga neni 23 i Kushtetutës, por kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, konkretisht me arsyetimin e gjykatave të zakonshme, të cilat kanë pohuar se kërkueset janë njohur me të gjitha aktet e regjistrimit të të dyja pronave të tyre.

21. Lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkueset kanë parashtruar gjithashtu, në thelb, se gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe regjistrimit të pasurive në emër të personave të tretë, nuk kanë vlerësuar siç duhet provat dhe aktet mbi të cilat pasuritë u kanë kaluar këtyre personave, kanë njohur të drejtën e tyre të pronës përmes gjykimeve në të cilat trashëgimlënësit e tyre nuk kanë qenë të pranishëm. Për të njëjtat shkaqe, sipas tyre, gjykatat e zakonshme u kanë cenuar edhe *të drejtën e pronës*. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, i ka prapësuar si të pabazuara këto pretendime, me argumentin se, në kundërshtim nga sa kërkueset pretendojnë, ato kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e zakonshme për pretendimet e tyre për të drejtën e pronës dhe konkretisht se këto pretendime kishin rezultuar të pabazuara me vendim gjyqësor të formës së prerë.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka

theksuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkueset kanë vënë në lëvizje gjykatat administrative, duke ngritur pretendime për veprimtarinë administrative të ZVRPP-së. Në përgjigje të pretendimeve të tyre, gjykatat e zakonshme kanë konstatuar se aktet e regjistrimit të pasurive janë paraqitur në gjykim nga ZVRPP-ja, duke realizuar në këtë mënyrë njohjen e kërkueseve me to. Po kështu, gjykatat administrative kanë vlerësuar se kërkimi për t'u pajisur me certifikatë pronësie dhe hartat treguese, në thelb, kishte të bënte me njohjen e së drejtës së pronësisë, por titulli i pronësisë për të dyja pasuritë kishte qenë objekt i një procesi gjyqësor civil të përfunduar me vendim të formës së prerë. Në vlerësimin e Gjykatës, qëndrimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton me gabime të dukshme në drejtim të përcaktimit të fakteve ose të ligjit të zbatueshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës janë haptazi të pabazuara.

24. Kërkueset kanë pretenduar gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar *standardin e arsyetimit*, duke parashtruar se pretendimet e tyre të paraqitura në shtesën e rekursit nuk kanë marrë përgjigje. Konkretisht, bëhej fjalë për pretendimin se vendimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njëses nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, shkak për të cilin, sipas kërkueseve, atyre u është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike*. Duke mbajtur në konsideratë natyrën kushtetuese të këtyre pretendimeve, Gjykata çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

*B. Për themelin e pretendimeve**B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

25. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimet e parashtruara prej tyre në shtesën e rekursit, në të cilat kanë parashtruar, ndër të tjera, edhe se vendimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njësuës nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ të saj.

26. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, por pa dhënë ndonjë argument konkret.

27. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 10.4.2025; 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 10.3.2026; nr. 44, datë 4.6.2024; nr. 10, datë 7.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se arsyetimi ka për funksion t'u tregojë palëve se janë dëgjuar nga gjykata, ka pohuar se Gjykata e Lartë duhet të ketë kujdes të shtuar në administrimin e të gjitha akteve të depozituara nga palët, përfshirë edhe shtesën e rekursit (*shih vendimin nr. 5, datë 29.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur shqyrtimi i rekursit bëhet nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve, paraqitja e shtesës së rekursit duhet evidentuar në vendimin e saj, edhe nëse në përfundim konkludon se ky akt është paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (*shih vendimin nr. 30, datë 18.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Mungesa e arsyetimit në vendim për shkaqet me natyrë kushtetuese të ngritura në shtesën e rekursit vë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij (*shih vendimet nr. 77, datë*

5.11.2024; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese), duke sjellë, si pasojë, edhe cenimin e së drejtës së aksesit (*shih vendimin nr. 50, datë 25.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në rastet kur në shtesën e rekursit nuk parashtrohen shkaqe të reja në raport me rekursin, mospasqyrimi i tyre në vendim nuk përbën shkelje kushtetuese, për sa kohë që kjo mangësi nuk ka ndikuar në thelbin e vendimarrjes së Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 88, datë 28.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata, në vijim, do të verifikojë nëse shtesa e rekursit e paraqitur nga kërkueset përmbante shkaqe të reja dhe nëse mungesa e evidentimit të saj në vendimin e Gjykatës së Lartë ka vënë në dyshim thelbin e vendimarrjes së kësaj gjykate dhe funksionin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

30. Në parantezë, Gjykata vëren se neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo individi për të ankimuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe për çështje me rëndësi ose vlerë të vogël. Në funksion të kësaj të drejte, si dhe të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 23, datë 4.3.2026; nr. 27, datë 18.5.2023; nr. 9, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*), legjislacioni procedural ka parashikuar afate dhe kërkesa formale për ushtrimin e mjeteve të ankimit, mosrespektimi i të cilave sjell pasojën e mospranimit të tyre.

31. Kështu, në gjykimin administrativ, rekursi depozitohet në gjykatën e apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit që kundërshtohet (nenet 443 dhe 446 të KPC-së, si dhe neni 60 i Ligjit për Gjykatat Administrative). Ndonëse ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën për paraqitjen e shtesave të rekursit, ai rregullon procedurën për ndreqjen e të metave të tij (neni 57 i Ligjit për Gjykatat Administrative) dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të njoftuar datën e shqyrtimit të rekursit të paktën 15 ditë përpara (neni 61 i po këtij ligji). Këto dispozita synojnë garantimin e zhvillimit të rregullt dhe efektiv të procesit gjyqësor, duke siguruar, nga njëra anë, që palët të kenë dijeni për aktet dhe pretendimet e paraqitura, me qëllim ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, dhe, nga ana tjetër, që gjykata të disponojë kushtet e nevojshme për të shqyrtuar dhe për të vendosur në mënyrë të informuar për mosmarrëveshjen. Për rrjedhojë, Gjykata thekson se e drejta kushtetuese



për proces të rregullt ligjor nuk vendos detyrime vetëm mbi organet gjyqësore, por kërkon edhe nga individit të tregojë kujdesin e duhur në përmbushjen e detyrimeve procedurale që ligji i ngarkon.

32. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se në datën 21.8.2024 kërkuaset kanë depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit rekursin e tyre ndaj vendimeve të gjykatave të faktit, që kishin rrëzuar padinë e tyre. Ato kanë pretenduar se vendimet ishin marrë në kundërshtim me faktet, provat e legjislacionin në fuqi, si dhe me praktikën njësuere të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë e jurisprudencën kushtetuese, por pa specifikuar vendime konkrete. Pas pothuajse 6 muajve, konkretisht më 24.2.2025, kërkuaset kanë depozituar në Gjykatën e Lartë shtesë rekursi, në të cilën janë shprehur se po detajonin shkaqet e rekursit. Në shtesën e rekursit ato kanë parashtruar se vendimet gjyqësore nuk kishin respektuar vendimin nr. 216/2018, i cili, sipas tyre, përbënte qëndrim njësuere të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

33. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe ka administruar aktet e çështjes, përfshirë rekursin dhe shtesën e tij. Në përfundim, ajo ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk përmbushnin kërkesat e nenit 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative.

34. Në analizë të vendimarrjes së Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në arsyetimin e saj nuk evidentohet paraqitja e shtesës së rekursit dhe vlerësimi i saj, e cila *prima facie* përbën shkelje procedurale. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, nga pikëpamja kushtetuese, përveçse kur shkelja është thelbësore (*shih vendimet nr. 8, datë 10.4.2025; nr. 30 datë 18.4.2024; nr. 9, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata do të analizojë nëse mosparaqitja e shtesës së rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë ka ndikuar ose jo në thelbin e së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar, pra nëse vendimi i Gjykatës së Lartë e ka përmbushur ose jo funksionin e tij për t'u treguar kërkuaseve se janë dëgjuar për pretendimet e tyre.

35. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se argumentet e parashtruara në shtesën e rekursit janë, në thelb, përsëritje e pretendimeve të ngritura më parë gjatë gjyqimit në gjykatat e zakonshme dhe në

rekurs. Edhe vetë kërkuaset pohojnë në shtesën e rekursit se po detajonin shkaqet e rekursit. Lidhur me shkakun e mosrespektimit nga gjykata e apelit të vendimit nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ, ai jo vetëm që përbën konkretizim të shkakut të paraqitur në rekurs, me përmbajtje “vendimet e kundërshtuara janë marrë në kundërshtim me praktikën njësuere të Gjykatës së Lartë”, por nuk përbën formalisht as vendim njësuere. Vendimi nr. 216/2018 është marrë nga një trup gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë, bazuar në parashikimet e nenit 12, pika 3, të Ligjit për Gjykatat Administrative dhe nuk ka vendosur njësimin e praktikës gjyqësore, shkak për të cilin Gjykata e Lartë nuk ka urdhëruar të botohej në Fletoren Zyrtare. Në kushtet kur ky vendim nuk është njësuere, Gjykata çmon se nuk qëndron pretendimi i kërkuaseve për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*.

36. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se në pjesën arsyetuese të Gjykatës së Lartë, është paraqitur teksti i plotë i nenit 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative, shkronja “b” e të cilit parashikon si shkak rekursi mosrespektimin e vendimeve njësuere. Mbi këtë bazë ligjore, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ishte detyrë e kërkuaseve t'i parashtronin shkaqet qartësisht dhe t'i argumentonin pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural ose rëndësinë themelore të shkeljes në kuadër të njësimin ose zhvillimit të praktikës gjyqësore. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë duket se e ka vlerësuar çështjen edhe në raport me respektimin nga gjykatat e faktit të vendimeve njësuere, ndaj kërkuaset kanë marrë përgjigje për të.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se mospasqyrimi në vendimin e Gjykatës së Lartë i pretendimeve të parashtruara në shtesën e rekursit nuk ka ndikuar në thelbin e vendimarrjes së saj. Në këtë mënyrë, ajo nuk përbën shkelje thelbësore, ndaj pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa, sipas arsyetimit të mësipërm, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.6.2026.

Shpallur më 11.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 2, datë 11.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	kryetar;
Natasha Mulaj	anëtare;
Albana Shtylla	anëtare;
Ina Rama	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare;

– mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 4, datë 3.11.2023, që u përket:

ANKUES: Sali Hasa, ish-magjistrat, prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, përfaqësuar me prokuror të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.4.2023, nga Prof. Dr. Ermir Dobjani dhe avokat Erajd Dobjani, me Licencë nr. {***}.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI: 1. Shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj prokurorit Sali Hasa, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Dërgimin e çështjes në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili duhet të rishqyrtojë kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, mbasi të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

3. Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që në kuadër të zbatimit të procesit të rregullt ligjor në procedurat administrative, mbi bazë të pretendimeve të prokurorit Sali Hasa, të fillojë hetimin disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që janë marrë me procedimin dhe gjykimin e akuzave ndaj tij dhe t'i përfshijë gjetjet e hetimit në raportin e hetimit disiplinor, që do t'i ridërgojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbas përfundimit të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 148/d, pika 3 dhe neni 134, pika 1/i e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 50, pika 4, e ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 129, 182, 189, 192, 194, e 214, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, pas shqyrtimit të ankimit dhe prapësimeve të paraqitura nga ish magjistrati Sali Hasa, prapësimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankues Sali Hasa (në vijim “ankuesi” dhe/ose “magjistrati”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

2. Me vendimin nr. {***}, datë 17.6.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg” për z. Sali Hasa, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Ndërsa me



vendimin nr. {***}, datë 21.6.2021, kjo gjykatë ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr. {***}, datë 17.6.2021. Këto vendime janë miratuar më pas nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 14.7.2021.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (në vijim “KLP”), për shkak të masës së sigurimit personal dhënë nga gjykata, ka marrë vendimin nr. {***}, datë 22.6.2021, “Për pezullimin nga detyra të z. Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

4. Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 31.5.2022, ka vendosur: “1. deklarinin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim; 2. deklarinin e pafajshëm të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarinin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, pasi nuk përbën vepër penale; 3. në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Sali Hasa i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke e dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim; 4. në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke vënë në provë të pandehurin Sali Hasa, për një periudhë prove prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi; [...]”.

5. Në bazë të ankimit të ushtruar mbi këtë vendim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 23.3.2023, ka vendosur: “[...] 2. ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 31.5.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lidhur me të pandehurin Sali Hasa, si më poshtë: - deklarinin fajtor të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet

burgim; - deklarinin fajtor të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarinin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim; - në aplikim të nenit 55/2 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit Sali Hasa me një vendim të vetëm 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. – Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të pandehurit Sali Hasa me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim; - Vuajtja e dënimit të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme. [...]”.

6. Më datë 23.3.2023, lëshohet urdhri i ekzekutimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 31.5.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë”.

7. Bazuar në vendimet e Prokurorisë së Posaçme, gjykatave të posaçme të shkallës së parë dhe apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”) me vendimin nr. {***}, datë 6.4.2023, ka vendosur: “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

8. Me vendimin nr. {***}, datë 15.5.2023, “Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, ILD-ja ka vendosur: “[...] ii. Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; iii. propozimin e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 148/d pika 2, shkronja “b”, të



*Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkelljen disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi [...]”. Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.5.2023, ILD-ja ia përcjell kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor KLP-së.*

9. KLP-ja, me vendimin nr. 284, datë 17.7.2023, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, ka vendosur: “1. *Pranimin e kërkesës nr. {***} prot., datë 15.5.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurorit Sali Hasa, për shkellje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; 2. Dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për magjistratin Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; 3. Pezullimin e përfuturimit të pagës në masën 50%, si dhe përfuturimet e tjera të magjistratit derisa vendimi të marrë formë të prerë. [...] 6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar. [...]”.*

10. Vendimin e mësipërm të KLP-së, e ka kundërshtuar ankuesi, me objekt kërkesat e përcaktuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, që në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në: i. shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të KLP-së, si i papajtueshëm me Kushtetutën; ii. dërgimin e çështjes në KLP, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë; si dhe iii. dëryrimin e ILD-s, të fillojë hetimin disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë proceduar dhe gjykuar akuzat ndaj ankuesit dhe përfshirjen e rezultateve të këtij hetimi, në raportin e hetimit disiplinor që do t'i ridërgojë KLP-së për ankuesin Sali Hasa.

11. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 4/1 (JD), datë 1.2.2024, vendosi të kalojë për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të

dokumenteve ankimin e magjistratit Sali Hasa dhe ftoi subjektet e interesuara që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim.

I. SHKAQET E ANKIMIT TË PARAQITURA NGA ANKUESI DHE PRETENDIMET E PARASHTRUARA NË KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT

I/1. Shkaqet e ankimit /parashtrimet e ankuesit

12. Në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), ankuesi ngre këto pretendime:

12.1 Procesi i shqyrtimit të kërkesës së ILD-së në KLP është një proces i parregullt ligjor, në trajtimin e kërkesave dhe ankesave të paraqitura prej ankuesit gjatë këtij procesi.

12.2 Shqyrtimi i çështjes vetëm mbi bazën e të dhënave të vendimit penal të Gjykatës së Posaçme të Apelit, e ka kthyer KLP-në në një organ formal, ndërkohë që është një organ i vetëqeverisjes së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, por që nuk kryen asnjë hetim administrativ paraprak për pretendimet administrative të prokurorëve që procedohen. KLP-ja vetëm “noterizon” kërkesat e Prokurorisë së Posaçme për marrjen e masave të pezullimit dhe vendimet e Gjykatës së Posaçme, për shkarkimin nga detyra të prokurorëve.

12.3 Vendimi nr. 284, datë 17.7.2023, duhet shfuqizuar, pasi KLP-ja duhet të pezullonte shqyrtimin e kërkesës së ILD-së dhe marrjen e vendimit, derisa të shqyrtohej rekursi i ankuesit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

12.4 Arsyetimin e KLP-së, që bazuar në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës, nenin 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 462, pika 3, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale, e ka konsideruar vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. {***}, datë 31.5.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut³, si dhe me vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar terminologjinë “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar”.

³ Shih vendimin e çështjes “Gjyli kundër Shqipërisë”.



12.5 Në bazë të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale⁴, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përveç prishjes ose lënies në fuqi të vendimeve të gjykatave të faktit, mund të vendosë edhe ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit, pasojat civile, si dhe prishjen e vendimit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim, kur zbatimi i ligjit material dhe procedural nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo provave të çështjes. Në këto kushte, pas shqyrtimit të rekursit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mund të vendosë edhe pushimin e gjykimit dhe/ose deklarimin e pafajshëm të magjistratit Sali Hasa.

12.6 KLP-ja dhe ILD-ja si organe të administratës shtetërore/publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të Kushtetutës, ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Kodit të Procedurave Administrative. Referuar nenit 66, pika 1 e këtij kodi⁵, shqyrtimi i kërkesës së ILD-së nga KLP-ja duhej pezulluar deri sa të merrej vendimi i shqyrtimit i rekursit nga Gjykata e Lartë.

12.7 Ankuesi ka paraqitur në KLP parashtrësë që vinin në dyshim procedurën dhe faktet në kërkesën e ILD-së, duke kërkuar verifikimin e tyre, në kuadër të respektimit të procesit të rregullt ligjor edhe në procedurat administrative, pasi këto pretendime jo vetëm që lidheshin me veprimtarinë e këtij këshilli, por edhe sepse prokurori Sali Hasa nuk kishte rrugë dhe organ tjetër ku t’i paraqiste.

12.8 Në parashtrësat e depozituara në ILD, ankuesi pretendon shkelje të ligjit procedural penal, pasi çështja penale në ngarkim të tij është marrë nga prokurori i Prokurorisë së Posaçme pa zhvilluar procedurat e shortit, si dhe në shkelje të rënda të parimeve të objektivitetit e transparencës në hetimet paraprake të procedimit penal nr. {***} të vitit 2021. ILD-ja nuk ka ushtruar asnjë proces hetimi mbi këto shkelje, hetimi i thelluar i të cilave, mund ta shfajësonin prokurorin nga akuza për veprën penale të korrupsionit pasiv.

12.9 Ndaj prokurorit Sali Hasa nuk është zbatuar parimi kushtetues i barazisë para ligjit dhe është

mbajtur standard i ndryshëm, në raport me sjelljen e Prokurorisë së Posaçme dhe KLP-së ndaj prokurorit E. H., ndaj të cilit kishte më tepër prova për ta akuzuar për veprën penale të korrupsionit pasiv sesa indicie që janë konsideruar si prova për të dënuar prokurorin Sali Hasa.

12.10 Ankuesi pretendon shkelje të nenit 6, pika 3, shkronja “b” të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), lidhur me kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes në gjykatë, për shkak të volumit të dosjes penale të hetimeve paraprake, si dhe mënyrës së paraqitjes së akteve dhe të dhënave në të.

12.11 Ankuesi i kërkon Kolegjit, gjithashtu, të vlerësojë edhe pretendimin e tij lidhur me zbatimin e dispozitave për fillimin e afatit të hetimeve për procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të Sali Hasës. Pasi duke i lënë në dorë prokurorit që të vendosë kohën për regjistrimin e emrit të personit të dyshuar në regjistrimin e njoftimit të veprave penale, e lejon atë të abuzojë me kohën e zgjatjes së hetimit të veprës penale. Po kështu lejimi i përgjimit telefonik 15-ditor dhe mbajtja në vëzhgim të fshehtë përpara regjistrimit të emrit si i dyshuar, shkel rëndë privatësinë e ankuesit në cenim të nenit 36 të Kushtetutës⁶.

I/2. Parashtrimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, datë 7.3.2024

13. KLP-ja nëpërmjet parashtrimeve, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), ka kërkuar rrëzimin e ankimit të ankuesit, subjekt procedimi disiplinor, prokurorit Sali Hasa, si të pabazuar në prova e në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 284, datë 17.7.2023. Në mënyrë të përmbledhur, KLP-ja parashtron, si më poshtë:

13.1 Pretendimet e ankuesit në Kolegji, janë të njëjtat me ato të paraqitura pranë KLP-së, e cila iu ka dhënë përgjigje shteruese në arsyetimin e vendimit të saj. Neni 5, pika 3, e ligjit nr. 84/2016,

⁴ Me ndryshimet e ligjit nr. 41/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

⁵ “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballat me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është Faqe | 11922

kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

⁶ “Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara”.



“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ekuivalenton gjykimin e Kolegjit me atë të Gjykatës Kushtetuese, duke i dhënë në këtë mënyrë Kolegjit atributet që burojnë nga ligji për Gjykatën Kushtetuese, dhe nga ana tjetër, proporcionalisht ngarkon të gjithë subjektet kërkuese/ankimuese të përmbushin detyrimet në referim të këtij ligji. Ankuesi ka dështuar të ngrejë pretendime në nivel kushtetues, për të cilat të merrte legjitimitim formal dhe substancial në referim të cenimit/mohimit të të drejtave, lirive dhe garancive kushtetuese.

13.2 Në referim të pikave 4 dhe 5, po të nenit 27 të këtij ligji⁷, ankimi objekt gjykimi nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë, e si i tillë, nuk duhet bërë objekt gjykimi.

13.3 Lidhur me pretendimin se KLP-ja ka marrë një vendim formal për shkarkimin nga detyra. Në interpretim të nenit 1, pika 2 dhe nenit 32 të Kodit Penal, referuar marzhit të dënimit të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 257/a/2 të këtij kodi, për të cilat është dhënë dënimi ndaj ish-magjistratit Sali Hasa, rezulton se ai është deklaruar fajtor për vepra penale që parashikohen nga ligji si krim. Nga interpretimi i nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe 428, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale, vendimi penal me të cilin është dënuar ish-magjistrati Sali Hasa është një vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

13.4 Referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht, nenit 148/d, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës dhe neneve 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016, në mënyrë të qartë përcaktohet se magjistrati i cili dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ndaj tij jepet vetëm masa disiplinore “shkarkim nga detyra”.

13.5 Në rastin konkret prokurori është dënuar për dy krime relativisht të rënda, e për këtë shkak gjykata ndaj tij ka aplikuar llojin e dënimit me burgim, i cili është ekzekutuar. Vendimi penal është i formës së prerë dhe është dhënë për vepra penale të cilat kanë si pasojë cenimin e figurës së magjistratit në dhënien e drejtësisë, gjë e cila e bën legjitime masën disiplinore të shkarkimit të vendosur nga

KLP-ja, pasi në këtë rast është cenuar rëndë besimi në publik i magjistratit dhe është jashtë çdo logjike të ligjit që magjistrati të qëndrojë në detyrë duke pezulluar procedimin disiplinor.

13.6 Procedura e shqyrtimit të çështjes nga KLP-ja është zbatuar konform përcaktimeve kushtetuese e ligjore, duke garantuar të drejtat e ankuesit, i cili nuk shpreh asgjë konkrete përveçse një opinion negativ që nuk ka asnjë vlerë sa i takon shqyrtimit të ankimit, pasi legjislatori shkarkimin nga detyra e lidh me akte dhe sjellje që cenojnë figurën e prokurorit, kur ai është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

13.7 Pretendimi se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është i pazbatueshëm për sa kohë rekursi nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, dhe nuk ka fituar fuqinë e *res judicata* dhe, si i tillë, nuk është një vendim përfundimtar, vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore të përmendura më sipër. Në këtë rast, legjislatori nuk ka dhënë ndonjë alternativë për një masë tjetër disiplinore, si dhe ka përdorur termin “vendim i formës së prerë për kryerjen e një krimi” dhe nuk ka përdorur një term tjetër ashtu si interpreton ankuesi.

13.8 Vendimi i formës së prerë është i detyrueshëm për të gjitha institucionet, edhe për KLP-në, që sipas detyrave të caktuara në ligj detyrohet të shqyrtojë edhe procedimin disiplinor të prokurorëve, dhe me të drejtë nuk kishte arsye përse të pezullonte procedimin disiplinor deri sa të shqyrtohej në Gjykatën e Lartë rekursi ndaj vendimit penal të formës së prerë.

13.9 Sipas vendimit unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndonëse nuk ka marrë ende statusin e “gjësë së gjykuar” është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm. KLP-ja në asnjë rast nuk ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është përfundimtar dhe as nuk i ka mohuar në asnjë fazë të procesit të drejtën ankuesit për të shteruar të gjitha mjetet juridike që ai disponon. KLP-ja nuk ka vënë në diskutim, në asnjë moment të drejtën e ankimit, si pjesë esenciale e një procesi të rregullt ligjor, por kjo

⁷ Neni 27, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 8577/2000, parashikon: “4. Kërkesa që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet nga Drejtoria Gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese. 5. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, konsiderohet e

paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuesin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuesi nuk e paraqet kërkesën të plotësuar ose brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet.”.



nuk e pengon atë të marrë vendimin e shkarkimit nga detyra, sipas dispozitave urdhëruese të ligjeve të posaçme.

13.10 Rekursi ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për dënimin e ankuesit, nuk pezullon fuqinë ekzekutive të vendimit të saj dhe nuk pengon KLP-në për shkarkimin e magjistratit nga detyra. Po kështu, edhe Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 55, datë 31.3.2021, ka vlerësuar se shprehja e vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë “formë e prerë” është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera, pa penguar kontrollin gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë. Pretendimi për pezullimin e procedimit disiplinor është paraqitur dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në KLP, dhe është rrëzuar si kërkesë duke vazhduar shqyrtimin e procedimit disiplinor, duke vendosur përfundimisht shkarkimin nga detyra.

13.11 Për pezullimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, duke referuar në nenin 66/1 të Kodit të Procedurave Administrative, KLP-ja parashtron se në rastin në shqyrtim zbatohet ligji specifik, përkatësisht, neni 145 lidhur me nenin 126, pika 2, e ligjit nr. 96/2016, nga interpretimi i të cilave saktësohet se pezullimi i procedimit disiplinor nga KLP-ja është i kufizuar deri në dhënien e vendimit të formës së prerë.

13.12 Lidhur me pretendimet se çështja penale në ngarkim të ankuesit është marrë nga prokurori pa zhvilluar procedurat e shortit, hetimi penal nuk ka qenë objektiv, i paanshëm dhe transparent, si dhe nuk është marrë në konsideratë kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, këto pretendime nuk zgjidhen kryesisht nga KLP-ja, pasi nuk ka pasur objekt shqyrtimi dhe një kërkesë të tillë nga ILD-ja. Kjo është një çështje që trajtohet nga nenet 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale dhe për sa kohë rekursi ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, vetëm kjo e fundit mund të shprehet me vendim përfundimtar nëse këto pretendime janë paraqitur në rekurs.

13.13 Pretendimet ndaj çështjeve penale që u përkasin personave të tretë që nuk kanë lidhje me objektin e procedimit disiplinor duke kërkuar nga KLP-ja të ndjekë të njëjtën praktikë në shqyrtimin e këtij rasti, duke pretenduar për shkelje procedurale nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, të cilët

sipas tij kanë cenuar parimin e barazisë para ligjit dhe të vepruarit me dy standarde, duke mbrojtur dhe favorizuar prokurorët e tjerë e duke ndërmarrë një proces hetimi të padrejtë ndaj prokurorit Sali Hasa, nuk zgjidhen kryesisht nga KLP-ja, kur nuk ka pasur objekt shqyrtimi për këto çështje të pretenduara prej tij, pasi nuk ka një kërkesë të tillë për shqyrtim nga ILD-ja. Veç kësaj, këto pretendime janë çështje që i përkasin hetimit penal nga ana e prokurorëve të cilët në çdo rast për çdo vendim të tyre, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nëpërmjet gjyqtarit të seancës paraprake që ka dhënë vendim, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Për sa kohë këto vendime janë të formës së prerë nuk mund të vlerësohen të padrejta, derisa nuk janë revokuar nga gjyqtari i seancës paraprake.

13.14 Lidhur me pretendimet e ankuesit se ndaj tij faktet e evidentuara nga prokurori i çështjes nuk përputhen me përmbajtjen reale që kanë dokumentet, për rrjedhim, sipas tij hetimet tej çdo dyshimi janë joobjektive, të njëanshme dhe jotransparente, deri në këto momente janë hipotetike dhe nuk janë vërtetuar nga kontrolli gjyqësor i një gjykate më të lartë me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

I/3. Parashtrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, datë 9.3.2024

14. ILD-ja parashtron se kërkesa e ankuesit duhet të mos pranohet, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

14.1 Në drejtim të procesit të rregullt ligjor, të gjitha veprimet e kryera dhe aktet e nxjerra nga ILD-ja gjatë kryerjes së veprimtarisë hetimore janë realizuar në respektim të këtij parimi. Ankuesi është njoftuar me vendimmarrjet e ILD-së dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet ligjore.

14.2 Parashtresat e ankuesit, të datës 26.4.2023 dhe të datës 3.5.2023, janë referuar në përmbajtjen e raportit të përfundimit disiplinor ndaj magjistratit⁸, si dhe janë bërë pjesë e dosjes hetimore të përcjellë pranë KLP-së. Për pasojë, pretendimet e ngritura në lidhje me rezerva sa i takon përcjelljes së këtyre dy dokumenteve pranë KLP-së janë tërësisht subjektive dhe të pambështetura.

14.3 ILD-ja ka bërë vlerësim të pavarur të parashtrimeve dhe argumenteve të ngritura nga ankuesi. Kjo nuk nënkupton mangësi në realizimin

⁸ Shih paragrafin 16.4, të raportit nr. {***}, datë 11.5.2023, “Për hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me Faqe | 11924

detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.



e një procedure të plotë dhe të gjithanshme të hetimit disiplinor, por përkundrazi, ILD-ja ka vepruar bazuar në diskrecionin që Kushtetuta dhe ligji i jep për fillimin dhe kryerjen e një procesi të plotë dhe të gjithanshëm hetimi disiplinor në funksion të respektimit të procesit të rregullt ligjor. Fakti që qëndrimet e mbajtura nga ILD-ja nuk i përgjigjen pritshmërisë së magistratit apo nuk mbajnë në konsideratë pretendimet e tij, nuk mund të nënkuptojë cenim të standardit të procesit të rregullt ligjor.

14.4 Në lidhje me pretendimet e ankuesit për mosshqyrtimin nga ILD-ja të ankimit me shkrim ndaj veprimtarisë të prokurorit A. D. dhe gjyqtarit Sh. L., të paraqitura ndërmjet parashitësave gjatë fazës së hetimit disiplinor, ILD-ja shprehet se ankuesi mund të pretendojë një tërësi faktesh dhe mund të identifikojë në ankesë çdo lloj shkelje disiplinore që ai pretendon se ka ndodhur, por është ILD-ja që, në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin për statusin e magistratit, bën një cilësim të fakteve, veprimeve/mosveprimeve që lidhen me shkeljen disiplinore që pretendohet në ankesë pa u lidhur me përcaktimin që mund të pretendojnë personat fizik/juridik. Kushtetuta dhe ligji i garantojnë ILD-së diskrecion për fillimin dhe kryerjen e një procesi të plotë dhe të gjithanshëm hetimi në funksion të respektimit të procesit të rregullt ligjor. Në fazën e hetimit disiplinor, ILD-ja kryen një vlerësim të pavarur të fakteve në përputhje me objektin e hetimit disiplinor, pavarësisht fakteve të parashtruara apo të kërkuara nga ankuesi/magjistrati. Parashitësa e paraqitur nga magjistrati gjatë fazës së hetimit disiplinor, si mjet procedural në dispozicion të magistratit subjekt hetimi disiplinor ka si qëllim garantimin e të drejtës së tij për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pretendimet e tij bazuar në objektin e hetimit disiplinor.

14.5 Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹, e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata është element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, për faktin se shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur dhe lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime/parashtrime dhe për të marrë përgjigje për to. E drejtë e cila është realizuar plotësisht gjatë hetimit

dhe procedimit disiplinor të zhvilluar respektivisht nga ILD-ja dhe KLP-ja. Pretendimet e ngritura nga ankuesi për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor janë tërësisht të pambështetura.

14.6 Në lidhje me pretendimin se nga ILD-ja dhe KLP-ja, në cilësinë e organeve administrative, duhet të ishin zbatuar parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative për pezullimin e procedurës disiplinore deri në përfundimin e gjykimit të rekursit në Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, ILD-ja parashtron se në kuadër të zhvillimit të veprimeve hetimore, dispozitat e ligjit nr. 96/2016 plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, vetëm me përjashtim të rasteve dhe për atë që ky ligj nuk parashikon ndryshe. Ligji për statusin e magistratit ka parashikuar në mënyrë të detajuar dhe shteruese rregullat e dhe rastet e pezullimit të procedurës së hetimit disiplinor, në nenin 126 të tij. Në këtë rast nuk jemi përpara aplikimit të kësaj dispozite pasi hetimi disiplinor me iniciativë nga ILD-ja ka filluar pasi çështja penale në ngarkim të magistratit është gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

14.7 Referuar nenit 148/d, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës, shkarkimi nga detyra vjen si pasojë e një vendimi gjyqësor që e deklaron prokurorin fajtor për kryerjen e një krimi dhe nuk presupozon vlerësim dhe diskrecion nëse duhet marrë masa e shkarkimit nga detyra apo jo. Kjo është qartësisht e sanksionuar jo vetëm në këtë dispozitë kushtetuese, por edhe në përmbajtjen e nenit 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, dispozitë e cila ka parashikuar që masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm në rastin kur magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, procedurat disiplinore të detajuara në këtë ligj zbatohen *për atë që është e nevojshme*. Jo pa arsye, legjislatori ka vendosur këtë term, pasi dënimi penal me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi përbën një fakt me vërtetimin e të cilit, ILD-ja është e detyruar të iniciojë procedurën disiplinore dhe të paraqesë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor duke propozuar vetëm masën e shkarkimit nga detyra dhe Këshilli përkatës ta finalizojë atë procedurë nëpërmjet dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

⁹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12/2005, nr. 8/2006, si dhe vendimin e KPA nr. 1, datë 20.2.2023, paragrafi

14.1.2.1, vendimin e GJEDNj-së çështja “Dory kundër Suedisë”, paragrafi 37.



14.8 Gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor rezultoi e provuar përmbushja e dy kriterëve të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, vendimi nr. {***}, datë 23.3.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konsiderohet vendim i formës së prerë, referuar parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe nenit 428, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe referuar neneve 1/2, 32, si dhe neneve të pjesës së posaçme përkatësisht 319/ç, 257/a/2 të Kodit Penal, ankuesi është dënuar për kryerjen e një krimi.

II. VLERËSIMI I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

A. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

15. Në përputhje me nenin 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁰, nenin 5, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”¹¹, si dhe nenin 192, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”¹², Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të prokurorit Sali Hasa.

16. Nën dritën e këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, shqyrtimi i kësaj çështjeje kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8577/2000. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 4/1 (JD), datë 1.2.2024, konkludoi se ankimi i plotëson kërkesat për t’i kaluar për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi plotëson kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000.

16.1 Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se ankuesi legjitimohet *ratione personae*, sipas pikave 2/b e 2/c, të nenit 31/a, të ligjit nr. 8577/2000, pasi kërkesa është paraqitur nga subjekti i legjitimuar me interes të drejtpërdrejtë në çështjen

e parashtruar, dhe është nënshkruar nga ai vetë dhe përfaqësuesit ligjor me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.4.2023.

16.2 Ankuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është protokolluar në Kolegji në datën 3.11.2023, brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577/2000, nga njoftimi i vendimit të arsyetuar të KLP-së, më 25.7.2023.

16.3 Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm i Apelit. Me fjalë të tjera, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit. Kërkimet në ankimin objekt shqyrtimi, nuk rezultojnë të kenë qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese. Përpos sa arsyetuar më sipër, në kushtet që nuk rezultojnë që ky kërkim të jetë ngritur e trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, as ky kriter përjashtues për shqyrtimin, nuk vërtetohet. Për rrjedhojë, ankuesi po shteron në Kolegji mjetin juridik të ankimit.

B. Vlerësimi për themelin e pretendimeve

17. Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), fillimisht mori në analizë pranueshmërinë e ankimit nën dritën e fakteve dhe rrethanave që lidhen me statusin e tij të magjistratit/prokuror, pas paraqitjes së këtij mjeti procedural dhe vendimit nr. 4/1 (JD), datë 1.2.2024, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ankuesi, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në Komision për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. 433, datë 3.9.2021, Komisioni ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të

¹⁰ “7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”

¹¹ “[...]3. Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...], b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

¹² “[...] Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese”.



rivlerësimit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Subjekti i rivlerësimit, Sali Hasa, ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi duke vënë në lëvizje Kolegjin në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit. Kolegji, me vendimin nr. 33 (JR), datë 8.7.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 433, datë 3.9.2021, të Komisionit. Vendimi i Kolegjit është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm, duke passjellë njëherazi mbarimin e statusit të magjistratit. Kjo situatë faktiko-ligjore, e vendos ankuesin në kushtet e parashikuara nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 8577/2000, të papranueshmërisë së ankimit në kuadër të juridiksionit disiplinor, pasi “*kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur*”.

18. Kolegji çmon se edhe në rast se do të merrte në konsideratë shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në kushtet e mungesës së statusit të magjistratit, si rezultat i moskalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, rivendosja në vend e së drejtës së pretenduar të shkelur nuk do të ishte e mundur.

19. Përpos sa më sipër, *obiter dictum* Kolegji, në kuadër të juridiksionit disiplinor, mori në analizë pretendimet e ankuesit kundër vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe procedurës ligjore të ndjekur, duke i analizuar ato edhe në këndvështrim të parashtrimeve që kanë bërë prezent në gjykim subjektet e interesuara, KLP-ja dhe ILD-ja. Në analizë të pretendimeve të palëve, Kolegji konstaton se ato përqendrohen kryesisht në interpretimin e efekteve juridike të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në ekzekutueshmërinë e menjëhershme të tij nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në këtë rast ILD-ja dhe KLP-ja, në kuadër të procesit disiplinor, si dhe efektet që prodhon rekursi derisa çështja të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë e të marrë statusin e *gjësë së gjykuar*.

20. KLP-ja, bazuar në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, që parashikon se: “*Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë:*

[...] b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”, nenin 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, “*Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme*”, ka analizuar nëse veprat penale në ngarkim të magjistratit klasifikohen në “krim”, si dhe nëse vendimi gjyqësor është i formës së prerë.

20.1 Me konsideratë përcaktimet e nenit 1, paragrafi 2 i Kodit Penal, në të cilin thuhet se: “*Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij kodi*”, si dhe nenit 32 të këtij kodi se: “*Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet*”, KLP-ja, referuar marzhit të dënimit të parashikuar për veprat penale për të cilat është dhënë dënimi, përkatësisht “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, dhe “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, konstaton se: *Magjistrati është deklaruar fajtor për vepra penale që parashikohen nga ligji si krim*.

20.2 Lidhur me “vendimin gjyqësor të formës së prerë”, KLP-ja i referohet nenit 462, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: “*3. Janë vendime të formës së prerë: [...] b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi¹³; c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar*”.

20.3 Për sa më sipër, KLP-ja ka dhënë masën disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, referuar ekzekutueshmërisë së menjëhershme të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit nën dritën e nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos pasur asnjë opsion të ndryshëm, në përputhje me nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës. Sikurse ka

¹³ Neni 428, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të Kodit të Procedurës Penale, parashikon: “*1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: a) lënien në fuqi të vendimit; b) ndryshimin e vendimit;*

c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit; [...]”.



shtjelluar, për analogji dhe Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 29/2001:

“[...] Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se, për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar”.

20.4 Ankuesi, nëpërmjet këtij mjeti procedural ankimi i ka kërkuar Kolegjit, dërgimin e çështjes në KLP, i cili duhet të rishqyrtojë kërkesën e ILD-së për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, mbasi të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Koleji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë nuk rezultojnë të ketë depozituar informacion mbi ecurinë gjyqësore të çështjes penale në ngarkim të tij, edhe pas marrjes së njoftimit në prill 2026, mbi shqyrtimin e çështjes së juridiksionit disiplinor në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, më datë 11.5.2026.

20.5 Nga të dhënat e pasqyruara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në internet, Kolegji erdhi në dijeni të faktit që Kolegji Penal i kësaj gjykate, me vendimin nr. {***}, datë 14.11.2024, ka vendosur:

*“ [...] 2. Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Sali Hasa kundër vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për akuzën për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal;*

*3. Prishjen e vendimit nr. {***} datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të gjykuarin Sali Hasa për akuzën për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.”.*

20.6 Nga të dhënat në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë se kjo gjykatë, më datë 2.4.2026, ka rrëzuar kërkesën e z. Sali Hasa, me objekt: *“Shfuqizimi pjesërisht si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të cilin është ndryshuar vendimi nr. {***}, datë 31.5.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lidhur me të pandehurin Sali Hasa, sipas të cilit ky ishte shpallur i pafajshëm për veprën penale “Refuzim për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal dhe deklarimi fajtor i të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e kësaj veprë penale dhe dënimi i tij me 1 (një) vit burgim; i vendimit nr. {***}, datë 14.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me të cilin ndërmjet të tjerave është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur nga i gjykuari Sali Hasa kundër vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për dënimin për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal”¹⁴.*

20.7 Pas dërgimit të çështjes për rishqyrtim në gjykatë e apelit me tjetër trup gjykues, nga të dhënat e pasqyruara në faqen e internetit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezultojnë se me vendimin nr. {***}, datë 18.6.2025, kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 31.5.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lidhur me deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, si dhe llojin dhe masën e dënimit për këtë veprë penale. Referuar të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në internet, ankuesi ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi, dhe çështja penale rezultojnë me *“status në proces”*.

21. Për sa analizuar më sipër, rezultojnë se ankuesi është deklaruar fajtor me një vendim të formës së prerë për veprën tjetër penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, *“Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me*

¹⁴ *Vendime përfundimtare, prill 2026 – Gjykata Kushtetuese.*



burgim deri në tre vjet”, vendimi i cili është përfundimtar, *res judicata*. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit në këtë rast për shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.7.2023 dhe dërgimin e çështjes në KLP, derisa të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, tashmë është pa objekt.

22. Në rrethanat aktuale, nisur nga data 14.11.2024, Gjykata e Lartë tashmë ka marrë një vendim përfundimtar, nëpërmjet mospranimit të rekursit kundër vendimit nr. {***}, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për akuzën e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, që passjell një përgjigje përfundimtare për masën disiplinore të shkarkimit nga KLP-ja.

23. Kolegji vëren se pjesë e rëndësishme e kërtimeve të ankuesit, është koncepti i vendimit të formës së prerë, marrë në analizë e shtjelluar nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 2/2014. Në linjë me këtë kërkim, ndërsa interpretimi i ankuesit ishte i drejtë deri në vitin 2017, me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, nën dritën e nenit 462, pika 3, shkronja “b”, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe ekzekutimi i këtij vendimi nga prokurori, është i formës së prerë dhe nuk mund të argumentohet se lë diskrecion për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për të mos zbatuar një dispozitë që, në mënyrë të shprehur, përcakton çfarë përbën vendim penal i formës së prerë, apo për të mos ndërmarrë hapat e parashikuar në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta e ligji për mënyrën se si veprohet për magjistratët në detyrë, statusi i të cilëve rregullohet e funksionon nëpërmjet këtyre organeve, në rast se ka vendim penal për kryerjen e një krimi.

24. Në rastin kur procesi disiplinor vjen si pasojë e një procesi penal, parashikimet e Kushtetutës në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” dhe pika 4, shkronja “a”, nuk parashikojnë për këto organe ILD-në dhe KLP-në, një mënyrë alternative veprimi. Procesi i hetimit disiplinor dhe vendimmarrja objekt ankimi janë kryer pasi ka nisur edhe ekzekutimi i vendimit penal, për shkak të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ndërsa ligji ka parashikuar edhe mënyrën e shërimit dhe rivendosjes së të drejtave, në rast se ankuesi do të kishte marrë një vendim në favor të tij pas rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, parë

edhe në këtë këndvështrim, mënyra se si është kryer procesi disiplinor për ankuesin, është e bazuar në ligj.

25. Lidhur me pretendimet për mosrespektim të parimit të procesit të rregullt ligjor gjatë procedurave administrative të kryera nga ILD-ja dhe KLP-ja, nga natyra e këtyre pretendimeve të renditura në paragrafët 12.8–12.11 të këtij vendimi, Kolegji konstaton se ato nuk afektojnë procesin e rregullt ligjor, në kuadër të procedimit disiplinor të zhvilluar ndaj tij, por i përkasin procesit penal, dhe janë objekt i kontrollit gjyqësor nga Gjykatat e Posaçme në të dyja shkallët e saj, Gjykata e Lartë, si dhe Gjykata Kushtetuese, në rastin e ankimit individual për shkelje të parimeve të parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja.

26. Në analizë të sa më sipër, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, Kolegji vendosi të mos pranojë ankimin e kërkuarit, duke e gjetur atë të pabazuar në ligj dhe akte. Ky vlerësim mban në konsideratë që procedimi disiplinor i kryer për ankuesin rezulton të ketë qenë në respektim të plotë të të drejtave për proces të rregullt nga njëra anë, dhe të faktit që, nga ana tjetër, në ngarkim të tij, ka një dënim penal për një krim të kryer me dashje. Dy institucionet e referuara më sipër [ILD-ja dhe KLP-ja] rezulton të kenë vepruar në përputhje me tagrat e tyre kushtetuese e ligjore, duke çelur hetimin disiplinor dhe ndërmarrë veprimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet që rregullojnë rrethanat ligjore konkrete.

27. Për sa më sipër arsyetuar, Kolegji vlerëson se ankimi i ankuesit Sali Hasa, kundër vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 31/a, pika 2, shkronja “dh” dhe 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të ankuesit Sali Hasa kundër vendimit nr. 284, datë 17.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin e masës



disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.5.2026.

Shpallur më 11.6.2026.

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtarë: Ina Rama, Mimoza Tasi, Albana Shtylla, Rezarta Schuetz, Natasha Mulaj

URDHËR

Nr. 115, datë 19.6.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negocimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën 4-ditore (katërditore), duke filluar nga data 22.6.2026 dhe datën 25.6.2026.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti, drejtor i Negocimit dhe Asistencës Ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 128|Datë: 19.06.2026 13:21:54
+02:00|8f031120-8a9e-4b7f-8010-93a6adf3f2d6

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)